



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Nr. 247 Akti

Nr. 416 Vendimi  
Tiranë, më 8.7.2021

**V E N D I M**

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i përbërë nga:

<b>Xhensila Pine</b>	Kryesuese
<b>Lulzim Hamitaj</b>	Relator
<b>Suela Zhegu</b>	Anëtare

asistuar nga sekretare gjyqësore, znj. Orjanda Liçi, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Francesco Ciardi, në datën 1.7.2021, në Pallatin e Koncerteve (ish-Pallati i Kongreseve), salla B, kati 0 (*underground*), Tiranë, mori në shqyrtim në seancë dëgjimore publike çështjen që i përket:

**SUBJEKTI I RIVLERËSIMIT:** **Znj. Zegjine Sollaku**, gjyqtare në Gjykatën e Apelit Tiranë.

**OBJEKTI:** **Rivlerësimi kalimtar i subjektit të rivlerësimit.**

**BAZA LIGJORE:** **Neni 179/b dhe nenet A, Ç, D, DH, E dhe Ë të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë;**

**Ligji nr. 84/2016**, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”;

**Ligji nr. 44/2015**, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”;

**Ligji nr. 49/2012**, “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar.

## **TRUPI GJYKUES I KOMISIONIT TË PAVARUR TË KUALIFIKIMIT,**

pasi dëgjoi arsyetimin ligjor dhe rekomandimin e relatorit të çështjes, komisioner Lulzim Hamitaj, subjektin e rivlerësimit, vëzhguesin ndërkombëtar, si dhe pasi shqyrtoi dhe diskutoi në tërësi çështjen që i përket rivlerësimit kalimtar të subjektit të rivlerësimit, znj. Zegjine Sollaku, e cila në seancën dëgjimore publike të datës 1.7.2021 kërkoi konfirmimin në detyrë,

### **V Ë R E N:**

#### **I. RRETHANAT E ÇËSHTJES**

1. Znj. Zegjine Sollaku, për shkak të funksionit si gjyqtare në Gjykatën e Apelit Tiranë, i është nënshtruar rivlerësimit, *ex officio*, në bazë të pikës 3, të nenit 179/b, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe të ligjit nr. 84/2016<sup>1</sup>.
2. Pas hedhjes së shortit, trupi gjykues, për këtë subjekt, fillimisht ishte i përbërë nga komisionerët Alma Faskaj, Lulzim Hamitaj dhe Suela Zhegu, e cila, pasi administroi dhe shqyrtoi raportet e institucioneve të parashikuara nga nenet 31 - 44 të ligjit nr. 84/2016, me vendimin nr. 1, vendosi të fillojë hetimin administrativ të thelluar dhe të gjithanshëm sipas nenit 45 të po këtij ligji.
3. Më pas, për shkaqe objektive, Komisioni, me vendimin nr. 18, të datës 9.3.2020, ka vendosur zëvendësimin e komisioneres Alma Faskaj, duke shortuar si zëvendësuese komisioneren Xhensila Pine. Në vijim, trupi gjykues me mirëkuptim caktoi kryesues të trupit gjykues, komisionere Xhensila Pine. Anëtarët e trupit gjykues deklaruan se nuk ishin në kushtet e konfliktit të interesit me subjektin e rivlerësimit.
4. Në vijim të hapave hetimorë të ndërmarrë nga Komisioni në datën 28.5.2021, me vendimin nr. 3, trupi gjykues vendosi të mbyllë fazën hetimore dhe në bazë të nenit 4 të ligjit nr. 84/2016 vlerësoi që procesi i rivlerësimit për znj. Zegjine Sollaku të bazohet në të tria kriteret e rivlerësimit dhe përkatësisht: rivlerësimin e pasurisë; kontrollin e figurës; dhe vlerësimin profesional.
5. Në datën 31.5.2021, Komisioni e njoftoi subjektin e rivlerësimit mbi: (i) rezultatet e hetimit kryesisht; (ii) kalimin e barrës së provës sipas nenit 52 të ligjit nr. 84/2016, për të sjellë shpjegime dhe prova të mundshme për të provuar të kundërtën, brenda afatit të caktuar; (iii) për t'u njohur me provat e administruara nga Komisioni, në përputhje me nenin 47 të ligjit nr. 84/2016, si dhe nenet 35 - 40 dhe 45 - 47 të Kodit të Procedurës Administrative.
6. Subjekti i rivlerësimit, pasi u paraqit për t'u njohur me dosjen, ka paraqitur shpjegimet dhe parashtrimet në Komision brenda afatit, të shoqëruara me dokumentacion mbështetës. Ndonëse më herët subjekti kishte paraqitur një kërkesë për të pasur një kohë shtesë për paraqitjen e prapësimeve të veta, pasi ishte në pritje të disa përgjigjeve nga institucione të

---

<sup>1</sup> Paragrafi 3 i nenit 179/b të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe ligji nr. 84/2016, "Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë" (në vijim ligji nr. 84/2016) parashikojnë se: "Të gjithë gjyqtarët, duke përfshirë gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese dhe Gjykatës së Lartë, të gjithë prokurorët, duke përfshirë Prokurorin e Përgjithshëm, Kryeinspektorin dhe inspektorët e tjerë pranë Këshillit të Lartë të Drejtësisë, i nënshtrohen rivlerësimit *ex officio*".

ndryshme të cilëve u ishte drejtuar me disa shkresa – por të vonuara në raport me njohjen e rezultateve të hetimit. Në lidhje me këtë shkak, por edhe për faktin që këto dokumente në vetvete nuk mund të përbënin prova me një peshë të tillë për të përmbysur barrën e provës, trupi gjykues, me vendimin e ndërmjetëm nr. 4, datë 16.6.2021, bazuar në pikën 6, të nenit 49, të ligjit nr. 84/2016, vendosi të mos e pranojë kërkesën e subjektit, dhe megjithatë, duke i dhënë kohë deri në seancën dëgjimore për të paraqitur dokumente dhe prova të reja.

7. Gjithashtu, trupi gjykues, pasi shqyrtoi disa kërkesa të tjera të subjektit të rivlerësimit, nëpërmjet vendimit të ndërmjetëm nr. 5, datë 23.6.2021, vendosi mospranimin lidhur me kërkesën e subjektit Zegjine Sollaku për të dëgjuar disa persona si dëshmitarë të mundshëm, duke mbajtur në vëmendje dispozitën ligjore të pikës 6, të nenit 49, të ligjit nr. 84/2016, pasi vlerësoi se dëgjesa e tyre nuk është e nevojshme, për sa kohë shumë prej këtyre personave (shtetasit K., M., K., K. dhe D.) e kanë shprehur mendimin e tyre nëpërmjet deklaratave noteriale, lidhur me rrethanat që pretendohet të provohen nëpërmjet dëshmisë së tyre. Madje në disa raste mjeti i provës i kërkuar nga subjekti nuk është i përshtatshëm, p.sh. si në rastin e shtetasve (Sh., I., M.) të cilët nuk mund të provonin nëpërmjet deklaramit të tyre lidhur me disponimin e një shume monetare të dikujt tjetër dhe as mbi burimin e saj – kjo edhe sipas jurisprudencës së konsoliduar të Kolegjit të Posaçëm të Apelit. Po ashtu, z. T. nuk mund të provonte nëpërmjet dëshmisë së tij të ardhurat e realizuara nga shitblerja e një pasurie, (garazh provizor), pasi vërtetësia e faktit në fjalë nuk mund të provohet nëpërmjet dëshmitarëve, pra mjeti i provës së kërkuar nuk është i përshtatshëm, për sa kohë parashikimet e Kodit Civil përcaktojnë kontratën e shkruar dhe të regjistruar, si të vetmin mjet prove mbi tjetërsimin e pasurive të paluajtshme. Për më tepër që, edhe sikur të merrej e mirëqenë provueshmëria e ndonjëres prej rrethanave që synohet të provohen me dëshmitarë, ato konsiderohen, sikurse edhe në tërësinë e tyre, me një peshë relative të tillë që nuk do të prodhonte një ndikim thelbësor/përmbysës për vendimmarrjen përfundimtare, parë kjo në raport me barrën e provës që i është kaluar subjektit.
8. Ndërkohë që, me vendimin e ndërmjetëm nr. 6, të datës 23.6.2021, trupi gjykues ka vendosur të ftojë subjektin e rivlerësimit në seancën dëgjimore të datës 25.6.2021, duke bërë njoftimin përkatës. Subjekti i rivlerësimit, pasi u njoh me caktimin e datës, po në datën 23.6.2021, ka kërkuar caktimin e një tjetër date për zhvillimin e seancës dëgjimore, për shkak të gjendjes së saj shëndetësore, dhe në pamundësi për t'u paraqitur në seancë, duke depozituar një raport mjekësor prej 10 ditësh.
9. Në datën 24.6.2021, me vendimin nr. 7, trupi gjykues, pasi shqyrtoi kërkesën e lartpërmendur, vendosi që ta pranojë atë dhe të ricaktojë seancën në datën 1.7.2021.
10. Në vijim, nëpërmjet rrugës elektronike, Komisioni e ka njoftuar subjektin e rivlerësimit në përputhje me nenin 55 të ligjit nr. 84/2016 lidhur me seancën dëgjimore të (ri)caktuar për në datën 1.7.2021, në të cilën seanca u zhvillua rregullisht, ku subjekti ishte prezent së bashku me përfaqësuesin e saj ligjor – njëkohësisht edhe bashkëshorti i saj – të cilët paraqitën shpjegimet dhe argumentimet e tyre lidhur me rezultatet e hetimit administrativ.

## II. SEANCA DËGJIMORE

11. Seanca dëgjimore e datës 1.7.2021 – për subjektin e rivlerësimit, znj. Zegjine Sollaku – u zhvillua në përputhje me kërkesat e nenit 55 të ligjit nr. 84/2016, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Francesco Ciardi.
12. Relatori i çështjes paraqiti rezultatet e arritura nga Komisioni përgjatë fazës së hetimit administrativ, të kryer mbi të tria kriteret e rivlerësimit dhe të kaluara si barrë prove apo për shpjegime.
13. Znj. Zegjine Sollaku, pasi dëgjoji relacionin, shprehu qëndrimin e saj, duke parashtruar shpjegimet përkatëse lidhur me gjetjet e hetimit kryesisht, si dhe mbi procesin e rivlerësimit të kryer ndaj saj, duke e vlerësuar objektivisht hetimin administrativ të Komisionit.
14. Gjithashtu, subjekti i rivlerësimit/përfaqësuesi gjatë seancës dëgjimore iu përgjigj pyetjeve të bëra nga trupi gjykues dhe shprehu qëndrimin përfundimtar të argumentuar dhe në konkluzion kërkoi konfirmimin në detyrë.
15. Në përfundim të seancës dëgjimore, bazuar në pikën 2, të nenit 4, të ligjit nr. 84/2016, trupi gjykues vendosi ta konsiderojë të plotësuar procesin e rivlerësimit për subjektin e rivlerësimit, znj. Zegjine Sollaku, duke u bazuar në të tria kriteret e rivlerësimit.
16. Seanca dëgjimore e datës 1.7.2021, u ndërpre, për të rifilluar në datën 8.7.2021, për shpalljen e vendimit.

## III. QËNDRIMI I SUBJEKTIT TË RIVLERËSIMIT

17. Znj. Zegjine Sollaku ka mbajtur një qëndrim bashkëpunues me Komisionin, duke dhënë përgjigje sa herë është pyetur, si dhe ka paraqitur dokumentacion mbështetës për shpjegimet e saj edhe në lidhje me burimet financiare të personave të tjerë me të cilët kishte pasur marrëdhënie financiare.

## IV. HETIMI ADMINISTRATIV I KRYER NGA KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

18. Bazuar në nenet 45, 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni kreu një hetim dhe vlerësim të të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimit, duke marrë në analizë:
  - i. provat e dorëzuara nga subjekti në ILDKPKI në “Deklaratën e pasurisë për rivlerësimin kalimtar, *Vetting*”;
  - ii. raportin e dorëzuar në Komision nga ILDKPKI-ja;
  - iii. raportet dhe informacionet mbi kontrollin e figurës, të dorëzuar në Komision nga DSIK-ja;
  - iv. provat shkresore/dokumentet të/e administruara nga organet publike dhe private, në përputhje me nenet 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016;
  - v. deklaratimet dhe përgjigjet e subjektit të rivlerësimit, të bëra me anë të komunikimit elektronik me Komisionin;
  - vi. shpjegimet me shkrim dhe dokumentacionin mbështetës, të paraqitur nga subjekti i rivlerësimit pas njoftimeve të mbylljes së hetimeve administrative, si dhe

argumentimeve të bëra nga subjekti në seancën dëgjimore – për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit;

- vii. deklaratimet e personave të lidhur, apo të tjerë të lidhur;
- viii. faktet e njohura botërisht.

#### **A. PROCESI I RIVLERËSIMIT PËR KRITERIN E PASURISË**

19. ILDKPKI-ja, bazuar në nenet 30 - 33 të ligjit nr. 84/2016, ka dërguar në Komision raportin lidhur me deklaratimet dhe vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit, znj. Zegjine Sollaku, ku konstatohet se:

- *deklarimi është i saktë në përputhje me ligjin;*
- *ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë;*
- *nuk ka kryer fshehje të pasurisë;*
- *nuk ka kryer deklarim të rremë;*
- *subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesit.*

#### **A/1 Rivlerësimi i pasurisë nga Komisioni**

20. Komisioni ka hetuar në mënyrë të pavarur mbi çdo informacion dhe konkluzion të institucionit të sipërpërmendur, ashtu sikurse mbi të gjitha faktet dhe informacionet e marra nga çdo subjekt i së drejtës, në përputhje me nenet 45, 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016.

21. Hetimi administrativ në lidhje me vlerësimin e pasurisë konsistoi në: verifikimin e vërtetësisë së deklaratimeve në lidhje me gjendjen pasurore të subjektit dhe personave të lidhur; verifikimin e burimeve të krijimit të të ardhurave dhe shpenzimeve me qëllim evidentimin e mungesës së mundshme të burimeve të mjaftueshme financiare për të justifikuar pasuritë; evidentimin e ndonjë fshehjeje të mundshme të sendeve në pronësi ose përdorim; si dhe evidentimin e ekzistencës së mundshme të deklaratimeve të rremë apo të ndonjë konflikti të interesave, parashikuar në pikën 5, të nenit 33, të ligjit nr. 84/2016.

22. Pasuritë e deklaruara nga subjekti i rivlerësimit në deklaratën e pasurisë për rivlerësimin kalimtar, në zbatim të ligjit nr. 84/2016, janë si më poshtë:

- i. **Apartament me sip. 81.4 m<sup>2</sup>, në rrugën “M. Gj.”, Tiranë**, me nr. pasurie \*\*\*, z. k. \*\*\*, blerë nga Enti i Banesave, përfituar me kontratë, datë 30.3.1995 (apartamenti prej vitit 2004 përdoret nga prindërit e subjektit), me vlerë blerjeje 1,126,289 lekë.
- ii. **Banesë private, në lagjen “\*\*\*\*”, Fier**, një dhomë e një kuzhinë, si dhe truall me sip. 495 m<sup>2</sup>, dhuruar bashkëshortit nga babai i tij, përfituar me kontratë nr. \*\*\*, datë 26.11.1998 (e pabanuar që prej vitit 2003).
- iii. **Apartament me sip. 195 m<sup>2</sup>, në rr. “P. R.”, p. “K.”, shk. \*\*\*, ap. \*\*\*, Tiranë**, me nr. pasurie \*\*\*, z. k. \*\*\*, përfituar me kontratën e shitblerjes nr. \*\*\*, datë 13.4.2005, si dhe kontratë shitblerjeje nr. \*\*\* (aktualisht përdoret nga nëna e bashkëshortit të subjektit), me vlerë të deklaruar prej 8,207,000 lekësh.
- iv. **Garazh me sip. 22.2 m<sup>2</sup>, me adresë të njëjtë me apartamentin në rrugën “P. R.”, pallati “K.”, Tiranë**, me nr. pasurie \*\*\*, z. k. \*\*\*, përfituar me kontratë nr. \*\*\*, datë 13.4.2005, me vlerë të deklaruar 475,000 lekë.

- v. **Apartament me sip. 140.03 m<sup>2</sup>, në rrugën “I. R.”, Tiranë**, me nr. pasurie \*\*\*, z. k. \*\*\*, përfituar me kontratë shitblerjeje nr. \*\*\*, datë 19.6.2012 (përdoret si zyrë avokatie nga bashkëshorti i subjektit) me vlerë të deklaruar 90,800 euro.
- vi. **Garazh me sip. 28.75 m<sup>2</sup>, në rrugën “I. R.”, Tiranë**, me nr. pasurie \*\*\*, z. k. \*\*\*, me vlerë të deklaruar 9,200 euro.
- vii. **Apartament me sip. 184.2 m<sup>2</sup>, në rrugën “S. F.”, kompleksi “N.”, Tiranë**, me nr. pasurie \*\*\*, z. k. \*\*\*, përfituar me kontratë nr. \*\*\*, datë 4.3.2013, me vlerë 181,200 euro.
- viii. **Apartament me sip. 82.4 m<sup>2</sup>, në rrugën “S. F.”, kompleksi “N.”, Tiranë**, me nr. pasurie \*\*\*, z. k. \*\*\*, përfituar me kontratë nr. \*\*\*, datë 4.3.2013, me vlerë 81,000 euro.
- ix. **Garazh me sip. 21.93 m<sup>2</sup>, me adresë dhe kontratë të njëjtë** si pasuria nr. 7 dhe nr. 8, me nr. pasurie \*\*\*, z. k. \*\*\*, vlera e blerjes 15,600 euro.
- x. **Garazh me sip. prej 15.95 m<sup>2</sup>, me adresë dhe kontratë të njëjtë** si pasuria nr. 7 dhe nr. 8, me nr. pasurie \*\*\*, z. k. \*\*\*, vlera blerje 11,400 euro.
- xi. **Garazh me sip. 15.08 m<sup>2</sup>, me adresë dhe kontratë të njëjtë** si pasuria nr. 7 dhe nr. 8, me nr. pasurie \*\*\*, z. k. \*\*\*, vlera e blerjes 10,800 euro.
- xii. **Apartament me sip. 70.56 m<sup>2</sup>, në K., Kavajë (P.)**, me nr. pasurie \*\*\*, z. k. \*\*\*, përfituar me kontratë nr. \*\*\*, datë 2.11.2015. Paguar me mandatpagesën, datë 20.2.2009, me vlerë 3,000,000 lekë.
- xiii. **Automjet tip “Citroen 5”**, me targa \*\*\*, prodhim i vitit 2009, blerë në vitin 2009, në bashkëpronësi me vajzën A. S., me vlerë 30,000 euro.
- xiv. **Automjet tip “Audi 6”** me targa \*\*\*, prodhim i vitit 2009, blerë sipas kontratës nr. \*\*\*, datë 27.5.2013, në bashkëpronësi të djalit dhe bashkëshortit të subjektit, me vlerë 10,000 euro.
- xv. **Apartament me sip. 64 m<sup>2</sup>, në Sarandë**, me nr. pasurie \*\*\*, z. k. \*\*\*, blerë në vlerën 32,500 euro, me kontratën nr. \*\*\*, datë 19.10.2012.

## A/2 Vlerësimi i pasurisë

### 1. Apartament me sipërfaqe 81.4 m<sup>2</sup>, në rrugën “M. Gj.”, Tiranë

- 23. Në deklaratën *Vetting* subjekti i rivlerësimit ka deklaruar burimin e krijimit të kësaj pasurie nga: (i) kursimet familjare ndër vite nga pagat; (ii) dietat e bashkëshortit si këshilltar i Presidentit të Republikës; (iii) dietat nga vizita në SHBA 1 muaj, në maj të vitit 1993 (kursyer 4,000 USD); si dhe (iv) pagat si pedagog i jashtëm në Fakultetin Juridik. Ndërsa në DIPP-në e vitit 2003 subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshorti kanë deklaruar apartamentin në fjalë, me burim krijimi nga privatizimi, pa e deklaruar vlerën e tij prej 1,126,289 lekësh sipas kontratës së shitblerjes.
- 24. Përgjatë hetimit administrativ është konstatuar se ky apartament është përfituar me kontratën e shitjes nr. \*\*\*, datë 30.4.1995, lidhur ndërmjet Degës së Entit Kombëtar të

Banesave Tiranë dhe blerësit Th. S., kundrejt çmimit të blerjes 1,126,389 lekë, paguar sipas mandatarkëtimit nr. \*\*\*, datë 29.3.1995. Gjithashtu, ASHK-ja, Tirana Jug, me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 15.10.2019, ka konfirmuar se pasuria e sipërcituar, me nr. pasurie \*\*\*, z. k. \*\*\*, është e regjistruar në emër të bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit, z. Th. S..

25. Lidhur me analizimin e burimeve të deklaruara për blerjen e kësaj pasurie, ka rezultuar se:

i. Sa i përket të ardhurave nga pagat, nga dokumentacioni i administruar nga Komisioni ka rezultuar se subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshorti kanë realizuar të ardhura deri në mars të vitit 1995, në masën 532,038 lekë<sup>2</sup>.

ii. Lidhur me burimet e tjera të deklaruara në deklaratën *Vetting* si burim për krijimin e kësaj pasurie (dietat dhe pagat si pedagog), Komisioni, nëpërmjet pyetësorit nr. 3, i ka kërkuar subjektit të rivlerësimit të paraqesë dokumentacionin përkatës. Në përgjigje të sa më sipër, subjekti ka vënë në dispozicion dokumentacionin, si vijon:

- vërtetim nr. \*\*\* prot., datë 5.7.1999, nga dekanati i Fakultetit të Drejtësisë, në të cilin është konfirmuar se z. Th. S. është/ka qenë pedagog i jashtëm;
- vërtetim nr. \*\*\* prot., datë 27.5.2020, nga Fakulteti i Drejtësisë, sipas të cilit nuk rezultojnë të dhëna për pagesa për pedagogët e jashtëm;
- vërtetim nr. \*\*\* prot., datë 17.7.2020, nga Fakulteti i Drejtësisë mbi numrin e studentëve që janë marrë në provim nga z. Th. S. si pedagog i jashtëm në vitet 1992 - 1996;
- vërtetim nr. \*\*\* prot., datë 11.6.2020, nga Ministria e Drejtësisë, sipas të cilit janë evidentuar regjistrat e mësimdhënies në kursin e përsheptuar të Drejtësisë të zhvilluar në Durrës në vitin 1993, por nuk disponohet dokumentacion mbi pagesa të kryera në favor të pedagogut Th. S.<sup>3</sup>;
- vërtetim nr. \*\*\*, datë 23.6.2020, nga Këshilli i Europës, në të cilin janë shprehur se nuk mund të ofrojnë një vërtetim mbi honoraret e përfituara nga bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit për periudhën 1992 – 2002, për shkak se rregulloret e tyre financiare kërkojnë ruajtjen e informacionit deri në 10 vite<sup>4</sup>;
- vërtetim nr. \*\*\* prot., datë 21.2.2019, nga institucioni i Presidentit të Republikës mbi të ardhurat në valutë të përfituara nga bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit për shërbimet jashtë vendit për periudhën 1994 – 2001;
- deklaratë noteriale nr. \*\*\*, datë 12.6.2020, nga shtetasi A. H., i cili është shprehur se në maj të vitit 1993, së bashku me bashkëshortin e subjektit të rivlerësimit, për shkak të detyrës zhvilluan një vizitë 1-mujore në SHBA<sup>5</sup>, për të cilën kanë marrë një

<sup>2</sup> Janë përlogaritur të ardhurat nga viti 1989 deri në mars të vitit 1995 (të ardhurat nga punësimi në Hetuesinë Shkodër, Hetuesinë Tiranë dhe Institutin e Presidentit të Republikës për bashkëshortin e subjektit të rivlerësimit dhe të ardhurat e subjektit si mësuese deri në 31 tetor 1991 dhe më pas në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, përfshirë dhe periudhën me lejëlindjeje.

<sup>3</sup> Bashkëlidhur shkresës është vënë në dispozicion VKM-ja nr. 133, datë 26.3.1993, “Për çeljen e kurseve për përgatitjen e punonjësve të Prokurorisë, të Policisë Hetimore dhe të gjykatave” dhe disa fletë regjistri.

<sup>4</sup> Bashkëlidhur shkresës në gjuhën angleze (përkthyer në gjuhën shqipe dhe noterizuar) Këshilli i Europës ka vendosur një tabelë me historikun e pagesave të kryera të ekspertëve që udhëtonin me shpenzimet e buxhetit të Këshillit të Europës.

<sup>5</sup> Subjekti i rivlerësimit ka vendosur në dispozicion edhe Programin Ndërkombëtar të Vizitorëve, të zhvilluar në periudhën 22 maj 1993 – 22 qershor 1993 për Sistemin e Drejtësisë të SHBA-së, së bashku me listën e pjesëmarrësve, ndër të cilët janë bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit dhe deklaruesit e mësipërm A. H. dhe K. T..

shumë prej 5,100 USD për të mbuluar shpenzimet e qëndrimit. Ai ka shtuar se nga ky udhëtim secili u kthye me kursime mbi 3,000 USD dhe se z. Th. S., sipas deklarimeve të tij, ishte kthyer me 3,500 USD;

- deklaratë noteriale nr. \*\*\*, datë 12.6.2020, nga shtetasi K. T., i cili është shprehur se në maj të vitit 1993, së bashku me bashkëshortin e subjektit të rivlerësimit, për shkak të detyrës zhvilluan një vizitë 1-mujore në SHBA, për të cilën kanë marrë një shumë prej 5,000 USD dhe se ai personalisht kishte kursyer më shumë se gjysmën;
  - deklaratë noteriale nr. \*\*\*, datë 10.6.2020, nga shtetasi S. D., i cili ka deklaruar se në vitin 1995 ka blerë nga bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit apartamentin e ndodhur në Fier, kundrejt çmimit 1,100,000 lekë, pagesë të cilën e ka kryer *cash*. Ai ka shtuar gjithashtu se për shkak të problemeve të tij akti noterial i shitjes është kryer në vitin 1998.
26. Subjekti i rivlerësimit ka paraqitur gjithashtu dy deklarata noteriale nga shtetasit R. H. dhe M. D., të cilët kanë deklaruar se gjatë periudhës 1990 – 1992, së bashku me bashkëshortin e subjektit Th. S. kanë ushtruar profesionin e avokatit, ku kanë qenë kundërshtarë apo kanë përfaqësuar çështje të përbashkëta. Subjekti ka pretenduar se bashkëshorti ka realizuar të ardhura nga avokacia në këtë periudhë të paktën në shumën 600,000 lekë, por që si pasojë e mosekzistencës së një kuadri fiskal në atë kohë nuk janë deklaruar në asnjë strukturë.
  27. Referuar orientimeve<sup>6</sup> të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit nuk mund të konsiderohen si të ardhura të subjekteve të rivlerësimit dhe personave të lidhur me ta vlerat monetare të përfituara në formën e dietës për rimbursimin e shpenzimeve nga organizatorët e aktiviteteve të ndryshme profesionale ku ata kanë qenë pjesëmarrës. Rrjedhimisht, dietat e përfituara nga bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit në udhëtimet e tij në SHBA apo edhe nga Këshilli i Europës, edhe nëse do të provohej shuma e saktë dhe përfitimi i tyre, nuk mund të merren në konsideratë në analizën financiare si të ardhura.
  28. Lidhur me të ardhurat si pedagog në Fakultetin e Drejtësisë dhe në kursin e përshpejtuar të drejtësisë të zhvilluar në Durrës në vitin 1993, pavarësisht faktit se provohet punësimi i bashkëshortit të subjektit në këto institucione, mbetet e paprovuar shuma e të ardhurave të përfituara.
  29. Po ashtu, të ardhurat e pretenduara nga avokacia në periudhën 1990 – 1992, ndërkohë që aktiviteti i ushtrimit të avokatisë nuk ka qenë i regjistruar, mbeten vetëm në nivel deklarativ dhe, për rrjedhojë, nuk janë konsideruar si burim në analizën e pasurisë.
  30. Ndërkohë, të ardhurat nga shitja e apartamentit në Fier, të pretenduara si të disponuara në vitin 1995, për të cilin është nënshkruar kontrata e shitjes në vitin 1998, nuk janë deklaruar nga subjekti të përdorura si burim për blerjen e këtij apartamenti as në DIPP-në e vitit 2003 dhe as në deklaratën *Vetting*. Për më tepër, subjekti e ka deklaruar këtë të ardhur si burim për blerjen e një apartamenti tjetër në lagjen “\*\*\*”, Fier, në vitin 2003.
  31. Edhe në rast se do të pranohej nga Komisioni, pretendimi kontradiktor i subjektit në përgjigje të pyetësorit nr. 3, krahasuar me deklaratimet e saj në deklaratën *Vetting* mbi disponimin e kësaj shume që në vitin 1995 dhe përdorimi i tyre për blerjen e apartamentit

---

<sup>6</sup> Vendimi nr. 7 (JR), datë 5.4.2019.



në analizë, kjo do të rezultonte në një mungesë të shtuar të burimeve të ligjshme për blerjen e apartamentit në lagjen “\*\*\*\*”, Fier dhe investimeve të tjera të subjektit në vitet 2000 apo 2003<sup>7</sup>.

32. Në përfundim të sa më sipër, Komisioni ka përllogaritur edhe shpenzimet e jetesës për këtë periudhë në masën 66 %<sup>8</sup> të të ardhurave, prej 351,145 lekësh. Në mënyrë të përmbledhur janë paraqitur të ardhurat dhe shpenzimet deri në mars të vitit 1995, kur është kryer investimi nga subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshorti.

**Tabela nr. 1** – analiza e burimeve të përdorura për blerjen e apartamentit

Të ardhura për periudhën 1986-mars 1995	532 038
Shpenzime për blerje apartamenti në Tiranë	- 1 126 389
Shpenzimet jetike	- 351 145
<b>Rezultati</b>	<b>- 945 496</b>

33. Nisur nga sa më sipër, Komisioni i ka kaluar subjektit barrën e provës lidhur me rezultatet e mëposhtme:
- Duket se subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar në DIPP-në e vitit 2003 vlerën e pasurisë (prej 1,126,289 lekësh) dhe as burimin e të ardhurave për krijimin e kësaj pasurie.
  - Duket se deklaratimet e subjektit të rivlerësimit në përgjigje të pyetësorit nr. 3 janë kontradiktore krahasuar me deklaratimet e saj në deklaratën *Vetting*, sa i përket disponimit në një kohë më të hershme (viti 1995) të të ardhurave nga shitja e apartamentit në vitin 1998.
  - Nga analiza financiare duket se për blerjen e këtij apartamenti në vitin 1995 subjekti i rivlerësimit ka pasur mungesë të burimeve financiare të ligjshme financiare prej 945,496 lekësh.

### **Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit**

34. Pasi është njohur me rezultatet e hetimit administrativ, subjekti i rivlerësimit, lidhur me konstatimet mbi deklaratimet, është shprehur se janë pasojë e një qasjeje të pakujdesshme në drejtim të plotësimit me përpikëri të deklaratave periodike të pasurisë. Është deklaruar apartamenti me burim krijimi nga privatizimi, veprim i cili vërteton se nuk ka qenë qëllimi i fshehjes së kësaj pasurie, por një harresë e paqëllimshme, që nuk ka sjellë fshehje të

<sup>7</sup> Nga dokumentacioni i administruar, subjekti dhe bashkëshorti kanë kryer investime në pasuri të paluajtshme në vitet 2000 dhe 2003. Në qoftë se të ardhurat do të konsideroheshin të përfituara realisht në vitin 1995, do të zbriteshin nga burimet e përdorura për investimet e subjektit në vitin 2000 dhe/apo në vitin 2003.

<sup>8</sup> Referuar jurisprudencës së Kolegjit të Posaçëm të Apelit, shpenzimet e jetesës për këtë periudhë janë konsideruar në masën 66 % të të ardhurave.

pasurisë, për sa kohë evidentohet në regjistrat hipotekorë dhe origjina është nga privatizimi.

35. Lidhur me burimet nga shitja e apartamentit në vitin 1998, të pretenduara si të përdorura për blerjen e kësaj pasurie, subjekti insiston se çmimi është përfituar në vitin 1995 dhe kontrata është formalizuar në vitin 1998, kjo për shkaqe që lidheshin me probleme të blerësit, i cili kishte kërkuar që pasuria të regjistrohej më pas. Gjithashtu, subjekti është shprehur se referuar kontratës së shitjes së apartamentit, ku citohet se: *“Banesën së bashku me truallin e saj ja kemi shitur z. S. D., në shumën 1,100,000 lekë. Këtë shumë e kemi marrë të gjithë jashtë kësaj zyre dhe i kemi liruar banesën dhe truallin e saj”*, kuptohet se veprimet janë kryer në një kohë të mëparshme nga lidhja e kontratës. Ky fakt konfirmohet edhe nga blerësi, si në kontratën e shitjes, ashtu edhe në deklaratën noteriale të dhënë prej tij.
36. Lidhur me mungesën financiare të larpërmendur, subjekti është shprehur se burim për blerjen e këtij apartamenti kanë shërbyer të ardhurat nga kursimet familjare ndër vite (paga si ndihmës gjyqtare dhe pagat e bashkëshortit hetues në Shkodër dhe më pas pedagog i Fakultetit të Drejtësisë dhe prej vitit 1992 këshilltar i Presidentit), pagesat për rrugët jashtë shtetit, quajtur shkurt “dieta”, nga viti 1992 pagesat si pedagog i jashtëm i Fakultetit Juridik dhe puna si avokat në vitet 1990 - 1992, duke kërkuar aplikimin e pikës 2, të nenit 32, të ligjit nr. 84/2016, dhe ka specifikuar si vijon:
  - a. Në lidhje me pagesat e deklaruara nga bashkëshorti si avokat për periudhën 1990 – 1992, në shumën 600,000 lekë, ka vendime gjyqësore të cilat provojnë qenien e bashkëshortit avokat gjatë atyre viteve. Po ashtu, subjekti ka pretenduar se ligji për “Tatimin mbi të ardhurat” është miratuar në fund të vitit 1992 dhe është bërë efektiv gjatë vitit 1993, për rrjedhojë, bashkëshorti nuk kishte çfarë tatimi të paguante, sepse nuk ekzistonte një detyrim ligjor i tillë.
  - b. Sa i përket dietave/pagesave të pretenduara nga Këshilli i Europës dhe SHBA-ja, kursimet nga këto pagesa/përfitime janë të logjikshme, duke konsideruar nivelin ekonomik dhe kushtet e jetesës në Shqipëri në ato vite.
  - c. Lidhur me pagesat e përfituara si pedagog i jashtëm, subjekti ka paraqitur një përllogaritje të kryer në bazë të të ardhurave referuar numrit të studentëve të marrë në provim, nga z. Th. S., duke pretenduar një të ardhur nga ky burim, jo më pak se 100,000 lekë.
37. Në vijim të pretendimeve të mësipërme, subjekti i rivlerësimit ka paraqitur një përllogaritje të analizës financiare të kryer në bazë të pretendimeve të saj, në të cilën duke shtuar edhe të ardhurat e sipërpërmendura, këto të fundit mbulojnë vlerën e blerjes së pasurisë në analizë.
38. Gjithashtu, subjekti i rivlerësimit ka depozituar dokumentet e mëposhtme, në cilësinë e provës dhe në mbështetje të pretendimeve të saj:
  - i. vendim civil nr. \*\*\*, datë 25.3.1992, me palë paditës/kundërpaditur G. N. dhe të paditur/kundërpaditës A. L., e përfaqësuar nga avokat Th. S.;

- ii. deklaratë noteriale e shtetasit E. B., i cili është shprehur se z. Th. S. ka qenë avokati i babait të tij B. B., në vitet 1991 - 1992;
- iii. shkresë nr. \*\*\* prot., datë 18.6.2021, e Kryetarit të Gjykatës së Rrethit Tiranë, në të cilën është shprehur se: “...verifikimi i vendimeve të kësaj periudhe bëhet vetëm në bazë të emrave konkret të palëve ndërgjyqëse dhe jo mbi bazë të përfaqësuesve të tyre, ndaj dhe kërkimi është një punë voluminoze që kërkon angazhim shtesë të stafit...”;
- iv. deklaratë noteriale në SHBA e shtetasit A. Sh., i cili është shprehur se në vitin 1993 është marrë me organizimin dhe shoqërimin e një grupi juristësh, mes të cilëve edhe z. Th. S.. Në fund të vizitës, anëtarët kanë këmbyer çeqet në USD dhe z. Th. S. ka këmbyer ditën e fundit shumë prej 3,500 USD;
- v. një përlllogaritje e kryer nga kancelari i Fakultetit të Ekonomisë, mbi të ardhura të mundshme të përfituara si pedagog i jashtëm në vitet 1992 - 1997, sipas të cilës ka nxjerrë një të ardhur të mundshme prej 89,044 lekësh;
- vi. në DIPP-në e vitit 2003, ku janë cituar të ardhurat nga avokatia e viteve 1990 - 1992 si pedagog i jashtëm i Fakultetit të Drejtësisë dhe kursimet nga dietat nga udhëtimet jashtë vendit.

### **Vlerësimi i trupit gjykues**

39. Trupi gjykues, nisur nga pretendimet dhe argumentimet e subjektit dhe nga analizimi i provave të paraqitura prej saj, vlerëson se për sa i përket të ardhurave nga ushtrimi i profesionit të avokatit përgjatë periudhës 1990 – 1992, rezulton e provuar se bashkëshorti i saj ka zotëruar licencën e avokatit dhe ka qenë të paktën në një çështje gjyqësore në cilësinë e avokatit/përfaqësuesit ligjor. Lidhur me pretendimin e subjektit se meqenëse nuk kishte legjislacion/rregullim tatimor të kohës, bashkëshorti i saj nuk ka pasur ndonjë detyrim për të paguar tatime mbi të ardhurat e realizuara, vlerësohet se ky arsytim vlen pjesërisht – vetëm për vitin 1991 dhe jo për vitin 1992 e më pas. Kjo pasi nga shqyrtimi i legjislacionit të kohës ka rezultuar se prej datës 1.1.1992 ka hyrë në fuqi ligji nr. 7546, “Për administrimin e tatimeve dhe të taksave në Republikën e Shqipërisë”, ligji nr. 7544, “Për tatimin mbi fitimin”, si dhe ligji nr. 7545, datë 6.1.1992, “Për tatimin mbi të ardhurat e personave fizikë në sektorët privatë të tregtisë, artizanatit e të shërbimeve të tjera”, ku parashikohet se çdo person fizik apo juridik që ushtron veprimtari ekonomike i nënshtrohet tatimit dhe taksave në përputhje me legjislacionin në fuqi për tatimet dhe taksat, si dhe përcaktohet tatimi për avokatët i cili llogaritet me tarifë proporcionale 20 %, që derdhen në buxhetin e shtetit. Po ashtu, përcaktohet se çdo subjekt që ushtron veprimtari private dhe ka fituar zotësi për të vepruar regjistrohet në organet tatimore brenda 15 ditëve nga dita e fillimit të zotësisë për të vepruar.
40. Për rrjedhojë, ndonëse për periudhën 1990 - 1991, për të cilën nuk kishte dispozita rregulluese e parashikuese mbi detyrime tatimore, nuk është paraqitur ndonjë dokumentacion që të provojë specifikisht të ardhura të realizuara përgjatë kësaj periudhe, trupi gjykues çmon se për shkak të distancës kohore dhe mungesës së organizimit formalo-administrativ dhe mospasjes së detyrimit të ruajtjes së dokumentacionit provues të të ardhurave deri në ditët e sotme, në këto rrethana gjen aplikim pika 2 e neni 32, të ligjit nr.

84/2016 dhe mund të konsiderohet si e realizuar e ardhur e z. Th. S. nga ushtrimi i profesionit si avokat, në shumën prej 300,000 lekësh dhe jo 600,000 lekë sa pretendon subjekti. Ndërsa, për sa i përket vitit 1992, edhe nëse do të ishte provuar (apo prezumuar për shkak të aplikimit të pikës 2, të nenit 32, të ligjit nr. 84/2016) shuma e të ardhurave të përfituara si avokat, bashkëshorti i subjektit në këtë periudhë duhet të ishte regjistruar në organet tatimore dhe të paguante detyrimet tatimore përkatëse sipas legjislacionit në fuqi, për rrjedhojë, pretendimet e tij nuk mund të vlerësohen të pranueshme për shkak të kohëzgjatjes, për sa kohë të dhënat tatimore, nëse do të ishin paguar, do të rezultinin aktualisht të evidentueshme.

41. Lidhur me kursimet e pretenduara nga udhëtimet e bashkëshortit në Europë dhe SHBA, fillimisht vërehet se përgjithësisht dietat janë vlera monetare të përfituara për mbulimin e shpenzimeve dhe nuk mund të konsiderohen si të ardhura/kursime, me përjashtim të rasteve kur provohet e kundërta. Në rastin konkret trupi gjykues vlerëson se, nisur nga: (i) dokumentacioni i paraqitur nga subjekti (deklaratë noteriale; kërkesë për të dëgjuar një dëshmitar mbi këtë rrethanë; dokument mbi mospasje detyrimi për deklarime në doganë të të hollave të pretenduara si të sjella në Shqipëri); (ii) argumentimi i dhënë në prapësime dhe në seancë dëgjimore mbi situatën ekonomiko-shoqërore asokohe në Shqipëri; të ndërthurura me (iii) faktin që ky burim është deklaruar nga subjekti prej vitit 2003, si dhe në deklaratën *Vetting*; dhe duke mbajtur në konsideratë (iv) kohën e largët dhe pamundësinë objektive për të provuar pretendimin, ndonëse kursimi dhe transferimi i shumës së pretenduar dhe disponimi/përdorimi i saj në Shqipëri nuk është provuar plotësisht – ky burim mund të konsiderohet në analizën financiare për periudhën përkatëse.
42. Lidhur me të ardhurat nga Fakulteti i Drejtësisë si pedagog i jashtëm, vërehet se përlllogaritjet e kryera nga eksperti i zgjedhur nga subjekti janë bërë duke konvertuar numrin e studentëve të marrë në provim, në një numër të caktuar orësh mësimore. Përveç kësaj janë përlllogaritur edhe orët mësimore përkatëse për leksione dhe seminare, të konvertuara me koeficientë sipas informacioneve të marra nga pedagogë të tjerë. Në bazë të VKM-së nr. 393, datë 3.9.1992, rezulton të jetë përcaktuar pagesa për punonjësit e jashtëm që japin mësim në shkollat e larta, prej 38 lekësh/orë. Si pasojë, Komisioni ka përlllogaritur të ardhura për pjesën që rezulton e provuar nga vërtetimi i Fakultetit të Drejtësisë dhe vetëm nga marrja e studentëve në provim rezulton se pagesa totale për këtë veprimtari shkon në shumën 1,363 lekë. Nisur nga sa më lart, dhe nga fakti që edhe këto të ardhura janë deklaruar nga subjekti si në deklaratën e vitit 2003, ashtu edhe në atë *Vetting*, si dhe duke i gërshetuar rrethanat e lartpërmendura me vështirësitë e të provuarit të përfitimeve nga këndvështrimi sasior, për sa kohë marrëdhënia/bashkëpunimi profesional/e rezulton e provuar, trupi gjykues vlerëson se nëpërmjet aplikimit të pikës 2, të nenit 32, të ligjit nr. 84/2016, edhe përfitimi i shumës totale prej 89,044 lekësh, të shpërndarë në 6 vite, 1992 - 1997, duket bindëse dhe duhet marrë në konsideratë.
43. Për sa u përket të ardhurave të përfituara nga shitja e apartamentit në Fier, të pretenduara si të marra/disponuara në vitin 1995, ndërkohë që kontrata e shitblerjes është nënshkruar në vitin 1998, trupi gjykues vlerëson se pretendimi i subjektit jo vetëm që nuk provohet, pasi deklaratat e mëpasshme nuk mund të zhbëjnë çka është shprehur përpara noterit në

një kontratë shitblerjeje e cila është regjistruar dhe i ka prodhuar efektet e saj reale në vitin 1998. Përmbajtja e kësaj të fundit prevalon mbi çdo deklaram apo pretendim ndryshe, për sa kohë nuk është cituar asgjë lidhur me pagesën e çmimit të vite me herët. Për rrjedhojë, në këtë rast nuk provohet pretendimi i subjektit mbi përfitimin/disponimin në një kohë më të hershme (në vitin 1995) të të ardhurave nga shitja në vitin 1998.

44. Në konkluzion, duke konsideruar dhe reflektuar efektet mbi analizën financiare të vlerësimeve përfundimtare të trupit gjykues për çdo pretendim të subjektit – të argumentuar më lart në paragrafët përkatës, ku janë trajtuar edhe tematikat specifike – pamundësia financiare e familjes së subjektit për të paguar/krijuar këtë pasuri reduktohet në vlerën negative prej 283,071 lekësh.

## **2. Banesë private në lagjen “\*\*\*”, Fier**

45. Kjo pasuri është deklaruar për herë të parë nga subjekti i rivlerësimit në DIPP-në e vitit 2003, me sip. 540 m<sup>2</sup> dhe me burim krijimi: dhuruar bashkëshortit nga prindërit.
46. Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion nga ASHK-ja Fier, me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 16.10.2019, ka rezultuar se në emër të z. Th. S. figuron e regjistruar pasuria e llojit “truall”, me sip. 491.66 m<sup>2</sup>, me nr. \*\*\* dhe “ndërtesë me sip. 99.34 m<sup>2</sup>, e papajisur me certifikatë pronësie<sup>9</sup>.
47. Origjina e pronës buron nga babai i bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit, z. L. S., i cili në bazë të vendimit nr. \*\*\*, datë 11.3.1996, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier, është njohur pronar i truallit me sip. 495 m<sup>2</sup>.
48. Më pas kjo pasuri është përfituar nga bashkëshorti i subjektit nëpërmjet kontratës së dhurimit nr. \*\*\*, datë 26.11.1998, dhe disponuar me notë transkriptimi nr. \*\*\* regj., datë 26.2.1998, nga ZVRPP-ja Fier, për pasurinë shtëpi banimi 1-katëshe dhe truall me sipërfaqe 495 m<sup>2</sup>.
49. Nisur nga sa më sipër, për këtë pasuri Komisioni nuk ka konstatuar problematika lidhur me burimet financiare të krijimit apo me deklaramet e subjektit të rivlerësimit.

## **3. Apartament me sipërfaqe 195 m<sup>2</sup> dhe garazh me sipërfaqe 22.2 m<sup>2</sup>, në rrugën “P. R.”, Tiranë**

50. Subjekti i rivlerësimit ka deklaruar në DIPP-në e vitit 2003 një huadhënie në vlerën 60,000 USD shoqërisë së ndërtimit “K.” sh.p.k., në të cilën, sipas këtij deklarimi, ka porositur në vitin 2001 një apartament 3+1 dhe burimi për këtë shumë është deklaruar me të ardhurat nga kredia në Bankën e Kursimeve në vlerën 25,000 USD, si dhe nga të ardhurat familjare në vlerën 35,000 USD. Ndërkohë që në DIPP-në e vitit 2005 subjekti i rivlerësimit ka deklaruar në rubrikën e ndryshimit të pasurive shtimin e dy apartamenteve<sup>10</sup> dhe garazhit në fjalë, duke e shoqëruar me shënimin: “P.s.: pasuritë 1+2+3 janë paguar deri në fund

<sup>9</sup> Në datën 3.6.2019, mbi këtë pasuri është vendosur sekuestro në favor të shoqërisë “D.” sh.p.k.

<sup>10</sup> Tek njëri prej apartamenteve, subjekti ka shënuar në kllapa që në të jetojnë prindërit.

të vitit 2003, 60,000 USD<sup>11</sup> (shihni deklarinimin e vitit 2004<sup>12</sup>) dhe pjesa tjetër deri në momentin e nënshkrimit të kontratave”.

51. Subjekti i rivlerësimit ka deklaruar në deklaratën *Vetting* si burim krijimi të pasurive të sipërcituara (apartament dhe garazh) të ardhurat e përfituara nga:
- i. shuma prej 2,500,000 lekësh nga kredia e marrë në Bankën e Kursimeve dhe e paguar në “Raiffeisen Bank”;
  - ii. shuma prej 30,000 euro, e cila ishte paguar/dhënë nga babai i subjektit T. Ç., si kapar (pagesë paraprake) për blerjen e apartamentit të ndodhur në rrugën “M. Gj.”, Tiranë, sipas kontratës premtim shitjeje nr. \*\*\*, të datës 29.12.2005, dhe kontratës së shitjes me rezervë nr. \*\*\*, datë 12.1.2006;
  - iii. të ardhurat nga pagat, kursimet nga dietat, shërbimet dhe udhëtimet jashtë shtetit (nuk është përcaktuar vlerë);
  - iv. shuma prej 11,500,000 dhrahmi greke përfituar nga bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit si këshilltar i jashtëm i “Tirana Bank” në vitet 1996 - 2001.
52. Këto pasuri të paluajtshme janë përfituar me anë të kontratës së shitblerjes nr. \*\*\*, datë 13.4.2005, për blerjen e apartamentit me sip. 135 m<sup>2</sup>, në shumën 5,500,000 lekë; kontratës së shitblerjes nr. \*\*\*, datë 13.4.2005, për blerjen e apartamentit me sip. 60 m<sup>2</sup>, në shumën 2,707,000 lekë; dhe kontratës së shitblerjes nr. \*\*\*, datë 13.4.2005, për blerjen e garazhit me sip. 22.2 m<sup>2</sup>, në shumën 475,000 lekë<sup>13</sup>.
53. Komisioni, nëpërmjet pyetësorit nr. 2, i ka kërkuar subjektit të rivlerësimit të japë shpjegime lidhur me huadhënien prej 60,000 USD shoqërisë “K.” sh.p.k., si dhe të paraqesë dokumentacionin përkatës mbi mënyrën dhe kohën e kryerjes së pagesave për pasuritë e sipërcituara. Në përgjigje<sup>14</sup> të pyetësorit nr. 2 subjekti i rivlerësimit ka bërë me dije se: *“Nuk ka pasur ndonjëherë kontratë huaje për shumën 60,000 USD me S. K.<sup>15</sup>. Pavarësisht nga përshkrimi si ‘huadhënie’ në deklaratën e pasurisë për herë të parë në vitin 2003, kjo shumë përfaqëson pagesat e kryera nga bashkëshorti dhe pjesërisht nga babai im T. Ç. deri në vitin 2003 për sipërfaqet e porositura tek S. K.. Pagesa e parë e bërë nga bashkëshorti im është bërë në datën 31.7.2001<sup>16</sup>, në shumën 15,000 USD, çka e provojmë me një vërtetim me shkrim dore lëshuar nga S. K. dhe që na kishte mbetur mes dokumenteve të shtëpisë, por deri në datën 31.12.2003 është e sigurt që janë paguar gjithsej 60,000 USD. Diferenca u pagua deri në datën e lidhjes së kontratës së kalimit të pronësisë. Për shkak se S. K. është 81 vjeç, me gjithë kërkesën tonë për të na mundësuar dokumentacionin e mënyrës së pagesave, nëse do ta dispononte, ka qenë e pamundur për shkak të situatës”.*
54. Lidhur me këtë pasuri, Komisioni ka administruar dokumentacionin, si vijon:

<sup>11</sup> Konvertuar në lekë sipas kursit mesatar të fundit të vitit 2001, 60,000 USD = 8,222,400 lekë.

<sup>12</sup> Në deklaratën e vitit 2004 nuk rezulton të ketë deklarinim të ndryshimit të pasurive të subjektit të rivlerësimit, por duket që subjekti i është referuar DIPP-së së vitit 2003, të plotësuar në vitin 2004.

<sup>13</sup> Në total çmimi i pasurive rezulton 8,682,000 lekë.

<sup>14</sup> Referojuni përgjigjes nr. 7 të pyetësorit.

<sup>15</sup> Përfaqësues i shoqërisë “K.” sh.p.k.

<sup>16</sup> Bazuar në vërtetimin me shkrim dore, të datës 31.7.2001, nënshkruar nga shtetasi S. K., ku ka deklaruar se ka marrë shumën 15,000 USD për efekt të zbatimit të kontratës së porosisë nr. \*\*\*, datë 21.7.2001.

- a. ASHK-ja, Tirana Jug, me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 15.10.2019, ka konfirmuar pasurinë me nr. \*\*\*, z. k. \*\*\*, vol. \*\*\*, f. \*\*\*, me sip. 195 m<sup>2</sup>, të regjistruar në emër të shtetasve Th. S. dhe Zegjine Sollaku, e cila rrjedh nga bashkimi i pasurive nr. \*\*\*, me sip. 60 m<sup>2</sup> dhe nr. \*\*\*, me sip. 135 m<sup>2</sup>;
- b. kontratë shitjeje nr. \*\*\*, datë 13.4.2005, për blerjen e apartamentit me sip. 135 m<sup>2</sup>, në shumën 5,500,000 lekë; kontratë shitjeje nr. \*\*\*, datë 13.4.2005, për blerjen e apartamentit me sip. 60 m<sup>2</sup>, në shumën 2,707,000 lekë dhe kontratë shitjeje nr. \*\*\*, datë 13.4.2005, për blerjen e garazhit me sip. 22.2 m<sup>2</sup>, në shumën 475,000 lekë, me palë shitëse S. K. dhe palë blerëse subjektin e rivlerësimit dhe bashkëshortin Th. S.;
- c. kontratë porosie nr. \*\*\*, datë 21.7.2001, ku shtetasi T. C. ka porositur apartamentin me sipërfaqe të përgjithshme prej 115 m<sup>2</sup>, me vlerë 50,600 USD dhe kontratë porosie nr. \*\*\*, datë 21.7.2001, ku z. Th. S. ka porositur apartamentin me sipërfaqe të përgjithshme prej 93 m<sup>2</sup>, me vlerë 40,900 USD;
- d. deklaratë noteriale<sup>17</sup> nr. \*\*\*, datë 13.4.2005, lëshuar nga shtetasi T. Ç., ku ka deklaruar se heq dorë nga pretendimet për pronësinë mbi apartamentin e ndodhur në rrugën “P. R.”, që buron nga kontrata e porosisë së datës 21.7.2001, dhe bie dakord që ky apartament të regjistrohet në emër të subjektit të rivlerësimit (vajzës së saj) dhe bashkëshortit;
- e. kontratë premtim shitjeje nr. \*\*\*, datë 29.12.2005, ndërmjet premtuesit shitës Th. S. dhe blerësit T. Ç., i cili sipas kontratës ka paguar vlerën 30,000 euro nga çmimi total prej 80,000 euro për blerjen e apartamentit me nr. pasurie \*\*\*, z. k. \*\*\*, ndodhur në rrugën “M. Gj.”, Tiranë;
- f. kontratë shitjeje me rezervë nr. \*\*\*, datë 12.1.2006, ndërmjet z. Th. S. në cilësinë e shitësit dhe blerësit T. Ç.<sup>18</sup>;
- g. kontratë huaje për blerje banese nr. \*\*\*, datë 28.2.2002, lidhur ndërmjet z. Th. S. dhe Bankës së Kursimeve;
- h. kontratë hipotekimi nr. \*\*\*, datë 28.2.2002, për vendosjen e apartamentit ekzistues të ndodhur në rrugën “M. Gj.”, Tiranë, për sigurimin e kredisë;
- i. deklaratë noteriale nr. \*\*\*, datë 6.1.2017, e “Raiffeisen Bank” për mbylljen e detyrimeve të kredisë së siguruara me këtë pasuri dhe lirimin e saj nga hipoteka.

### ***Lidhur me burimet e deklaruara për krijimin e pasurive***

#### **Lidhur me shumën prej 2,500,000 lekësh nga kredia bankare**

55. Referuar kontratës së huas me Bankën e Kursimeve për blerje banese, shuma e kredisë së marrë nga bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit në vitin 2002 rezulton të ketë qenë 2,500,000 lekë<sup>19</sup>, me afat 15-vjeçar, e cila rezulton të jetë likuiduar dhe deklaruar rregullisht nga DIPP-ja e vitit 2005 deri në vitin 2015. Ndërkohë në DIPP-në e vitit 2016 nuk është deklaruar nga subjekti i rivlerësimit likuidimi total dhe mbyllja e kredisë.

<sup>17</sup> Në këtë deklaratë nuk rezulton të jetë dhënë informacion lidhur me vlerën e paguar për apartamentin në fjalë nga shtetasi T. Ç. dhe as njohje të ndonjë detyrimi të mbetur/apo të mbartur nga shtetasit Th. dhe Zegjine Sollaku.

<sup>18</sup> Në DIPP-në e vitit 2015, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar kthimin e shumës prej 30,000 euro shtetasit T. Ç. për anulimin e kontratës së shitjes me rezervë.

<sup>19</sup> Për këtë kredi nuk rezulton dokumentacion për transferimin e saj në llogari të palës shitëse.

**Lidhur me shumën 30,000 euro, paguar/dhënë nga babai i subjektit T. Ç.**

56. Nga shqyrtimi i kontratës së premtim shitjes nr. \*\*\*, të lidhur ndërmjet premtuesit shitës Th. S. dhe blerësit T. Ç., është evidentuar se është nënshkruar në datën 29.12.2005 dhe kontrata e shitjes me rezervë me po të njëjtët palë me nr. \*\*\* është lidhur në datën 12.1.2006.
57. Kjo kontratë është nënshkruar në fund të vitit 2005, ndërkohë që në DIPP-në e vitit 2005 subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshorti në deklaratën e këtij viti kanë deklaruar se kanë likuiduar vlerën prej 60,000 USD për blerjen e këtyre pasurive deri në fund të vitit 2003, pra, rreth 2 vite përpara nënshkrimit të kontratës së premtim shitjes me shtetasin T. Ç.. Për më tepër, edhe kontrata e shitblerjes së apartamenteve dhe garazhit është nënshkruar në datën 13.4.2005, pra 8 muaj përpara nënshkrimit të kontratës së premtim shitjes me shtetasin T. Ç. dhe marrjes së vlerës prej 30,000 euro nga ky i fundit.
58. Lidhur me mënyrën dhe kohën e dhënies së shumës 30,000 euro nga shtetasi T. Ç., të deklaruar si burim krijimi për blerjen e pasurive apartament dhe garazh në rrugën “P. R.”, Tiranë, subjekti i rivlerësimit, në përgjigje<sup>20</sup> të pyetësorit nr. 2, ka bërë me dije se: *“Th. S. dhe babai im kanë porositur ndërtimin e 2 apartamenteve (përkatësisht babai apartamentin me sip. 115 m<sup>2</sup>, kundrejt çmimit 50,600 USD dhe bashkëshorti apartamentin me sipërfaqe 93 m<sup>2</sup>, kundrejt çmimit 40,900 USD) tek shtetasi S. K. sipas kontratave të porosisë, datë 21.7.2001. Gjatë kohës që ndërtohej pallati, vëllai im B. Ç. u largua familjarisht në vitin 2002 në Milano/Itali me punë në konsullatë, ndërsa babai i bashkëshortit ndërroi jetë në vitin 2003. Në rrethanat e reja, babai im dhe bashkëshorti bien dakord që gjithë sipërfaqet e porositura tek K. të modifikoheshin në dy apartamente me sipërfaqe ndryshe nga ato të parashikuara në kontratën e porosisë, konkretisht njëri 135 m<sup>2</sup> dhe tjetri 60 m<sup>2</sup>, ngjitur me njëri-tjetrin. Për shkak se këto dy apartamente i përshtateshin më mirë familjes Sollaku për arsye se duhej të jetonte nëna e ve e bashkëshortit pranë nesh, u ra dakord që këto dy apartamente të kalonin në pronësinë tonë, ndërsa babai im T., së bashku me nënën time, të jetonte tek apartamenti ynë në rrugën ‘M. Gj.’ (ku edhe aktualisht jetojnë) me synimin e blerjes në të ardhmen të atij apartamenti. PAGESA prej 30,000 euro nga T. Ç. përfaqëson shumën që ai ka dhënë gjatë 4-5 viteve të ndërtimit të pallatit (me saktësi dihet koha e pagesës prej 10,000 USD që citohet në kontratën e porosisë të nënshkruar me ndërtuesin S. K., ndërsa për pagesat e kësteve të tjera nuk e përcaktojmë dot sepse nga babai im nuk janë ruajtur dëftesat e dorës të dhënë në momentin e pagesës. Ne i kemi njohur babait pagesë paradhënieje për apartamentin në rrugën ‘M. Gj.’. Më pas, meqenëse prindërit e mi nuk patën interes për të paguar edhe pjesën tjetër të shumës sipas kontratës shitje me rezervë, për shkak se vëllai im me familjen qëndruan në Itali, ata hoqën dorë nga synimi për të blerë apartamentin në rrugën ‘M. Gj.’ dhe i kemi kthyer shumën 30.000 euro, duke mbetur në pronësi tonën dhe duke vazhduar të banojnë aty”.*

<sup>20</sup> Referojuni përgjigjes së pyetjes nr. 2 të pyetësorit.



59. Në DIPP-në e vitit 2015 subjekti i rivlerësimit ka deklaruar kthimin e shumës prej 30,000 euro shtetasit T. Ç., për anulimin e kontratës së shitjes me rezervë për blerjen e apartamentit të ndodhur në rrugën “M. Gj.”, Tiranë.
60. Lidhur me të ardhurat që kanë mundësuar pagimin e shumës prej 30,000 euro nga babai i subjektit të rivlerësimit T. Ç., subjekti ka paraqitur në përgjigje të pyetësorit nr. 3, dokumentacionin, si vijon:
- a. vërtetim nr. \*\*\* prot., datë 19.3.2020, lëshuar nga Bashkia Peqin, e cila ka konfirmuar se për periudhën maj 1963 – shtator 2004 babai i subjektit T. Ç. ka bashkëjetuar me të birin B. Ç. në të njëjtën banesë;
  - b. vërtetim nr. \*\*\* prot., datë 15.6.2020, nga ISSH-ja Tiranë për të ardhurat e realizuara nga pagat e z. T. Ç. për periudhën shtator 1990 – gusht 1993 dhe të ardhurat nga pensionet për periudhën gusht 1994 e në vijim;
  - c. deklaratë noteriale nr. \*\*\*, datë 13.6.2020, lëshuar nga shtetasi D. Ç., në të cilën është shprehur se është vëllai i z. T. Ç. dhe se përgjatë periudhës 1994 – 1999<sup>21</sup> ky i fundit e ka ndihmuar në dyqanin e tij me furnizimet dhe ka përfituar shpërblim mujor në shumat, përkatësisht 35,000 lekë për periudhën shtator 1994 – 1995, 40,000 lekë për vitin 1996 dhe 50,000 lekë për periudhën 1997 – mars 1999;
  - d. vërtetim nr. \*\*\* prot., datë 29.5.2020, nga Drejtoria e Taksave Vendore Peqin, e cila ka konfirmuar se shtetasi D. Ç. ka ushtruar dy veprimtari gjatë periudhës 1992 – 2004, përkatësisht kinkalери dhe materiale ndërtimi;
  - e. deklaratë noteriale nr. \*\*\*, datë 2.7.2020, lëshuar nga shtetasi L. Ç., i cili ka deklaruar se në magazinat e tij me artikuj elektrikë, ku furnizoheshin shumë subjekte tregtare, furnizohej edhe z. T. Ç. për llogari të vëllait të tij;
  - f. vërtetim nr. \*\*\* prot., datë 15.6.2020, nga ISSH-ja Tiranë, për të ardhurat e realizuara nga pagat e shtetasës M. Ç. (nëna e subjektit të rivlerësimit) për periudhën janar 1987 – dhjetor 1989 dhe të ardhurat nga pensionet për periudhën dhjetor 1991 e në vijim;
  - g. shkresë nr. \*\*\* prot., datë 28.5.2020, e Ministrisë për Europën dhe Punët e Jashtme, se shtetasi B. Ç. (vëllai i subjektit të rivlerësimit) ka qenë i punësuar në Konsullatën e Milanos për periudhën 2002 – 2006 dhe ka marrë shpërblim mujor në vlerën 520 USD/muaj deri në tetor të vitit 2003 dhe më pas 558 euro/muaj. Gjithashtu, ka konfirmuar se nga buxheti i shtetit janë mbuluar qiraja e apartamentit, dritat, uji dhe gazi;
  - h. vërtetim nr. \*\*\* prot., datë 26.5.2020, nga Zyra Arsimore Peqin për të ardhurat e realizuara nga shtetasja M. Ç. (nusja e vëllait të subjektit);
  - i. kontratë shitblerjeje nr. \*\*\*, datë 24.3.1999, në të cilën z. T. Ç. ka blerë dyqanin e ndodhur në lagjen “Xh.”, Peqin, nga pala shitëse F. M., kundrejt çmimit 1,500,000 lekë;
  - j. kontratë shitblerjeje, datë 10.9.2006, në të cilën z. T. Ç. i ka shitur shtetasit A. C. një truall me sip. 20 m<sup>2</sup> dhe një dyqan me sipërfaqe 19 m<sup>2</sup>, kundrejt çmimit total prej 3,200,000 lekësh dhe një deklaratë dore (e panoterizuar) e nënshkruar nga palët në 18.11.2005, ku blerësi A. C. ka deklaruar se në 18.11.2005 ka dhënë shumën prej

---

<sup>21</sup> Lidhur me të ardhurat përgjatë kësaj periudhe, nga dokumentacioni i vënë në dispozicion nuk provohet të jenë paguar detyrime tatimore për pagat/shpërblimet e pretenduara nga z. T. Ç..

- 2,500,000 lekësh si parapagim dhe diferenca prej 700,000 lekësh do të paguhet në momentin e lidhjes së kontratës së shitjes;
- k. certifikatë regjistrimi në organin tatimor të aktivitetit të vëllait të subjektit të rivlerësimit B. Ç. me NIPT nr. \*\*\*, me objekt “tregti artikuj të ndryshëm”, regjistruar në datën 13.1.2000;
  - l. vërtetim nr. \*\*\* prot., datë 15.1.2019, nga Drejtoria e Taksave Vendore Peqin mbi detyrimet e shlyera për taksat dhe tarifave vendore, nga shtetasi B. Ç., gjatë periudhës 1999 – 2006, por pa përcaktuar ndonjë të dhënë mbi xhirot apo fitimet e realizuara.
61. Nisur nga përmbajtja e dokumentacionit të mësipërm, i paraqitur nga subjekti i rivlerësimit në përgjigje të pyetësorëve nr. 2, dhe nr. 3, konstatohet se të ardhurat nga pagesa paraprake prej 2,500,000 lekësh nga shitja e dyqanit të babait të subjektit të rivlerësimit T. Ç., të cilat edhe nëse do të konsideroheshin, janë përfituar në nëntor të vitit 2005, pra, pas nënshkrimit të kontratave të shitblerjes së pasurive në prill të vitit 2005 dhe, për rrjedhojë, nuk mund të përfshihen si burim për pagesat e kryera deri në këtë moment.
  62. Lidhur me aktivitetin e vëllait të subjektit të rivlerësimit B. Ç., Komisioni i ka kërkuar të dhëna tatimore DRT-së Elbasan, e cila, me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 30.12.2020, ka bërë me dije se ky aktivitet është regjistruar si Person Fizik në datën 30.1.2003 dhe ka kaluar në status “pasiv”, po në datën 30.1.2003 dhe, për rrjedhojë, nuk ka realizuar dhe deklaruar të ardhura dhe fitime ndër vite. Nisur nga vërtetimi i lëshuar nga Bashkia Peqin mbi pagesat e taksave dhe tarifave vendore nga ky aktivitet në këtë institucion, Komisioni iu ridrejtoi DRT-së Elbasan për të riverifikuar të dhënat tatimore të disponuara për aktivitetin në fjalë. Në përgjigje të saj, DRT-ja Elbasan, me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 19.1.2021, ka rikonfirmuar të njëjtin informacion të përcjellë më parë, duke bërë me dije gjithashtu se nuk disponojnë informacion tjetër shtesë jashtë të dhënave që gjenden në sistemin informatik tatimor.
  63. Komisioni i ka kërkuar gjithashtu Bashkisë Peqin për të vënë në dispozicion të gjitha të dhënat e disponuara mbi aktivitetin në fjalë, duke bërë me dije mbi detyrimet konkrete të taksave dhe tarifave vendore të paguara gjatë periudhës 1999 – 2005. Në përgjigje të kërkesës së Komisionit, Bashkia Peqin, me shkresës nr. \*\*\* prot., datë 26.1.2021, ka paraqitur të dhënat mbi qarkullimin<sup>22</sup> vjetor të vetëdeklaruar nga shtetasi B. Ç., si dhe llojin e taksave të paguara përgjatë periudhës së kërkuar. Nga përmbajtja e shkresës është konstatuar se detyrimet e paguara përfshijnë vetëm taksa dhe tarifa vendore (si taksë ndërtese, pastrimi, reklame, zënie të hapësirës publike, si dhe tarifë shërbimi) dhe nuk ka rezultuar pagimi i ndonjë detyrimi tatimor pranë këtij institucioni.
  64. Në këto kushte, me aq sa është disponuar nga Komisioni, ndonëse është provuar ekzistenca e aktivitetit tregtar, në mungesë të të dhënave tatimore lidhur me fitime të mundshme të realizuara nga aktiviteti i shtetasis B. Ç. si Person Fizik dhe/apo detyrime tatimore të mundshme të paguara, Komisioni nuk ka përfshirë në analizë të ardhura të mundshme nga

<sup>22</sup> Qarkullimet vjetore të parashikuara nga aktiviteti kanë qenë përkatësisht: në vitin 1999 – shuma 1,185,000 lekë; në vitin 2000 – shuma 1,320,000 lekë; në vitin 2001 – shuma 1,400,000 lekë; në vitin 2002 – shuma 1,360,000 lekë; në vitin 2003 – shuma 1,500,000 lekë; në vitin 2004 – shuma 1,780,000 lekë; dhe në vitin 2005 – shuma 1,100,000 lekë.

ky aktivitet, si një burim i ligjshëm, për sa kohë nuk plotësojnë kriteret e parashikuara nga neni D i Aneksit të Kushtetutës.

65. Komisioni ka përllogaritur të ardhurat e dokumentuara dhe brenda hapësirës kohore të kryerjes së pagesave, si dhe shpenzimet jetike<sup>23</sup> për familjen e babait të subjektit të rivlerësimit T. Ç., duke filluar nga viti 1987 e deri në mars të vitit 2005, nisur nga fakti që kontratat e shitblerjes me palën shitëse janë nënshkruar në datën 13.4.2005 dhe nuk janë të përcaktuara saktësisht momentet e kryerjes së pagesave nga ky i fundit.
66. Duke përmbledhur të gjitha të ardhurat e dokumentuara të familjes Ç. dhe pas përllogaritjes së shpenzimeve jetike dhe të investimit të kryer në vitin 1999, ka rezultuar një pamundësi financiare në vlerën negative prej 5,843,963 lekësh.

**Tabela nr. 2** – mundësia e kursimit të shumës 30,000 euro nga familja Ç.

Të ardhura nga paga T*** C***	44,724
Të ardhura nga pensioni T*** C***	668,095
Të ardhura nga paga M*** C***	24,053
Të ardhura nga pensioni M*** C***	702,384
Të ardhura nga aktiviteti B*** C***	-
Të ardhura nga paga B*** C***, Itali	2,464,408
Të ardhura nga paga M*** C***	1,033,279
Shpenzime për blerje dyqani në vitin 1999	- 1,500,000
Shpenzime për pagesën 30,000 Euro	- 4,009,500
Shpenzime jetese	- 5,271,406
<b>Rezultati</b>	<b>- 5,843,963</b>

67. Nisur nga sa më sipër, u konstatua se personat e tjerë të lidhur nuk kanë pasur mundësi për pagimin e shumës prej 30,000 euro, si dhe njëkohësisht të përballonin shpenzimet e jetesës së bashku me investimet e tjera të kryera përgjatë periudhës 1987 – mars 2005, me burime të ligjshme financiare.

**Lidhur me shumën 11,500,000 dhrahmi (GRD), të përfituar prej bashkëshortit të subjektit si këshilltar i jashtëm në “Tirana Bank”, në vitet 1996 - 2001**

68. Subjekti i rivlerësimit ka deklaruar në deklaratën *Vetting* si një ndër burimet edhe të ardhurat e bashkëshortit si konsulent i jashtëm juridik në “Tirana Bank”, në masën totale prej 11,500,000 GRD (ekuivalenti 4,417,725 lekë).

<sup>23</sup> Për përllogaritjen e shpenzimeve jetike është konsideruar: për periudhën 1987 – 1996 shpenzimi në masën 66 % të të ardhurave; për periudhën 1997 – 1999 në masën 5,000 lekë/frymë në muaj; për periudhën 2000 – 2001 sipas të dhënave zyrtare të INSTAT-it për 6 frymë (z. B. Ç. me bashkëshorten dhe 2 fëmijë së bashku me z. T. Ç. dhe bashkëshorten), për periudhën 2002 – mars 2005 sipas të dhënave zyrtare të INSTAT-it për z. T. Ç. dhe bashkëshorten dhe për periudhën 2002 – 2005 sipas të dhënave zyrtare të www.istat.it për z. B. Ç. dhe familjen e tij. Në përllogaritjen e shpenzimeve të Italisë, nga shpenzimet minimale mujore referuar të dhënave në nivelin e varfërisë për vitet 2002 - 2005, janë zbritur 42.8% të shpenzimeve, të cilat përbëjnë koston për strehim dhe transport, që janë konsideruar të mbuluara nga buxheti i shtetit, referuar vërtetimit të Ministrisë për Europën dhe Punëve të Jashtme. <http://seriestoriche.istat.it/> dhe <https://www.istat.it/en/files/2011/06/italyinfingures2004.pdf>.

69. Nga dokumentacioni i administruar nga Komisioni ka rezultuar se në llogarinë bankare në “Tirana Bank”, të bashkëshortit të subjektit Th. S., janë transferuar përkatësisht shumat 2,200,000 GRD në vitin 2000 dhe 1,100,000 GRD në vitin 2001 (në total ekuivalenti prej 1,267,695 lekësh), por nuk mund të evidentohet nga kush dhe për çfarë qëllimi ishin kryer transfertat.
70. Për një sqarim të mëtejshëm, Komisioni i ka kërkuar “Tirana Bank” të bëjë me dije mbi marrëdhënie të mundshme punësimi apo shërbimi me bashkëshortin e subjektit, gjatë periudhës së pretenduar 1996 – 2001, duke paraqitur dokumentacionin përkatës mbi të ardhurat e përfituara dhe pagimin e detyrimeve tatimore, si dhe të saktësojë dërguesin e transfertave të mësipërme.
71. Në përgjigje të kërkesës së Komisionit, “Tirana Bank”, me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 21.1.2021, ka bërë me dije se duke pasur parasysh që kanë kaluar rreth 20 vjet nga kryerja e shërbimit, si dhe në bazë të legjislacionit dhe politikave të arkivimit të bankës, kjo e fundit e ka të pamundur ofrimin e materialit të kërkuar. Por, ka konfirmuar se pagesat e kryera në llogari të shtetasit Th. S. në vitet 2000 dhe 2001 janë kryer nga “Tirana Bank”, bazuar në kontratën e shërbimit mes tyre, si dhe për këto pagesa banka ka mbajtur në burim tatimin mbi të ardhurat në masën e aplikueshme në kohën e pagesës.
72. Në vijim të veprimeve hetimore, Komisioni i ka kërkuar informacion DPT-së mbi detyrime të mundshme të tatimit në burim të paguara në favor të shtetasit Th. S. nga “Tirana Banka”. Drejtoria e Hetimit Tatimor në DPT, me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 18.1.2021, ka bërë me dije se për periudhën e kërkuar nuk ka të dhëna në sistem për detyrimin e tatimit në burim.
73. Po ashtu, Komisioni i ka kërkuar Drejtorisë së Arkivit Qendror të ISSH-së të dhëna të disponuara lidhur me paga të mundshme apo periudha kontribuuese për punësimin e bashkëshortit të subjektit në “Tirana Bank” në periudhën 1996 – 2001. Drejtoria e Arkivit Qendror të ISSH-së, me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 13.1.2021, ka bërë me dije se nga verifikimet e bëra në dosjen e “Tirana Bank” për periudhën 1996 – 2001, nuk figuron emri i bashkëshortit të subjektit.
74. Ndonëse këto të ardhura nuk janë specifikuar konkretisht si burim për pagesat e kryera deri në vitin 2003, është konstatuar se në rubrikën përkatëse të të ardhurave të DIPP-së së vitit 2003 subjekti, ndër të tjera, ka deklaruar edhe përfitimin e të ardhurave nga punësimi i bashkëshortit si konsulent i jashtëm juridik në “Tirana Bank”, për periudhën 1996 – 2001, pa specifikuar shumën e përfituar.
75. Për një qartësim të mëtejshëm, Komisioni iu drejtua ILDKPKI-së, me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 8.1.2021, duke i kërkuar të gjithë dokumentacionin e mundshëm të dorëzuar bashkëlidhur deklaratave të vitit 2003, nga subjekti i rivlerësimit dhe/apo bashkëshorti i saj, e cila me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 25.1.2021, ka bërë me dije se të dy subjektet deklarues nuk kanë dorëzuar dokumentacion bashkëlidhur deklaratave të vitit 2003<sup>24</sup>.

<sup>24</sup> ILDKPKI-ja ka vënë në dispozicion një procesverbal të datës 18.5.2015, të subjektit të rivlerësimit. Në këtë procesverbal, lidhur me të ardhurat e përfituara nga “Tirana Bank”, subjekti është përgjigjur se banka mundi të konfirmonte vetëm dy vite 2000 dhe 2001, duke sqaruar se nuk dispononte informacion për vitet 1996 - 1999.

76. Në përfundim të sa më sipër, Komisioni ka njohur në këtë fazë të hetimeve si të ardhura me burim të ligjshëm vetëm ato të përfituara në vitet 2000 dhe 2001, në shumën totale 3,300,000 GRD (ekuivalenti 1,267,695 lekë), për të cilat ka rezultuar e provuar marrëdhënia e punësimit me “Tirana Bank” dhe kanalizimi i të ardhurave nëpërmjet bankës.

### **Lidhur me të ardhurat nga pagat dhe kursimet nga dietat, shërbimet dhe udhëtimet jashtë shtetit**

77. Për sa i përket këtij burimi, përveç të ardhurave nga pagat në punësimet përkatëse të subjektit të rivlerësimit dhe të bashkëshortit, të ardhurat e tjera të pretenduara nga kursimet nga dietat, shërbimet dhe udhëtimet jashtë shtetit – siç është sqaruar edhe më lart, referuar orientimeve të KPA-së<sup>25</sup> – dietat jepen me qëllim rimbursimin e shpenzimeve dhe jo për kursim.

### **Analiza financiare e pagesave të kryera**

78. Referuar dokumentacionit të paraqitur nga subjekti në përgjigje të pyetësorit nr. 2, si dhe bazuar në deklaratimet e saj në DIPP-të përkatëse, është konstatuar se bashkëshorti dhe babai i subjektit kanë paguar për blerjen e këtyre apartamenteve kështu, si më poshtë:

- a. në vitin 2001, shumën 25,000 USD<sup>26</sup> (ekuivalenti 3,426,000 lekë);
- b. në vitin 2002, shumën 2,500,000 lekë nga kredia në Bankën e Kursimeve;
- c. në vitin 2003, shumën 595,400 lekë (shuma e mbetur nga 60,000 USD të paguara në total deri në fund të këtij viti);
- d. në vitin 2005, shumën 2,160,600 lekë (kësti i fundit).

79. Lidhur me pagesën e kështit të parë prej 25,000 USD, të kryer në vitin 2001, më konkretisht 10,000 USD në datën 21.7.2001 dhe 15,000 USD në datë 31.7.2001, nga shqyrtimi i lëvizjeve bankare të bashkëshortit të subjektit në “Tirana Bank” janë konstatuar tërheqjet e kryera prej këtij të fundit, përkatësisht 10,000 USD më 19.7.2001 dhe 17,400 USD më 31.7.2001. Po ashtu, është konstatuar se këto shuma janë derdhur *cash* po prej bashkëshortit të subjektit, përkatësisht në datën 13.7.2001 – shuma 15,000 USD dhe në datën 31.7.2001 – shuma 10,330 USD<sup>27</sup>.

80. Komisioni ka kryer analizën financiare të familjes së subjektit, duke marrë në konsideratë vetëm të ardhurat e periudhës dhjetor 2000 – korrik 2001<sup>28</sup>, të cilat kanë rezultuar në masën 1,257,842 lekë<sup>29</sup>. Ka rezultuar se gjatë kësaj periudhe, bashkëshorti i subjektit i ka dhënë

<sup>25</sup> Vendimi nr. 7/2019 (JR), datë 5.4.2019.

<sup>26</sup> Nga të cilat shuma 10,000 USD paguar nga z. T. Ç., referuar kontratës së porosisë dhe shuma 15,000 USD paguar nga z. Th. S. në datën 31.7.2001, referuar vërtetimit të dorës nënshkruar nga z. S. K..

<sup>27</sup> Përpara këtyre dy derdhjeve *cash*, në llogarinë e bashkëshortit të subjektit ka pasur disa transfertat dhe derdhje me shtetasit L. M. dhe M. M.. Pasi është pyetur nga Komisioni lidhur me arsyet e kryerjes së transfertave dhe derdhjeve në fjalë, në përgjigje të pyetësorit nr. 6, subjekti ka bërë me dije se me shtetasin L. M. kanë pasur marrëdhënie shoqërore të ngushta dhe këto transfertat parash kanë qenë marrëdhënie huaje. Më konkretisht, bashkëshorti i subjektit i ka dhënë hua z. L. M. shumën prej 22,000 USD, i cili ia ka kthyer nëpërmjet transfertës së datës 7.4.2000, në shumën 15,600 USD dhe derdhjes së datës 20.3.2001, në shumën 6,520 USD. Në vijim, bashkëshorti i ka dhënë sërish hua z. L. M. shumën prej 17,500 USD në datën 13.4.2001, dhe ky i fundit i ka kthyer nëpërmjet transfertës së datës 28.12.2001 shumën prej 10,000 USD dhe 7,500 USD *cash*.

<sup>28</sup> Për sa kohë në nëntor të vitit 2000 bashkëshorti i subjektit ka kryer një investim në shumën 10,000 USD për blerjen e një pasurie të llojit “tokë arë”, e cila është analizuar në pasuritë nr. 5 dhe nr. 6.

<sup>29</sup> Të ardhurat nga pagat e subjektit dhe të bashkëshortit, si dhe pagesat e përfituara si anëtar këshilli dhe Shkolla e Magjistraturës, janë konsideruar në mënyrë përpjesëtimore në raport me të ardhurat totale të vitit. Ndërsa të ardhurat e

hua në shumën 17,500 USD shtetasit L. M., referuar përshkrimin të transfertës dhe shpjegimeve të subjektit të rivlerësimit në përgjigje të pyetësorit nr. 6. Nisur nga fakti që deri në këtë fazë të hetimit marrëdhënia e huas me shtetasin L. M. nuk është e konfirmuar, në kuptim të pikës 4, të nenit 32, të ligjit nr. 84/2016, si dhe nuk është i provuar burimi i ligjshëm i të ardhurave që kanë mundësuar kthimin e shumave prej tij, Komisioni nuk i ka përfshirë këto në analizën financiare.

81. Pas përllogaritjes së shpenzimeve ka rezultuar se për kryerjen e pagesës së këstit të parë në shumën 25,000 USD (ekuivalenti prej 3,426,000 lekë), subjekti i rivlerësimit ka pasur një mungesë të burimeve të ligjshme financiare prej 2,262,174 lekësh. Pagesa e këstit të dytë prej 2,500,000 lekësh është kryer me burim nga kredia e marrë në Bankën e Kursimeve, nëpërmjet kontratës së kredisë nr. \*\*\*, datë 28.2.2002, për të cilën nuk janë konstatuar problematika.
82. Referuar deklarimeve të subjektit, sipas të cilave deri në fund të vitit 2003 është paguar në total shuma prej 60,000 USD, pas zbritjes së dy kësteve të para të paguara rezulton se kësti i tretë i paguar ka qenë në masën 595,400 lekë.
83. Komisioni, në mungesë të një afati/momenti të saktë të kryerjes së kësaj pagese, ka kryer një përllogaritje të të gjitha të ardhurave, shpenzimeve, likuiditeteve në llogaritë bankare dhe investimeve të ndërmjetme<sup>30</sup>, të kryera nga subjekti dhe bashkëshorti, përgjatë periudhës korrik 2001 deri në fund të vitit 2003, nga ku ka rezultuar një mungesë e burimeve të ligjshme financiare prej 1,119,753 lekësh për të kryer të gjitha shpenzimet, si dhe pagesën e këstit të tretë prej 595,400 lekësh për blerjen e apartamentit në Fier në shumën 1,900,000 lekë<sup>31</sup> dhe blerjen e pasurisë së llojit “tokë arë” në L., në shumën 600,000 lekë<sup>32</sup>.
84. Lidhur me diferencën prej 2,160,600 lekësh nga çmimi total 8,682,000 lekë i pasurive në fjalë, të paguar deri në mars të vitit 2005<sup>33</sup>, në DIPP-në e vitit 2004, subjekti nuk ka deklaruar ndonjë pagesë të kryer në favor të shoqërisë së ndërtimit “K.” sh.p.k. dhe, për rrjedhojë, është konsideruar e paguar në vitin 2005.
85. Nga hetimi administrativ ka rezultuar se në datën 17.2.2005 bashkëshorti i subjektit ka shitur një apartament të ndodhur në lagjen “\*\*\*\*”, Fier, kundrejt çmimit total 45,000 USD (ekuivalenti 4,649,850 lekë). Nga shqyrtimi i lëvizjeve bankare evidentohet se kjo shumë e depozituar në llogari të bashkëshortit të subjektit në “Tirana Bank” në datën 18.2.2005, ka vazhduar të qëndrojë në këtë llogari deri në vitin 2007, pa u tërhequr<sup>34</sup>, në këto kushte, kjo e ardhur nuk mund të shërbente si burim për kryerjen e pagesës në fjalë.

---

përfituara nga “Tirana Bank”, të cilat janë kanalizuar nëpërmjet llogarisë bankare, janë konsideruar ato të përfiturat deri në fund të muajit korrik të vitit 2001.

<sup>30</sup> Në të cilën janë përfshirë dy investime të kryera nga subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshorti përgjatë kësaj periudhe, konkretisht blerja e një toke arë në L., Tiranë, në shumën 600,000 lekë dhe blerja e një apartamenti në Fier në shumën 1,900,000 lekë.

<sup>31</sup> Të blerë me kontratën e shitblerjes nr. \*\*\*, datë 17.9.2003.

<sup>32</sup> Të blerë me kontratën e shitblerjes nr. \*\*\*, datë 14.10.2003.

<sup>33</sup> Referuar deklaramin të subjektit të rivlerësimit, shuma prej 60,000 USD është paguar deri në fund të vitit 2003 dhe diferenca deri në momentin e nënshkrimit të kontratave të shitblerjes në prill të vitit 2005.

<sup>34</sup> Ka një tërheqje prej 15,000 USD në janar të vitit 2007 dhe riderdhe të së njëjtës shumë në shtator të vitit 2007.

86. Nga shqyrtimi i DIPP-së së vitit 2004 të bashkëshortit të subjektit, ky i fundit ka deklaruar gjendje *cash* në shumën 1,500,000 lekë, për të cilën është pyetur nga Komisioni subjekti i rivlerësimit, e cila ka shpjeguar në përgjigje të pyetësorit nr. 5 se kjo shumë e deklaruar në vitin 2004 është pakësuar me 600,000 lekë në vitin pasardhës, viti 2005, për arredimin e apartamentit të ndodhur në rrugën “Perlat Rexhepi”, Tiranë, dhe pjesa tjetër në fund të vitit 2006<sup>35</sup>. Nga sa më sipër, duket se kjo shumë e disponuar *cash* nuk mund të ishte përdorur për pagesën e kryer për apartamentin në vitin 2005.
87. Si pasojë e sa më sipër, Komisioni ka përllogaritur të ardhurat e familjes së subjektit për periudhën janar – mars 2005 dhe nga dokumentacioni i administruar ka rezultuar se subjekti dhe bashkëshorti i saj kanë realizuar të ardhura gjatë 3-mujorit të parë të vitit 2005, në masën 758,160 lekë.
88. Pas përllogaritjes së shpenzimeve përgjatë të njëjtës periudhë, ka rezultuar se subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshorti kanë pasur një mungesë të burimeve të ligjshme financiare për pagimin e këstit të fundit për blerjen e pasurive në fjalë, siç është detajuar në rezultatet<sup>36</sup> e mëposhtme, të cilat i janë njoftuar edhe subjektit të rivlerësimit pas mbylljes së hetimit administrativ, duke i kaluar barrën e provës:
- Duket se ka pasaktësi lidhur me deklarin në DIPP-në e vitit 2003 të shumës së kredisë së marrë në Bankën e Kursimeve, ku deklarohet 25,000 USD<sup>37</sup> krahasuar me kontratën e huas që përshkruan një kredi prej 2,500,000 lekësh.
  - Duket se babai i subjektit të rivlerësimit T. Ç. nuk ka pasur mjaftueshmëri të burimeve të ligjshme financiare për pagimin e shumës prej 30,000 euro.
  - Nga analiza financiare duket se subjekti i rivlerësimit ka pasur një mungesë të burimeve të ligjshme financiare për kryerjen e pagesës së këstit të parë të pasurive në analizë, prej 2,262,174 lekësh.
  - Nga analiza financiare duket se subjekti i rivlerësimit ka pasur një mungesë të burimeve të ligjshme financiare për kryerjen e pagesës së këstit të tretë të pasurive në analizë dhe investimeve të tjera në vitin 2003, prej 1,119,753 lekësh.
  - Nga analiza financiare duket se subjekti i rivlerësimit, për pagimin e këstit të katërt dhe të fundit për blerjen e pasurive në fjalë, në shumën 2,160,600 lekë, ka pasur një mungesë të burimeve të ligjshme financiare në masën 1,649,291 lekë.

### **Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit**

89. Pasi është njohur me rezultatet e mësipërme, subjekti i rivlerësimit, në mënyrë të përmbledhur ka pretenduar sa vijon. Lidhur me pagesat e apartamenteve shoqërisë së ndërtimit “K.” sh.p.k., subjekti ka paraqitur dy shkresa të thjeshta me shkrim dore, të pagesave të kryera nga babai i saj për apartamentin e porositur prej tij, përkatësisht në

<sup>35</sup> Për sa kohë nga subjekti apo bashkëshorti nuk është deklaruar ndonjë pakësim apo gjendje e mbetur në DIPP-në e vitit 2006, nga Komisioni është konsideruar e zezuar e gjithë shuma në vitin 2005.

<sup>36</sup> Ky rezultat përfshin vetëm periudhën deri në momentin e blerjes së pasurisë, ndërkohë që analiza financiare e të gjithë vitit 2005 është me një balancë negative më të ulët për shkak të konsiderimit në të, të të gjithë të ardhurave të vitit.

<sup>37</sup> Konvertuar me kursin mesatar të fundit të vitit 2002 të marrjes së kredisë me 134.966, ku 25,000 USD = 3,374,150 lekë.

shumën 10,000 USD në datën 20.7.2001, dhe në shumën 15,000 USD në datën 31. 7.2001, duke specifikuar se prej bashkëshortit të saj është paguar shuma prej 15,000 USD dhe 2,500,000 lekë nëpërmjet kredisë së marrë, ndërsa babai i saj ka paguar në total shumën 25,000 USD (shumë kjo që është konvertuar në 30,000 euro). Në këtë mënyrë, subjekti është shprehur se shuma totale prej 40,000 USD është paguar që në vitin 2001 dhe shuma prej 2,500,000 lekësh në vitin 2002 dhe, për rrjedhojë, ka pretenduar se në vitin 2003 nuk ka kryer më pagesë (krahasuar me shumën prej 595,400 lekësh të përlllogaritur në rezultatet e hetimit), ndërsa në vitin 2005 ka paguar vetëm shumën e mbetur prej 700,000 lekësh (krahasuar me shumën 2,160,000 lekë të përlllogaritur në rezultatet e hetimit).

90. Gjithashtu, subjekti ka pretenduar se babai i saj nuk duhet të konsiderohet si person tjetër i lidhur, për sa kohë nuk kanë pasur një marrëdhënie interesi me objekt dhurimi apo huamarrjeje. Megjithatë, subjekti ka paraqitur një deklaratë noteriale të datës 18.6.2021, të shtetasit V. K., i cili është shprehur se në vitin 2001 i ka dhënë hua babait të saj shumën prej 25,000 USD, duke vënë në dispozicion dy kontrata shitblerjeje të viteve 1999 dhe 2001, të cilat kanë shërbyer si burimi i të ardhurave të deklaruesit të sipërcituar.
91. Sa i përket të ardhurave të bashkëshortit nga “Tirana Bank”, si këshilltar i jashtëm, subjekti ka paraqitur një vërtetim të datës 21.6.2021, të lëshuar nga kjo bankë, e cila ka konfirmuar se shtetasi Th. S. ka qenë këshilltar për periudhën shtator 1996 – 31 dhjetor 2001 dhe për periudhën 1996 – 1999 pagesa mujore ka qenë 200,000 GRD/muaj. Banka ka mbajtur tatimin sipas legjislacionit në fuqi për çdo pagesë të kryer, si dhe ka bërë me dije se për shkak të ndryshimeve në sistemet e bankës nxjerrja e ekstrakteve të mëparshme nuk është e mundur.
92. Lidhur me marrëdhënien e huamarrjes/huadhënies me shtetasin L. M., nëpërmjet prapësimeve, subjekti ka paraqitur një deklaratë noteriale të këtij shtetasi, i cili ka konfirmuar marrëdhëniet në fjalë, duke bërë me dije se ajo ka filluar në vitin 1999, kur bashkëshorti i subjektit i ka dhënë hua shumën 22,000 USD, të cilën ia ka kthyer në vitet 2000 dhe 2001, dhe më pas në vitin 2001 i ka dhënë sërish hua shumën 17,500 USD, të cilën ia ka kthyer në dhjetor të vitit 2001 dhe fillim të vitit 2002. Sa i përket të ardhurave dhe burimit të ligjshëm të shtetasit L. M. për të kthyer shumat e marra hua, subjekti ka vënë në dispozicion dy kontrata qiraje të nënshkruara prej këtij të fundit si qiradhënës dhe “Tirana Bank” si qiramarrës, sipas të cilës qiraja mujore ka qenë nga viti 1996 në vlerën 8,000 USD/muaj dhe nga viti 2001 në vlerën 9,000 USD/muaj.
93. Gjithashtu, në mbështetje të sa ka pretenduar dhe argumentuar, subjekti i rivlerësimit bashkë me prapësimet, ka paraqitur në cilësinë e provave të reja dokumentet e mëposhtme:
  - a. dy shkresa dore të vitit 2001, të cilat tregojnë pagesat e kryera nga babai i subjektit në favor të shoqërisë “K.” sh.p.k., të shumës prej 25,000 USD;
  - b. deklaratë noteriale e shtetasit V. K.; dy kontrata shitjeje të pasurive të paluajtshme nga huadhënësi V. K., në shumën totale prej 3,850,000 lekësh; vendimet e gjykatës për regjistrimin e aktiviteteve të shtetasit V. K.;
  - c. vërtetim nga “Tirana Bank” për të ardhurat e bashkëshortit të subjektit si këshilltar i jashtëm për periudhën shtator 1996 – dhjetor 2001;



d. deklaratë noteriale e shtetasit L. M. që konfirmon marrëdhëniet e huamarrjes me bashkëshortin e subjektit në vitin 2001, si dhe dy kontrata qiraje të këtij shtetasi me “Tirana Bank” të viteve 1996 dhe 2001.

### **Vlerësimi i trupit gjykues**

94. Trupi gjykues, në vijim të analizimit dhe shqyrtimit të provave të paraqitura nga subjekti, vlerëson se lidhur me saktësimin e shpërndarjes së shumave të paguara në periudhën 2001 – 2005 dhe të pagesave të kësteve përkatës për këtë pasuri, në mungesë të provës së kundërt, përlllogaritja e investimeve në fjalë do të kryhet sipas përcaktimeve qartësuese të subjektit, për aq sa ato përkojnë me deklaratimet në DIPP-të përkatëse, dhe konkretisht: shuma 40,000 USD në vitin 2001; shuma 2,500,000 lekë në vitin 2002; si dhe shuma 700,400 lekë në vitin 2005. Lidhur me moskonsiderimin e babait të subjektit si një person tjetër i lidhur, trupi gjykues çmon se, për sa kohë ky i fundit ka kryer pagesa të pretenduara nga të ardhurat e tij, të cilat më pas janë përlllogaritur si pjesë përbërëse e çmimit total të pasurive të përfituara nga subjekti dhe familja e saj, bazuar në dispozitat ligjore përkatëse, por edhe në jurisprudencën e deritanishme të procesit të rivlerësimit, pikërisht për këtë shkak-pasojë detyrimisht duhet të analizohen burimet financiare të shtetasit T. Ç. – kjo pavarësisht paqartësisë dhe mosdeklarimit nga subjekti mbi tipologjinë e përfitimit të shumës prej 25,000 USD nga të ardhurat e babait të saj. Nëse ato janë kthyer apo do të kthehen, gjendemi përballë një huadhënieje, ndonëse e padeklaruar si e tillë, dhe në rast moskthimi të shumave të përfituara marrëdhënia financiare e lartpërshkruar do të futej pa dyshim në kornizën e një dhurimi. Kësisoj, në çdo rast mbetet detyrimi i subjektit të rivlerësimit për të provuar burimet e ligjshme të shumave monetare të përfituara dhe të përdorura/konsideruara si pjesë e çmimit të pasurisë së saj.
95. Sa i përket deklaratës noteriale, nëpërmjet të cilës është pretenduar marrja e një huaje nga babai i subjektit në vitin 2001, trupi gjykues vlerëson se kjo tentativë saktësimi është e vonuar dhe nuk mund të ndryshojë burimet e deklaruar më herët nga subjekti, për sa kohë ky burim as nuk është cituar së paku në përgjigjet e pyetësorëve në të cilët është pyetur specifikisht nga Komisioni – konkretisht mbi burimet e përdorura nga babai i saj për kryerjen e pagesave. Për më tepër, nuk është paraqitur ndonjë dokumentacion që të provojë dhënien apo kthimin e kësaj huaje dhe, për sa kohë mbetet në nivel deklarativ, nuk mund të konsiderohet si një burim financiar i besueshëm. Gjithashtu, duket jo bindës fakti që dikush vendos të bëjë një investim në një apartament duke mos pasur disponibilitet financiar dhe merr hua që për pagesën e kësteve të para, dhe në vitet e mëpasshme (deri në vitin 2005) nuk nis asnjë veprim për marrjen e ndonjë kredie apo për sigurimin e burimeve alternative të mjeteve financiare me të cilat do të përfundonte pagesa e pasurisë në fjalë dhe do të përballoheshin edhe shpenzimet për arredimin e saj.
96. Lidhur me të ardhurat nga “Tirana Bank” si këshilltar i jashtëm, të bashkëshortit të subjektit Th. S., duke analizuar përmbajtjen e vërtetimeve të përfaqësuesve të kësaj banke, që ka pohuar se është në pamundësi për të paraqitur dokumente provuese për vitet 1996 - 1999, duke konfirmuar me dokumentacion mbështetës vetëm pagesat e kryera për këtë shtetas përgjatë viteve 2000 dhe 2001, dhe duke mbajtur në konsideratë kohën e gjatë që ka kaluar dhe në aplikim të pikës 2, të nenit 32, të ligjit nr. 84/2016, të ardhurat shtesë për

vitet 1996 - 1999, të pa konsideruara më herët nga Komisioni, do të rezultonin në shumën 3,588,280 lekë, të cilat duhet të përlllogariten në analizën financiare përfundimtare.

97. Gjithashtu, nga dokumentacioni i paraqitur nga subjekti në prapësime, është konfirmuar marrëdhënia me shtetasin L. M., si dhe ka rezultuar se ky i fundit ka pasur mundësi për kthimin e huave me burime të ligjshme financiare. Gjithashtu, edhe bashkëshorti i subjektit ka pasur mundësi financiare për dhënien e huave në fjalë më herët. Për rrjedhojë, edhe ky burim duhet të përfshihet në analizën financiare.
98. Nisur nga analizat, argumentet dhe qëndrimet e lartpërshkruara, duke rishikuar analizën financiare, ndryshe nga sa ishte përcjellë me rezultatet e hetimit, përfundimisht lidhur me shpenzimet për këtë pasuri, subjekti do të kishte një mjaftueshmëri të burimeve për kryerjen e pagesës së këstit të parë prej 15,000 USD në vitin 2001 (në vend të 2,262,174 lekë). Gjithashtu, për pagesën e kryer në vitin 2002 është i provuar burimi i ligjshëm nga kredia bankare. Ndërsa në vitin 2003 nuk do të rezultonte më ndonjë pagesë e kryer (për rrjedhojë as mungesë e burimeve) ndërkohë që, për vitin 2005 do të rezultonte një mungesë e burimeve të ligjshme financiare në shumën prej 189,091 lekësh (në vend të 1,649,291 lekë të përlllogaritur përgjatë hetimit administrativ), si pasojë e uljes së shumës së paguar në këtë vit nga 2,160,000 lekë në 700,400 lekë, dhe për shkak të përfshirjes/konsiderimit si disponibilitet i të ardhurave nga shitja e banesës, në vlerën 1,100,000 lekë (në vend të 550,000 lekë që ishte përlllogaritur më herët, me burim nga shitja e apartamentit në Fier, trajtuar në pikën në vijim). Për rrjedhojë, dhe në konkluzion, pamjaftueshmëria e burimeve financiare për krijimin e kësaj pasurie, bazuar në analizën financiare të rishikuar nga Njësia e Shërbimit Ligjor të Komisionit, ka rezultuar në total në vlerën negative prej 189,091 lekësh nga subjekti i rivlerësimit dhe 3,426,000 lekë për pagimin e shumës prej 25,000 USD nga babai i subjektit.

#### **4. Apartament me sipërfaqe 140.03 m<sup>2</sup> dhe garazh me sipërfaqe 28.75 m<sup>2</sup>, në rrugën “I. R.”, Tiranë**

99. Këto pasuri janë përfituar me kontratën e shitblerjes nr. \*\*\*, datë 19.6.2012, të lidhur ndërmjet palës shitëse, shoqërisë “K.” sh.p.k. dhe shtetasit A. J., dhe palës blerëse Th. S., për blerjen e apartamentit me sip. 140.03 m<sup>2</sup> kundrejt çmimit 90,800 euro dhe garazhit me sip. 28.75 m<sup>2</sup> kundrejt çmimit 9,200 euro, të ndodhura në rrugën “D. Sh.”, Tiranë. Në nenin 2.2 të kontratës së shitblerjes së sipërcituar, palët kanë deklaruar se ky çmim është paguar totalisht nga blerësi përpara lidhjes së saj.
100. Subjekti i rivlerësimit ka deklaruar në deklaratën *Vetting* si burim për blerjen e këtyre pasurive të ardhurat nga shitja e truallit me sip. 600 m<sup>2</sup> në Golem<sup>38</sup>, kundrejt çmimit 127,346 euro, nga të cilat është përdorur shuma prej 100,000 euro<sup>39</sup>.
101. Në DIPP-në e vitit 2007, subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshorti i saj kanë deklaruar në deklaratimet e tyre<sup>40</sup> porositjen e apartamentit nga shoqëria “K.” sh.p.k., me sip. 97 m<sup>2</sup>,

<sup>38</sup> Ky truall ishte dhënë fillimisht për ndërtim me kontratën nr. \*\*\*, datë 31.7.2007.

<sup>39</sup> Referuar deklaratimit në deklaratën *Vetting*, diferenca e mbetur prej 27,346 euro nga shitja është futur në kursimet e familjes dhe përdorur më pas për blerjen e automjetit tip “Citroen 5”.

<sup>40</sup> Deklaratë e interesave private pas largimit nga funksioni të z. Th. S., ku deklaroi paguar për këtë pasuri shuma 72,000 euro nga 100,000 euro.

garazh dhe tarracë me sip. 35 m<sup>2</sup>, në vlerën 100,000 euro, nga të cilat ishte paguar vlera prej 70,000 euro, por ka rezultuar se nuk e kanë deklaruar në rubrikën përkatëse të detyrimeve vlerën e mbetur pa shlyer prej 30,000 euro ndaj shoqërisë ndërtuese.

102. Ndërkohë, në DIPP-në e vitit 2008, në rubrikën e ndryshimit të pasurive, subjekti ka deklaruar: *“Paguar firmës ‘K.’ sh.p.k. kësti i mbetur për apartamentin në rrugën ‘D. Sh.’ (deklaruar 1 vit më parë). Vlera: 30.000 euro...”*, por ka rezultuar se nuk ka deklaruar burimin e ligjshëm të të ardhurave që kanë shërbyer për kryerjen e kësaj pagese.
103. Përgjatë hetimit administrativ, për më shumë qartësi, Komisioni iu drejtua subjektit të rivlerësimit nëpërmjet pyetësorit nr. 2, për të sqaruar diferencat e konstatuara në sipërfaqet e apartamentit dhe garazhit në fjalë midis deklarimit të saj në DIPP-në e vitit 2007 dhe sipërfaqeve të blera nga shoqëria “K.” sh.p.k. në vitin 2012 (përkatësisht 97 m<sup>2</sup> apartamenti, 35 m<sup>2</sup> tarraca dhe garazhi i porositur në vitin 2007, krahasuar me 140.03 m<sup>2</sup> apartamenti dhe 28.75 m<sup>2</sup> garazhi në vitin 2012). Në përgjigje<sup>41</sup> të pyetësorit, subjekti i rivlerësimit ka sqaruar se: *“Në kontratën e sipërmarrjes/porosisë të apartamentit dhe garazhit të deklaruar në vitin 2007, parashikohet një apartament me sip. 97.75 m<sup>2</sup>, sipërfaqe të përbashkëta 7.82 m<sup>2</sup>, një tarracë/verandë me sip. 35 m<sup>2</sup>, si dhe një garazh me sip. 27.95 m<sup>2</sup>. Ndërkohë, në kontratën e shitjes, datë 19.6.2012, apartamenti është shënuar me një sipërfaqe totale 140.03 m<sup>2</sup>, ndërsa sipërfaqja e garazhit është shënuar 28.75 m<sup>2</sup>. Mospërputhjet e sipërfaqes së apartamentit në dy kontratat e mësipërme kanë ndodhur sepse në kontratën e shitjes janë futur si sipërfaqe të apartamentit edhe sipërfaqja e tarracës/verandës dhe ajo e përbashkët, ndërsa në kontratën e porosisë këto sipërfaqe nuk janë llogaritur. Kjo mospërputhje ka ndodhur sepse, sipas shpjegimeve të ndërtuesit dhe specialistëve të ZRPP-së, aktet në fuqi në vitin 2007 nuk lejonin që në certifikatën e pronësisë së apartamentit të shkruhej si sipërfaqe apartamenti edhe sipërfaqja e përbashkët dhe ajo e verandës. Pra, sipërfaqja prej 140.03 m<sup>2</sup> përfshin si sipërfaqen e apartamentit prej 97.75 m<sup>2</sup>, verandës 35 m<sup>2</sup>, edhe sipërfaqen e përbashkët 7.48 m<sup>2</sup>”*.
104. Subjekti i rivlerësimit i ka bashkëlidhur pyetësorit nr. 2 kontratën e sipërmarrjes së datës 10.1.2007, të panoterizuar, lidhur midis shoqërisë “K.” sh.p.k. dhe porositësit Th. S., si dhe planimetrinë e apartamentit, në të cilën konstatohet se sipërfaqja *neto* është 97.05 m<sup>2</sup>, plus sipërfaqe e verandës 42.03 m<sup>2</sup> dhe sipërfaqe e përbashkët 8 m<sup>2</sup>. Në këtë kontratë palët janë shprehur se blerësi ka likuiduar me lidhjen e kontratës shumën prej 2,000 euro.
105. Duke qenë se pagesat për blerjen e këtyre pasurive janë likuiduar nëpërmjet bankës në shumat 70,000 euro dhe 30,000 euro, Komisioni i ka kërkuar subjektit të sqarojë në pyetësorin nr. 5 lidhur me këtë pagesë tepër prej 2,000 euro. Në përgjigje të kërkesës së Komisionit, subjekti ka depozituar një aktmarrëveshje të datës 10.9.2007, të lidhur midis bashkëshortit të subjektit dhe përfaqësuesit të shoqërisë “K.” sh.p.k., shtetasi F. B., në të cilën deklarohet se ka marrë mbrapsht shumën prej 2,000 euro.
106. Lidhur me këto pasuri, Komisioni ka administruar dokumentacionin, si vijon:

---

<sup>41</sup> Referojuni përgjigjes 11 të pyetësorit nr. 2.

- a. ASHK-ja, Tirana Jug, me shkresën nr. \*\*\* prot., të datës 15.10.2019, ka konfirmuar pasuritë apartament me sip. 140.03 m<sup>2</sup> dhe garazh me sip. 28.75 m<sup>2</sup>, të ndodhura në rrugën “D. Sh.”, Tiranë, z. k. \*\*\*, dhe me numrat e pasurive përkatësisht \*\*\* dhe \*\*\*; kontratë shitblerjeje nr. \*\*\*, datë 19.6.2012, ndërmjet palës shitëse “K.” sh.p.k., me përfaqësues A. J., dhe palë blerëse Th. S., për blerjen e apartamentit me sip. 140.03 m<sup>2</sup> dhe garazhit me sip. 28.75 m<sup>2</sup>, të ndodhura në rrugën “D. Sh.”, Tiranë, me çmimet përkatësisht 90,800 euro dhe 9,200 euro.
- b. Kontratë shitblerjeje nr. \*\*\*, datë 3.11.2000, me palë shitëse M. A. dhe T. A. dhe me palë blerëse bashkëshorti i subjektit Th. S., ku ky i fundit ka blerë pasurinë e llojit “arë”, me sip. 600 m<sup>2</sup>, me nr. pasurie \*\*\*, z. k. \*\*\*, vol \*\*\*, f. \*\*\*, kundrejt çmimit 10,000 USD; kontratë shitblerjeje nr. \*\*\*, datë 31.7.2007, me palë shitëse Th. S. dhe Zegjine Sollaku dhe palë blerëse A. T., për shitjen e pasurisë së llojit “arë”, me sip. 600 m<sup>2</sup>, me çmim total prej 127,346 euro.

### **Lidhur me analizimin e burimeve të krijimit të këtyre pasurive**

107. Nga verifikimet e lëvizjeve bankare është konstatuar qarkullimi/lëvizja e këtyre shumave:
  - i. Shuma 25,000 euro derdhur nga shtetasi A. T. në llogari të z. Th. S. në “Tirana Bank”, në datën 9.5.2007, me përshkrim “pagesë për blerje trualli M. R.”.
  - ii. Shuma 25,000 euro transferuar nga shtetasi A. T. në llogari të z. Th. S. në “Tirana Bank”, në datën 18.5.2007, me përshkrim “për blerje trualli”.
  - iii. Shuma 77,346 euro transferuar nga shoqëria “A. C.” sh.p.k.<sup>42</sup> në llogari të z. Th. S. në “Credins Bank”, në datën 30.7.2007, me përshkrim “blerje trualli M. R. G.”.
  - iv. Pas transferimit të shumës prej 77,346 euro, përmendur më lart, janë transferuar nga llogaria e bashkëshortit të subjektit në “Credins Bank”, përkatësisht shuma 50,000 euro, në datën 13.9.2007 dhe shuma 20,000 euro, në datë 9.10.2007, në favor të shoqërisë “K.” sh.p.k. me përshkrim “blerje apartamenti”.
108. Nga dokumentacioni i ardhur nga ZVRPP-ja Kavajë bashkëlidhur shkresës nr. \*\*\* prot., datë 18.12.2017, rezulton se pasuria e llojit “arë” është përfutur me kontratën e shitblerjes nr. \*\*\*, datë 3.11.2000, kundrejt çmimit 10,000 USD. Në momentin e shitjes së saj në vitin 2007 bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit ka kryer pagesën e shumës në masën 3 % të vlerës së shitjes së truallit prej 127,346 euro, si tatim për të ardhurat e realizuara nga kjo shitje në shumën prej 458,977 lekësh<sup>43</sup>.
109. Nga verifikimet e lëvizjeve bankare konstatohet edhe pagesa e shumës prej 30,000 euro nga llogaria e bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit në “Tirana Bank” në favor të shoqërisë ndërtuese “K.” sh.p.k., në datën 16.4.2008, me përshkrim “pag. këst apartamenti”.
110. Komisioni iu drejtua subjektit të rivlerësimit nëpërmjet pyetësorit nr. 3 lidhur me arsyet mbi diferencën e konsiderueshme midis çmimit të blerjes në vitin 2000 dhe çmimit të

<sup>42</sup> Nga verifikimi në [www.qkb.gov.al](http://www.qkb.gov.al) rezulton se shoqëria “A. C.” sh.p.k. është regjistruar në QKB në datën 20.8.2004, me administrator dhe ortak të vetëm z. A. T..

<sup>43</sup> 3% x 127,346 euro = 3,820.38 euro (kursi përdorur 1 euro = 120.1 lekë). Paguar vlera 458,977 lekë.

shitjes në vitin 2007, të pasurisë së llojit “arë”, me sip. 600 m<sup>2</sup>, përkatësisht nga çmimi i blerjes prej 10,000 USD në çmimin e shitjes prej 127,346 euro. Në përgjigje të pyetësorit<sup>44</sup>, subjekti ka bërë me dije se: *“Në vitin 2005 bashkëshorti im dhe z. S. P. vendosën që sipërfaqet tokë në pronësi të tyre të ndodhura në G., të bashkoheshin dhe të aplikoheshin për leje ndërtimi, duke kontraktuar ndonjë firmë private ndërtuese. Sipërfaqja prej 600 m<sup>2</sup> në emër të bashkëshortit tim dhe sipërfaqja prej 900 m<sup>2</sup> në emër të S. P., gjithsej 1500 m<sup>2</sup>, ju vunë në dispozicion firmës ndërtuese ‘G.’ sh.p.k. Kështu, me vendimin nr. \*\*\*, datë 8.3.2005, të KRRT-së G. është miratuar leje shesh ndërtimi me investitorë Th. S. dhe S. P.. Me vendim nr. \*\*\*, datë 3.5.2005, të Këshillit të Zhvillimit të Turizmit të Republikës është miratuar kërkesa e familjeve Sollaku dhe P. për kryerjen e ‘veprimtarisë jo të stimuluar’ në investimin që do të kryejnë në një truall në pronësi private. Me vendim nr. \*\*\*, datë 16.6.2005, të KRRT-së G. është miratuar leje ndërtimi shoqërisë ‘G.’ sh.p.k. dhe Th. S. e S. P. për ndërtim objekti 5 kate plus papafingo. Më 2.11.2005, me kontratën paraprake të sipërmarrjes së ndërtimit me nr. \*\*\*, midis Th. S. dhe S. P., në cilësinë e pronarëve të truallit dhe shoqërisë ‘G.’ sh.p.k., përfaqësuar nga R. H., është rënë dakord që nga sipërfaqja e ndërtimit pronarët e truallit do të përfitojnë 25 % të sipërfaqes së ndërtimit, ku Th. S. do të përfitojë 36,6 % të sipërfaqes takuese nga 25 % ose 267 m<sup>2</sup>. Pas përfundimit të ndërtimit firma ndërtuese do të kalonte pronësinë e apartamenteve sipas pjesës takuese pronarëve të truallit, ndërsa këta të fundit do të kalonin pronësinë e truallit tek firma ndërtuese në bazë të kontratës së shkëmbimit në të ardhmen. Ndërsa, në datën 7.11.2005 lidhet një kontratë nënsipërmarrjeje midis shoqërisë ‘G.’ sh.p.k. dhe shoqërisë ‘A. C.’ sh.p.k., me pronar A. T., për ndërtimin e objektit që përmendet në lejet dhe kontratën e mësipërme. Në përfundim të ndërtimit të objektit, A. T. i propozon Th. S. që sipërfaqet takuese të ndërtimit t’i mbante ai, ndërsa Th. do të merrte vlerën e sipërfaqes takuese, çka u finalizua me kontratën e shitjes, datë 31.7.2007. Ndonëse juridikisht është bërë kontratë shitjeje trualli sipas ligjit, në fakt vlera e truallit është vlera e sipërfaqes takuese të ndërtimit si pronar trualli. Për sa i përket z. A. T., unë personalisht nuk e njoh se kush është dhe çfarë përfaqëson, por edhe bashkëshorti im e ka njohur vetëm në momentin e përfundimit të kësaj marrëdhënieje me shoqërinë ‘G.’ sh.p.k., ku u ra dakord dhe u firmos kontrata”.*

111. Në vijim të sa më sipër shpjeguar, Komisioni i ka kërkuar subjektit të rivlerësimit nëpërmjet pyetësorit nr. 5, për të vënë në dispozicion dokumentacionin ligjor që të vërtetonte vlerën totale të ndërtesës si dhe mënyrën e përlllogaritjes së pjesës takuese në raport me të, të vlerësuar në shumën e shitjes prej 127,346 euro.
112. Subjekti i rivlerësimit, së bashku me përgjigjet e saj, ka paraqitur një shkresë të thjeshtë të shoqërisë ndërtuese “A. C.” sh.p.k., datë 27.9.2020, të firmosur dhe vulosur nga administratori i shoqërisë z. A. T., i cili ka shpjeguar mbi mënyrën e llogaritjes së pjesëve takuese. Sipas tij, godina përbëhet nga 5 kate me rreth 520 m<sup>2</sup> secili dhe kosto e ndërtimit ka qenë mesatarisht 39,000 lekë/m<sup>2</sup> (rreth 780,000 euro e gjithë godina). Pjesa takuese e pronarëve të truallit ishte 30%, nga e cila bashkëshorti i subjektit ishte pronar i sipërfaqes prej 600 m<sup>2</sup> nga 1,550 m<sup>2</sup> truall (38.7% x 30% x 2,435 m<sup>2</sup> ndërtim = 282.77 m<sup>2</sup>) që ishte

<sup>44</sup> Referojuni përgjigjes së pyetjes 11, të pyetësorit nr. 3.

vënë në dispozicion të shoqërisë ndërtuese. Referuar shpjegimeve në këtë shkresë, vlerësimi më pas në shitje është kryer me çmimin prej 450 euro/m<sup>2</sup>, nga ku ka rezultuar çmimi total i paguar prej 127,346 euro.

113. Sa i përket blerjes së tokës arë në nëntor të vitit 2000, Komisioni ka përllogaritur të ardhurat dhe shpenzimet e familjes së subjektit për periudhën prill 1995 – nëntor 2000.
114. Nga dokumentacioni i administruar, ka rezultuar se gjatë kësaj periudhe, subjekti dhe bashkëshorti kanë shitur një apartament me kontratën e shitblerjes nr. \*\*\* regj., nr. \*\*\* kol., datë 7.6.1998, në të cilën si palë shitëse kanë qenë Th. S., L. S.<sup>45</sup>, M. S.<sup>46</sup> dhe Zegjine Sollaku, kundrejt çmimit 1,100,000 lekë. Më parë ky apartament ishte privatizuar me kontratën për privatizimin e banesës, datë 8.6.1992, të lidhur ndërmjet Ndërmarrjes Komunale Banesa dhe z. Th. S., kundrejt çmimit 2,561 lekë. Komisioni, ka përllogaritur në analizën financiare të ardhura të subjektit dhe bashkëshortit shumën prej 550,000 lekësh (50% të çmimit të shitblerjes, sipas pjesës takuese të secilit), nga e cila (analiza) ka rezultuar një mungesë burimesh të ligjshme për blerjen e kësaj pasurie në shumën 206,585 lekë, siç është detajuar edhe në tabelën më poshtë:

**Tabela nr. 3** – analiza financiare për blerjen e tokës në vitin 2000

Të ardhurat prill 1995- nëntor 2000	5 341 163
Shpenzime jetike prill 1995 - tetor 2000	- 1 744 636
Të ardhura nga shitja apartamentit në Fier	550 000
Shpenzim për blerjen e tokës në Golem	- 1 499 000
Ndryshimi në likuiditete nëntor 2000	- 3 404 112
<b>Totali</b>	<b>- 756 585</b>

115. Nisur nga sa më sipër, në përfundim të hetimit administrativ lidhur me këtë pasuri, Komisioni, duke i kaluar barrën e provës, i ka njoftuar subjektit rezultatet e mëposhtme:
- Duket se subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar në DIPP-në e vitit 2007, në rubrikën përkatëse, detyrimin e mbetur pa shlyer shoqërisë shitëse “K.” sh.p.k., në vlerën prej 30,000 euro.
  - Duket se në DIPP-në e vitit 2008 subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar burimin e krijimit të pagesës së kryer ndaj shoqërisë “K.” sh.p.k., në vlerën prej 30,000 euro.
  - Duket se ka një diferencë të konsiderueshme midis çmimit të blerjes së pasurisë së llojit “arë”, prej 10,000 USD në vitin 2000, krahasuar me çmimin e shitjes së kësaj pasurie në vitin 2007, prej 127,346 euro, sipas kontratës së shitblerjes nr. \*\*\*, datë 31.7.2007, me palë shitëse Th. dhe Zegjine Sollaku dhe palë blerëse A. T..
  - Duket se subjekti i rivlerësimit ka pasur mundësi për blerjen e pasurive në analizë, apartament dhe garazh, me burime të ligjshme financiare.
  - Duket se për blerjen e tokës arë të ndodhur në G., në vitin 2000, subjekti ka pasur një mungesë të burimeve të ligjshme financiare prej 756,585 lekësh.

<sup>45</sup> Babai i bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit.

<sup>46</sup> Nëna e bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit.

### **Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit**

116. Subjekti i rivlerësimit, pasi është njohur me rezultatet e mësipërme, përveç të tjerash, ka shpjeguar se: *“Ndonëse juridikisht është bërë kontratë shitjeje trualli sipas ligjit, në fakt nuk bëhet fjalë për vlerën reale të shitjes së truallit, por për vlerën e sipërfaqes takuese të ndërtimit (në lekë) si pronar trualli. Për t’i rënë shkurt në arritjen e objektivit final të dakordësuar mes palëve dhe për të evidentuar stimulimin dhe nënshkrimin e disa kontratave, vendosëm të bënim këtë formë shitjeje, duke pasqyruar edhe vlerën e ndërtimit brenda çmimit”*.
117. Sa i përket mungesës financiare të konstatuar nga Komisioni, subjekti ka pretenduar njohjen e të ardhurave nga shitja e apartamentit në Fier, në shumën 1,100,000 lekë dhe jo 550,000 lekë, duke bërë me dije se në atë kohë prindërit e bashkëshortit nuk kanë marrë pjesën e tyre takuese nga këto të ardhura, duke qenë se ata kishin një pronë tjetër në emër të tyre. Gjithashtu, subjekti ka paraqitur edhe një deklaratë noteriale të datës 18.6.2021, lëshuar nga vjehrra e saj, e cila është shprehur se nuk kanë marrë pjesën e tyre takuese nga apartamenti i privatizuar, pasi këto të ardhura ia kanë lënë djalit të tyre Th. S..

### **Vlerësimi i trupit gjykues**

118. Lidhur me kontratën e shitjes së truallit nga bashkëshorti i subjektit, ndonëse ajo ka për objekt shitjen e truallit në fjalë, nisur nga përmbajtja dhe elementët e saj thelbësorë, përfshirë këtu jo vetëm çmimin por edhe tipologjinë e truallit, për të cilin ekzistonin lejet e zhvillimit dhe të ndërtimit, trupi gjykues vlerëson se *de facto* gjendemi përballë një kontrate shkëmbimi, me likuidimin paraprak të vlerës monetare të pjesës takuese të sipërfaqes ndërtimore, që do t’i përkiste bashkëshortit të subjektit, në shkëmbim të pasurisë së tij truall, mbi të cilin është ndërtuar.
119. Siç është shprehur edhe vetë z. Th. S. në seancën dëgjimore, vlerësohet se tipologjia e kontratës nuk është ajo e duhura për të bërë me transparencë tjetërsimin e të drejtave reale të ndërsjella, objekt shkëmbimi, dhe likuidimin paraprak të këtyre të fundit që i përkisnin bashkëshortit të subjektit. Megjithatë, nisur nga këto konstatime dhe vlerësime: (i) nuk kemi të bëjmë me një kontratë fiktive; (ii) çmimi i shitjes përputhet me vlerën mesatare të sipërfaqes së ndërtimit që do të përfitonte z. Th. S., (ndonëse në pamje të parë çmimi i kontratës në fjalë mund të duket fiktiv, nëse ai do të raportohej/krahasohej vetëm me vlerën e truallit); (iii) që pavarësisht titullit apo përmbajtjes së kontratës *de qua*, nëse kjo e fundit do të interpretohej nëpërmjet një vështrimi dhe vlerësimi gjithëpërfshirës, nisur nga dinamika e veprimeve dhe nga rrethanat faktike të shpjeguara nga subjekti, arrihet në përfundimin se efekti/objekti i përbërë i asaj kontrate ka qenë shkëmbimi i një trualli me leje zhvillimi dhe ndërtimi me shoqërinë ndërtuese, e cila ka rënë dakord të likuidojë/monetarizojë dhe të paguajë paraprakisht pjesën e sipërfaqes së ndërtimit që i takonte z. Th. S. (sikurse edhe pronarit tjetër të pjesës së truallit) dhe mbi të cilin është kryer ndërtimi nga shoqëria “A. C.” sh.p.k. – administratori i së cilës ka shpjeguar mënyrën e përlllogaritjes së vlerës takuese, nëpërmjet deklaratës noteriale të

lartpërmendur<sup>47</sup>; (iv) shpjegimet e subjektit gjejnë mbështetje në dinamikën e fakteve dhe në logjikën ekonomike, ndonëse ato nuk janë pasqyruar në mënyrën e duhur në aktet përkatëse – trupi gjykues çmon se pasaktësia formale e akteve noteriale nuk mund të zhbëjë thelbin e veprimeve juridiko-civile, të cilat në njëfarë mënyre i kanë prodhuar efektet e veta, me dakordësinë paraprake dhe vijuese të palëve përkatëse. Në këto kushte, lidhur me të ardhurat e përfituara nga kjo shitje, për sa kohë burojnë nga një tjetërsim të drejtash bazuar dhe në respekt të vullnetit të lirë të palëve, për të cilat janë paguar detyrimet tatimore dhe nuk gjendemi përballë ndonjë fiktiviteti për të gjeneruar të ardhura vetëm *de jure*, si dhe është provuar konkretisht përfitimi i ligjshëm i tyre, çmohet se ato duhet të përfshihen në analizën financiare.

120. Lidhur me disponibilitetin dhe përdorimin nga subjekti të të gjithë shumës prej 1,100,000 lekësh, të përfituar nga shitja e apartamentit të privatizuar, në bashkëpronësi me prindërit e bashkëshortit të subjektit, trupi gjykues vlerëson se pavarësisht se kjo shumë është cituar në vlerën e plotë si burim krijimi, subjekti nuk ka deklaruar përfitimin si dhurim të gjysmës së çmimit prej 550,000 lekësh, që *de jure* u përkiste prindërve të tij dhe jo bashkëshortit. Megjithatë, për sa kohë gjendemi në rrafshin e marrëdhënieve ndërfamiljare dhe nuk mund të përjashtohet mundësia e përdorimit total të shumës në fjalë për pasurinë në analizë, duke konsideruar edhe deklaratën e nënës së bashkëshortit të subjektit, që e konfirmon këtë rrethanë, vlerësohet se e gjithë shuma prej 1,100,000 lekësh mund të përlllogaritet në analizën financiare si një nga burimet monetare të disponueshme, me të cilin është paguar pjesërisht pasuria në fjalë.
121. Në përfundim, duke reflektuar në analizën financiare të rishikuar efektet e konsiderimit të përfitimit të të gjithë shumës së të ardhurave prej 1,100,000 lekësh në favor të subjektit dhe bashkëshortit, si dhe pas konfirmimit të burimeve të ligjshme lidhur me marrëdhëniet e huamarrjes/huadhënies me shtetasin L. M. (sipërrajtuar), rezulton një mjaftueshmëri e burimeve të ligjshme financiare për blerjen e kësaj pasurie në vitin 2000, ndryshe nga sa ishte konstatuar në rezultatet e hetimit administrativ – një mungesë burimesh në shumën prej 756,585 lekësh.

**5. Dy apartamente me sipërfaqe 184.2 m<sup>2</sup> dhe 82.4 m<sup>2</sup>, si dhe tre garazhe me sipërfaqe 21.93 m<sup>2</sup>, 15.95 m<sup>2</sup> dhe 15.08 m<sup>2</sup>, me vendndodhje në rrugën “S. F.”, kompleksi N., Tiranë**

122. Subjekti i rivlerësimit ka deklaruar për herë të parë në DIPP-në e vitit 2010 si pasuri të përfituar me kontratën e porosisë për blerje apartament në shoqërinë “T.” sh.p.k., me sip. 274 m<sup>2</sup>, kundrejt vlerës 200,000 euro.
123. Këto pasuri të paluajtshme<sup>48</sup> janë përfituar me kontratën e shitblerjes nr. \*\*\*, datë 4.3.2013, të lidhur ndërmjet shoqërisë shitëse “T. I. D.”<sup>49</sup> sh.p.k. dhe palës blerëse Zegjine dhe Th. Sollaku, për blerjen e pasurive me vlerë totale 300,000 euro, nga ku në pikën 3.2 të nenit 3, është cituar se: “*Palët bien dakord se vlera e blerjes është likuiduar*

<sup>47</sup> Pika 112, firmosur nga z. A. T., datë 27.9.2020.

<sup>48</sup> Duke qenë se pasuritë 7-11 janë objekt i një transaksioni të vetëm, për të cilat nga subjekti deklarohen të njëjtat burime financimi, analiza e tyre bëhet është bërë e përbashkët.

<sup>49</sup> Shoqëria “T.” sh.p.k.



*nga blerësi dhe se shitësi do të paguajë taksën e transferimit të pasurisë, si dhe likuidimi i shumës prej 300,000 euro është bërë nëpërmjet bankës në numrin llogarisë të shoqërisë 'T.' sh.p.k. para nënshkrimit të kësaj kontrate”.*

124. Në DIPP-në e vitit 2013 subjekti i rivlerësimit ka deklaruar pasuritë e paluajtshme në fjalë, të cilat në total rezultojnë me çmimin 300,000 euro<sup>50</sup>, si vijon:
  - a. apartament me sip. 184.2 m<sup>2</sup>, me vlerë 181,200 euro;
  - b. apartament me sip. 82.4 m<sup>2</sup>, me vlerë 81,000 euro;
  - c. tre garazhe, gjithsej me sip. 53 m<sup>2</sup>, me vlerë 37,800 euro.
125. Subjekti i rivlerësimit ka deklaruar burimin e krijimit nga kredia bankare e marrë në “Intesa Sanpaolo Bank” në vitin 2010, në shumën 200,000 euro, të përdorur për blerjen e apartamenteve dhe garazheve nga firma “T.” sh.p.k., si dhe kredi bankare marrë në “Tirana Bank” në vitin 2013, në shumën 193,000 euro, përdorur për blerjen e apartamenteve nga shoqëria “T.” sh.p.k., si dhe për nevoja të biznesit të bashkëshortit.
126. Subjekti i rivlerësimit ka deklaruar në deklaratën *Vetting* si burim krijimi të këtyre pasurive të ardhurat e përfituara nga:
  - i. kontratë kredie nr. \*\*\*, datë 4.7.2007, me Bankën Amerikane të Shqipërisë (sot “Intesa Sanpaolo Bank”), në shumën 200,000 euro;
  - ii. kontratë kredie nr. \*\*\*, datë 16.7.2013, me “Tirana Bank” (shuma e kredisë 193,000 euro, nga të cilat 100,000 euro transferuar në llogarinë e shtetasit K. P.<sup>51</sup> për huan e marrë nga bashkëshorti për shlyerje kësti, në pritje të kredisë bankare).
127. Në DIPP-në e vitit 2010 subjekti i rivlerësimit ka deklaruar lidhjen e kontratës së porosisë me shoqërinë “T.” sh.p.k. për blerje apartamenti me sip. 274 m<sup>2</sup> dhe ka deklaruar vlerën e pasurisë prej 200,000 euro. Në rubrikën e detyrimeve të DIPP-së së vitit 2010, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar kredinë në vlerën 200,000 euro, të marrë me kontratën e kredisë nr. \*\*\*, datë 4.7.2007, me ish-Bankën Amerikane të Shqipërisë.
128. Në bazë të kontratës së kredisë bankare nr. \*\*\*, datë 4.7.2007, palët kanë rënë dakord për një kredi në shumën 200,000 euro, e cila do të lëvrohej në dy këste, bazuar në kërkesën e kredimarrësve. Në datën 2.8.2010 kredimarrësit i kanë kërkuar bankës lëvrimin në llogarinë e tyre të të gjithë shumën, pra, të dyja këstet, duke specifikuar:
  - i. këstin e parë prej 100,000 euro brenda datës 10.9.2010; dhe
  - ii. këstin e dytë prej 100,000 euro brenda datës 20.9.2010.
129. Në datën 29.9.2010 në llogarinë e shtetasve Zegjine dhe Th. Sollaku në “Intesa Sanpaolo Bank” është disbursuar kredia në shumën 200,000 euro, e cila në datën 6.10.2010 është transferuar në llogarinë e shoqërisë “T.” sh.p.k.
130. Subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar në DIPP-në e vitit 2010 ndonjë detyrim të mbetur pa shlyer ndaj shoqërisë “T.” sh.p.k. në rubrikën përkatëse të detyrimeve. Gjithashtu,

<sup>50</sup> Çmimet e pasurive të veçanta janë përkatësisht 181,200 euro, 81,000 euro, 15,600 euro, 11,400 euro dhe 10,800 euro, pra në total 300,000 euro.

<sup>51</sup> Me përshkrimin “për huan e marrë nga bashkëshorti për shlyerje kësti, në pritje të kredisë bankare”.

konstatohet se në këtë deklaratë subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar as porositjen e tre garazheve pranë kësaj shoqërie.

131. Komisioni i ka kërkuar subjektit të rivlerësimit, nëpërmjet pyetësorit nr. 5, të bëjë me dije mbi arsyet e mosdeklarimit në DIPP-në e vitit 2010 dhe në vijim deri në vitin 2013, të porositjes së garazheve dhe të detyrimit të mbetur prej 100,000 euro ndaj kësaj shoqërie, si dhe të paraqesë kontratën e porosisë së vitit 2010 me shoqërinë “T.” sh.p.k. Në përgjigje të pyetësorit nr. 5, subjekti ka paraqitur kopje të kontratës së sipërmarrjes së nënshkruar me shoqërinë “T.” sh.p.k., në datën 4.10.2010, në të cilën objekt janë vetëm dy apartamentet me sipërfaqe totale 288.8 m<sup>2</sup>, nga të cilat sipërfaqe e brendshme 266.6 m<sup>2</sup>. Në këtë kontratë është përshkruar vlera e ambienteve prej 200,000 euro, e cila përfshinte punimet karabina, ndërsa punimet e brendshme do të bëheshin nga vetë porositësi. Subjekti është shpjeguar se këto punime të brendshme u kryen më pas nga shoqëria shitëse dhe në vitin 2013, në prag të nënshkrimit të kontratës së shitblerjes, palët ranë dakord për blerjen edhe të garazheve, si dhe u përlllogarit vlera totale e tyre së bashku me punimet e brendshme, të cilat rezultuan në shumën 100,000 euro.
132. Në DIPP-në e vitit 2013, në rubrikën e ndryshimit të pasurive, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar dy apartamentet dhe tre garazhet, si dhe lidhjen e kontratës së shitblerjes, datë 3.4.2013, për këto pasuri. Sa i përket çmimit të blerjes së pasurive në fjalë, nëpërmjet pyetësorit nr. 7, Komisioni i ka kërkuar subjektit të rivlerësimit të paraqesë kontrata të ngjashme të nënshkruara nga e njëjta shoqëri ndërtuese, në të njëjtin objekt dhe me sipërfaqe të ngjashme me apartamentet e porositur prej saj. Në përgjigje të sa më sipër, subjekti është shprehur se në objektin në fjalë ka pasur variacion çmimesh në varësi të pozicionit të apartamenteve dhe se vetë subjekti ka bërë një marrëveshje për çmimin që prej vitit 2010. Së bashku me përgjigjet, subjekti ka paraqitur 6 kontrata të ngjashme<sup>52</sup>, nga shqyrtimi i të cilave ka rezultuar një çmim mesatarisht prej 847.11 euro/m<sup>2</sup>, ndërkohë që pasuritë e subjektit kanë rezultuar të jenë blerë me një çmim prej 907.9 euro/m<sup>2</sup>.
133. Në rubrikën e detyrimeve financiare të DIPP-së së vitit 2013, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar marrjen e kredisë bankare në “Tirana Bank” në vlerën 193,000 euro, përdorur për blerjen e apartamenteve nga shoqëria “T.” sh.p.k., si dhe për nevoja të biznesit të bashkëshortit.
134. Lidhur me këto pasuri, Komisioni ka administruar dokumentacionin, si vijon:
  - i. ASHK-ja, Tirana Jug, me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 15.10.2019, ka konfirmuar se në emër të subjektit të rivlerësimit dhe bashkëshortit figurojnë të regjistruara pasuritë e paluajtshme, si vijon:

---

<sup>52</sup> Kontratë, datë 22.7.2010, për shitjen e një apartamenti me sip. 170.15 m<sup>2</sup>, kundrejt çmimit 135,000 euro; kontratë, datë 5.2.2010, për shitjen e një apartamenti me sip. 77.66 m<sup>2</sup>, kundrejt çmimit 70,000 euro; kontratë, datë 18.2.2013, për shitjen e një apartamenti me sip. 188.63 m<sup>2</sup>, kundrejt çmimit 153,700 euro; kontratë, datë 3.4.2013, për shitjen e një apartamenti me sip. 164.23 m<sup>2</sup> dhe dy garazhe, kundrejt çmimeve përkatësisht 142,000 euro, 8,900 euro dhe 8,500 euro; kontratë shitjeje, datë 4.11.2013, për shitjen e dy apartamenteve me sip. 167.49 m<sup>2</sup> dhe sip. 98.39 m<sup>2</sup>, si dhe dy garazheve, kundrejt çmimeve përkatësisht 145,000 euro, 80,000 euro, 10,000 euro dhe 10,000 euro; si dhe kontratë shitjeje e datës 22.7.2014, për shitjen e një apartamenti me sip. 160.83 m<sup>2</sup> dhe dy garazheve, kundrejt çmimeve 141,000 euro, 6,900 euro dhe 8,300 euro.

- a. apartament me sip. 82.4m<sup>2</sup>, me nr. pasurie \*\*\*, z. k. \*\*\*, me çmim 81,000 euro dhe apartament me sip. 184.2m<sup>2</sup>, me nr. pasurie \*\*\*, z. k. \*\*\*, me çmim 181,200 euro;
- b. garazh me nr. pasurie \*\*\*, z. k. \*\*\*, me çmim 10,800 euro, garazh me nr. pasurie \*\*\*, z. k. \*\*\*, me çmim 11,400 euro dhe garazh me nr. pasurie \*\*\*, z. k. \*\*\*, me çmim 15,600 euro.
- ii. Kontratë shitblerjeje nr. \*\*\*, datë 4.3.2013, e lidhur ndërmjet shitësit “T. I. D.” sh.p.k. dhe blerësve Th. dhe Zegjine Sollaku, kundrejt çmimit 300,000 euro.
- iii. Kontratë kredie nr. \*\*\*, datë 4.7.2007, me Bankën Amerikane të Shqipërisë (sot “Intesa Sanpaolo Bank”), për marrjen e kredisë në shumën 200,000 euro.
- iv. Kontratë kredie nr. \*\*\*, datë 16.7.2013, me “Tirana Bank”, për marrjen e kredisë në shumën 193,000 euro.
- v. Deklaratë noteriale nr. \*\*\*, datë 25.6.2013, në të cilën shtetasi K. P. ka deklaruar se: *“Në muajin janar të vitit 2013 i ka dhënë hua shtetasit Th. S. shumën 100,000 euro, me një afat 1-vjeçar dhe pa interes, për blerjen e një apartamenti”*.

### **Lidhur me analizimin e burimeve të krijimit të pasurive**

135. Nga verifikimi i lëvizjeve bankare është konstatuar se nga llogaria e kredisë në “Intesa Sanpaolo Bank” është kryer transfertat e shumës prej 200,000 euro në datën 6.10.2010, në favor të shoqërisë “T.” sh.p.k., me përshkrimin “pagesë për porositje apartamenti”. Gjithashtu, nga llogaria e bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit në “Tirana Bank” janë bërë transferimet në llogari të shoqërisë “T.” sh.p.k. të shumave, përkatësisht: 20,000 euro në datën 14.2.2013; 40,000 euro në datën 20.2.2013; dhe 40,000 euro në datën 22.2.2013, në total 100,000 euro. Këto shuma rezultojnë të jenë derdhur *cash* nga z. Th. S. në llogarinë e tij në të njëjtat data që janë kryer transfertat.
136. Po ashtu, nga lëvizjet bankare në “Tirana Bank” konstatohet se kredia në shumën 193,000 euro është disbursuar në datën 19.7.2013 në llogarinë e bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit dhe po në të njëjtën datë shuma 93,000 euro është transferuar në “Union Bank”, me përshkrimin “transfertë për mbyllje kredie”, si dhe shuma prej 100,000 euro është transferuar në llogarinë e shtetasit K. P., me përshkrimin “kthim borxhi sipas kontratës së kredisë”. Kjo kredi rezulton të jetë marrë 5 muaj pas likuidimit të shumës prej 100,000 euro<sup>53</sup> në favor të shoqërisë “T.” sh.p.k.
137. Nga shqyrtimi i deklaratave periodike vjetore të subjektit nuk ka rezultuar që ajo apo bashkëshorti i saj të kenë deklaruar në asnjë nga DIPP-të përkatëse të ndonjë marrëdhënieje detyrimi në shumën 100,000 euro ndaj shtetasit K. P., si dhe as qëllimin apo destinacionin e përdorimit të kësaj shume.
138. Në vijim, Komisioni i ka kërkuar shpjegime subjektit të rivlerësimit lidhur me marrëdhënien me shtetasin K. P., e cila në përgjigje të pyetësorit nr. 2 ka bërë me dije se: *“Në lidhje me sa më sipër, nuk kam qenë asnjëherë në dijeni sepse janë veprime të kryera nga bashkëshorti im dhe u vura në dijeni për herë të parë me rastin e dërgimit të pyetjeve*

<sup>53</sup> Shuma 20,000 euro në datën 14.2.2013; shuma 40,000 euro në datën 20.2.2013; dhe shuma 40,000 euro në datën 22.2.2013, në total shuma 100,000 euro, shoqëria “T.” sh.p.k.

*nga ana juaj. Marrëdhëniet e mësipërme nuk janë deklaruar nga ana ime sepse nuk kam pasur dijeni për to për shkak se kanë qenë pjesë e veprimtarisë private të bashkëshortit si avokat. Për më tepër, duke qenë se marrëdhëniet financiare të bashkëshortit janë mbyllur brenda vitit kalendarik, në çdo datë 31 dhjetor, nuk ka pasur asnjë marrëdhënie financiare të hapur me personat e listuar<sup>54</sup> më sipër”.*

139. Subjekti i rivlerësimit, së bashku me përgjigjet e pyetësorit nr. 2, ka paraqitur një deklaratë noteriale të datës 25.6.2013, në të cilën shtetasi K. P. ka deklaruar se: *“Në janar të vitit 2013 i kam dhënë hua shtetasit Th. S. shumën 100,000 euro, me një afat 1-vjeçar dhe pa interes, për blerjen e një apartamenti”.*
140. Nga analizimi i dokumentacionit të administruar është konstatuar se në kontratën e kredisë bankare nr. \*\*\*, datë 16.7.2013, të lidhur midis shtetasve Th. e Zegjine Sollaku dhe “Tirana Bank” për kreditë në shumën 193,000 euro, është përcaktuar se shuma 100,000 euro do të transferohej në llogarinë e shtetasit K. P. (huadhënësi) për likuidimin e huas së marrë për blerjen e apartamentit me sip. 140.03 m<sup>2</sup> në Tiranë<sup>55</sup>.
141. Nga sa më sipër, duket se subjekti i rivlerësimit ishte në dijeni të marrëdhënies së detyrimit prej 100,000 euro të marrë nga shtetasi K. P., pasi ajo ka qenë kredimarrëse së bashku me bashkëshortin në këtë kredi, me anë të të cilës do të kryhej shlyerja e huas shtetasit K. P.. Po ashtu, apartamenti me sip. 140.03 m<sup>2</sup> (objekt i kësaj kontrate kredie në “Tirana Bank”) ka rezultuar të jetë paguar totalisht nga subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshorti në vitin 2007, në shumën 70,000 euro dhe në vitin 2008 në shumën 30,000 euro, pra 5 vite përpara marrjes së kësaj kredie.
142. Lidhur me mospërputhjen e apartamentit (objekt i kredisë) për të cilin është marrë huaja, subjekti i rivlerësimit, në përgjigje të pyetësorit nr. 3<sup>56</sup>, ka bërë me dije se: *“Ka një pasaktësi nga ‘Tirana Bank’ në formulimin e kontratës së kredisë. Shuma e marrë hua nga K. P. në janar të vitit 2013 është përdorur për të paguar pranë shoqërisë ‘T.’ sh.p.k. diferencën prej 100,000 euro, shumë kjo e paguar në shkurt me tre mandatpagesat cash nga bashkëshorti. Shpjegoj se ishim të detyruar të merrnim hua, pasi shoqëria ‘T.’ sh.p.k. kërkonte me insistim likuidimin e diferencës së mbetur dhe pas kësaj të bënte veprimet në ZRPP për kalimin e pronësisë, çka ishte dhe në interesin tonë. Ndërkohë, marrja e kredisë nga banka kërkonte më tepër kohë. Pavarësisht pasaktësive në kontratën e kredisë me ‘Tirana Bank’, në finale, destinimi i shumës së kredisë të marrë prej kësaj banke prej 100,000 euro i ka shërbyer pagesës për blerje apartamenti, duke shlyer huan e dhënë nga K. P. me anë të së cilës u pagua diferenca e vlerës për blerjen e apartamenteve dhe garazheve pranë shoqërisë ‘T.’ sh.p.k.”.*
143. Lidhur me burimin e ligjshëm të huadhënësit K. P., subjekti i rivlerësimit ka paraqitur, së bashku me përgjigjet e pyetësorit, ekstrakt nga QKB-ja për aktivitetin e tij si Person Fizik dhe lëvizje bankare të llogarisë së huadhënësit në “Veneto Bank” të vitit 2012.

<sup>54</sup> Ndër të cilët edhe shtetasi K. P..

<sup>55</sup> Referojuni nenit 2.1 të kontratës së kredisë bankare me nr. \*\*\*, datë 16.7.2013, midis “Tirana Bank” dhe shtetasve Th. dhe Zegjine Sollaku.

<sup>56</sup> Referoju përgjigjes së pyetjes nr. 8 të pyetësorit nr. 3.

144. Nga shqyrtimi i lëvizjeve bankare të paraqitura nuk është konstatuar ndonjë tërheqje e konsiderueshme nga ana e huadhënësit, por kryesisht janë vërejtur transaksione/transferta bankare me klientë dhe furnitorë të ndryshëm.
145. Ndërsa, nga verifikimi në QKB<sup>57</sup> është konfirmuar se aktiviteti i huadhënësit K. P., si investitor në fushën e ndërtimit, është regjistruar pranë këtij institucioni në datën 16.2.2010. Gjatë vitit 2010 shoqëria ka rezultuar me humbje në masën 170,477 lekë, ndërsa në vitet 2011 dhe 2012, referuar pasqyrave financiare të publikuara në faqen zyrtare të QKB-së, aktiviteti i tij ka realizuar fitim *neto* në masat përkatësisht 40,212,320 lekë dhe 27,950,923 lekë.
146. Nga shqyrtimi dhe analizimi i zërave të pasqyrave financiare të deklaruara të aktivitetit të huadhënësit është konstatuar se fitimet *neto* të këtyre dy viteve, pra 2011 dhe 2012, nuk kanë rezultuar të jenë tërhequr nga ortaku, por referuar vendimeve të Personit Fizik këto fitime janë përdorur konkretisht:
- a. fitimi i vitit 2011 prej 40,212,320 lekësh për mbulimin e humbjes së vitit 2010 prej 170,477 lekësh dhe në rezerva për investime vlera e mbetur prej 40,041,843 lekësh;
  - b. fitimi i vitit 2012 prej 27,950,923 lekësh për investime.
147. Po ashtu, edhe nga shqyrtimi i bilancit të vitit të mëpasshëm, 2013, nuk është konstatuar ndonjë tërheqje nga pronari as në bilanc dhe as në pasqyrën e rrjedhjeve të flukseve monetare, në të cilat fitimet e kaluara vijnë në mbeten në fitimet e pasqyrës dhe në rezervat e shoqërisë. Për rrjedhojë, duket se deri në janar të vitit 2013, shtetasi K. P. nuk ka tërhequr asnjë prej fitimeve të shoqërisë së tij dhe, si pasojë, duket se nuk ka pasur mundësi për dhënien e huas ndaj bashkëshortit të subjektit, me burime të ligjshme financiare.
148. Nisur nga sa më sipër, në përfundim të hetimit administrativ lidhur me këtë pasuri, Komisioni, duke i kaluar barrën e provës, i ka njoftuar subjektin për rezultatet e mëposhtme:
- Duket se subjekti i rivlerësimit nuk e ka deklaruar në DIPP-në e vitit 2013 dhe në deklaratën *Vetting* huan e marrë nga shtetasi K. P., si burim i përdorur për blerjen e pasurive në fjalë.
  - Duket se personi tjetër i lidhur K. P. nuk ka pasur mjaftueshmëri të burimeve të ligjshme financiare për dhënien e huas në shumën 100,000 euro bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit. Për pasojë, duket se subjekti i rivlerësimit ka pasur një mungesë të burimeve të ligjshme financiare prej 14,021,000 lekësh (ekuivalenti i 100,000 euro) për blerjen e pasurive në analizë.

#### **Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit**

149. Pasi është njohur me rezultatet e mësipërme, subjekti i rivlerësimit, në mënyrë të përmbledhur, ka shpjeguar se ajo nuk e ka deklaruar huan/detyrimin, duke qenë se kjo e fundit është shuar brenda vitit, ndërkohë që rubrika përkatëse në DIPP kërkon detyrimet e mbetura pa shlyer në 31 dhjetor të vitit përkatës.

---

<sup>57</sup> [www.qkb.gov.al](http://www.qkb.gov.al)

150. Lidhur me të ardhurat e shtetasit K. P., subjekti ka paraqitur deklaratën e tij individuale të të ardhurave (DIVA) të viteve 2012 dhe 2013, sipas së cilave ka deklaruar të ardhura në shumat përkatësisht 45,880,356 lekë dhe 32,139,672 lekë, duke paguar tatimin përkatës, përkatësisht në shumat 4,468,036 lekë dhe 3,108,749 lekë.

### **Vlerësimi i trupit gjykues**

151. Komisioni vlerëson se arsyetimi i subjektit mbi mosdeklarimin e huas mund të vlejë vetëm për sa i përket deklaratës vjetore, por në deklaratën *Vetting* duhej të kishte deklaruar këtë hua si një nga burimet financiare të përdorura për pagesën e pasurive në analizë në këtë pikë – ndonëse fakti që pas pak muajve dhe brenda të njëjtit vit është përfituar një kredi bankare dhe me këto të ardhura është kthyer shuma e huazuar, mund të ketë çuar në një mbivendosje të burimit, duke cituar në deklaratën *Vetting* vetëm kreditë.
152. Në vijim të analizimit dhe shqyrtimit të të gjitha dokumenteve të administruara nga Komisioni, trupi gjykues vlerëson se shpjegimet dhe dokumentet e paraqitura nga subjekti i rivlerësimit, pas njohjes me rezultatet e hetimit, ndonëse krijojnë bindjen e disponibilitetit *de facto* të huadhënësit të shumës në fjalë prej 100,000 euro, nëpërmjet përdorimit të mjeteve monetare që përbënin kapitalin dhe/ose fitimin apo gjendjen e arkës së shoqërisë së tij, por nuk përmbushin kriteret e konsiderimit si një burimi të ligjshëm në kuptimin e nenit D të Aneksit të Kushtetutës dhe të ligjit nr. 84/2016. Ky konkluzion mbështetet mbi faktet si vijon: (i) të ardhurat e deklaruar nga shtetasi K. P. në DIVA-t e viteve 2012 dhe 2013 përkohë/përfaqësojnë fitimet e realizuara nga shoqëria dhe jo të individit; (ii) edhe tatimet e përshkruara në DIVA-t e sipërcituara referojnë shumat e paguara si detyrime tatimore prej kësaj shoqërie mbi fitimin e realizuar dhe jo tatime të paguara nga individi K. P.; (iii) siç është konstatuar edhe nga pasqyrat financiare të shoqërisë së shtetasit K. P., këto fitime nuk janë tërhequr prej këtij të fundit, por janë vendosur në rezervat e tjera të shoqërisë – duke e pamundësuar konsiderimin e këtyre mjeteve monetare si të disponueshme dhe të përdorueshme nga individi-huadhënës; (iv) edhe nëse do të konsiderohej përdorimi në këtë huadhënie i shumave të fituara, pjesë e arkës apo e rezervave, mungon prova e përshkrimit të veprimeve financiare në fjalë (dhënie huaje dhe marrje huaje), në datat përkatëse në librat e shoqërisë, konkretisht në lëvizjet e arkës – për sa kohë ka qenë detyrim pasqyrimi në kohë reale të çdo daljeje dhe hyrjeje të shumave monetare të shoqërisë, për më tepër që në rastin konkret bëhet fjalë për një shifër të rëndësishme prej 100,000 euro, që veç të tjerash pretendohet se është dorëzuar *cash*.
153. Për rrjedhojë të sa më sipër, *stricto legis* dhe sipas jurisprudencës së Kolegjit të Posaçëm të Apelit<sup>58</sup>, duke mos e konsideruar huamarrjen e lartpërmendur, subjekti i rivlerësimit dhe familja e tij rezulton me një mungesë të burimeve të ligjshme financiare në vlerën negative prej 14,021,000 lekësh për pagesën e çmimit të këtyre pasurive. Gjithashtu, duhet qartësuar se: (i) nga njëra anë kjo pamundësi financiare, në momentin e kryerjes së pagesave (si më sipërpershkruar), nuk ndikon në analizën financiare të vitit 2013 –

<sup>58</sup> Vendimi nr. 27/2019 (JR), datë 24.10.2019, i KPA-së.

duke mos u reflektuar kjo mungesë në fund të vitit në fjalë, për shkak të marrjes së kredisë bankare prej subjektit disa muaj më pas, shuma të përdorura pikërisht (edhe) për shlyerjen e kësaj huaje, duke u mbivendosur si burim alternativ brenda vitit, dhe për pasojë duke bërë që viti 2013 të mos rezultojë me balancë negative; (ii) nga ana tjetër, trupi gjykues vëren se edhe nëse huamarrja në fjalë do të konsiderohej me burim të ligjshëm financiar, ndonëse përfaqëson një shumë të konsiderueshme, kjo nuk do të mjaftonte që vlerësimi dhe vendimi përfundimtar dhe gjithëpërfshirës i kriterit të pasurisë të ishte i ndryshëm/pozitiv, për sa kohë pamjaftueshmëria totale që ka rezultuar në analizën financiare të pasurive/shpenzimeve të tjera (pa pasur asnjë efekt negativ prej kësaj huaje), si dhe problematikat e konstatuara lidhur me deklaratimet, nuk do ta mundësonin gjithsesi mosaplikimin e pikës 3, të nenit 61, të ligjit nr. 84/2016.

#### **6. Apartament me sipërfaqe 70.56 m<sup>2</sup>, në K., K. (P. A.)**

154. Kjo pasuri është deklaruar për herë të parë në DIPP-në e vitit 2009, me kontratën e porosisë në vlerën 3,000,000 lekë, por nuk është deklaruar burimi i krijimit të kësaj pasurie.
155. Në deklaratën *Vetting* subjekti i rivlerësimit ka deklaruar si burim krijim për këtë pasuri:
- i. të ardhura nga biznesi i bashkëshortit si avokat;
  - ii. të ardhura nga mësimdhënia në universitetin “M. B.”, universitetin “K.” dhe Universitetin European, kontratë shërbimi, datë 1.10.2008;
  - iii. kursimet familjare ndër vite nga pagat, shpërblimet, dietat, etj.
156. Pasuria është përfituar me kontratën e shitblerjes nr. \*\*\*, datë 2.11.2015, të lidhur midis shoqërinë shitëse “B.” sh.p.k. dhe blerësit Th. S., kundrejt çmimit 3,000,000 lekë. Në kontratë palët kanë deklaruar se çmimi është likuiduar përpara nënshkrimit të kontratës në llogarinë e shoqërisë në “Intesa Sanpaolo Bank”, në datën 20.2.2009, transfertë kjo e cila i është bashkëlidhur edhe kontratës.
157. Lidhur me dokumentacionin e administruar nga Komisioni për këtë pasuri, ka rezultuar si vijon:
- i. ZVRPP-ja Kavajë, me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 19.9.2017, ka konfirmuar se në emër të subjektit të rivlerësimit dhe bashkëshortit ka rezultuar e regjistruar pasuria e llojit “apartament”, me sip. 70.56 m<sup>2</sup>, me nr. pasurie \*\*\*, e ndodhur në K.. ASHK-ja Kavajë, me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 22.10.2019, dhe ASHK-ja, Drejtoria Vendore Zonat e Stimuluara, me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 15.10.2019, nuk kanë konfirmuar pasuri të regjistruara në emër të subjektit të rivlerësimit dhe/apo të personave të lidhur.
  - ii. Subjekti i rivlerësimit ka depozituar bashkëlidhur deklaratës *Vetting*, certifikatën për vërtetim pronësie me nr. \*\*\*, të datës 9.11.2015, për pasurinë e llojit “apartament”, me sip. 70.56 m<sup>2</sup>, me nr. pasurie \*\*\*, vol. \*\*\*, z. k. \*\*\*, f. \*\*\*, në pronësi të shtetasve Zegjine dhe Th. Sollakut. Kontratë shitblerjeje nr. \*\*\*, datë 2.11.2015, mes palës shitëse shoqëria “B.” sh.p.k. dhe palës blerëse Th. S., për blerjen e pasurisë në fjalë.

- iii. Transfertë bankare në shumën 3,000,000 lekë, datë 20.2.2009, në favor të shoqërisë “B.” sh.p.k., me përshkrim “pagesa e apartamentit 4-B në G., P. A., sip. 77.78 m<sup>2</sup>”<sup>59</sup>.

### **Lidhur me analizimin e burimeve për krijimin e kësaj pasurie**

158. Nga lëvizjet e llogarive bankare të bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit është konstatuar se transferta prej 3,000,000 lekësh është kryer nga gjendja e disponuar në llogarinë e tij në “Intesa Sanpaolo Bank”<sup>60</sup> – gjendje kjo e krijuar nga pagesat kalimtare nga ISSH-ja<sup>61</sup> në shumën 100,020 lekë/muaj dhe transfertat në shumën 250,000 lekë/muaj nga “K.” sh.p.k.
159. Pagesat kalimtare nga ISSH-ja kanë filluar të transferohen në llogarinë e bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit në shkurt të vitit 2008. Po ashtu, pagesat nga universiteti “K.” sh.p.k. kanë filluar të transferohen nga shkurti i vitit 2008, por ndërkohë, referuar vërtetimit datë 16.5.2015, të lëshuar nga universiteti “K.”, z. Th. S. ka qenë bashkëpunëtor i universitetit “K.” për periudhën dhjetor 2008 – 2011, në rolin e këshilltarit të jashtëm dhe pedagogut dhe është paguar në shumat 200,000 – 250,000 lekë/muaj<sup>62</sup> nëpërmjet bankës dhe *cash*.
160. Përveç këtyre transfertave, në llogari janë evidentuar edhe disa derdhje *cash* në shumat 250,000 lekë, me përshkrimin “shpërblim mujor nga individë”, por që në kllapa shënohet “Kompania K.”.
161. Komisioni i ka kërkuar subjektit të rivlerësimit, nëpërmjet pyetësorit nr. 5, sqarime lidhur me pagesat e përfituara nga bashkëshorti nga universiteti “K.”, të cilat kanë shërbyer si burim për blerjen e apartamentit me sip. 70.56 m<sup>2</sup>, të ndodhur në K., Kavajë dhe dokumentacionin ligjor për pagimin e detyrimeve tatimore të shumave të përfituara nga marrëdhënia e punës/shërbimeve me këtë shoqëri.
162. Në përgjigje të sa më sipër, subjekti i rivlerësimit ka bërë me dije se pagesat e detyrimeve tatimore të shumave të përfituara nga marrëdhënia me universitetin “K.”, janë kryer nga ky i fundit, bazuar në legjislacionin përkatës, i cili parashikon që punëdhënësi mban në burim shumën e detyrimit tatimor për pagesën që kryen.
163. Gjithashtu, subjekti ka paraqitur një shkresë të datës 22.10.2020<sup>63</sup>, nga universiteti “K.”, në të cilën është deklaruar se shoqëria, për çdo pagesë të kryer në favorin e bashkëshortit si pedagog i jashtëm apo si këshilltar, ka mbajtur tatimin në burim, duke e paguar më pas në shtet. Po ashtu, kanë bërë me dije se nuk është e mundur të paraqesin dokumentacion provues për shkak se dokumentacioni është asgjësuar.
164. Po ashtu, në përgjigje të kërkesës së bërë nga subjekti në DRT-në Tiranë, kjo e fundit, me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 28.10.2020, ka bërë me dije se universitare “K.” ka paguar

<sup>59</sup> Në përshkrim të transfertës i referohet blerjes së një apartamenti me sip. 77.78 m<sup>2</sup> dhe jo 70.56 m<sup>2</sup>.

<sup>60</sup> Referuar lëvizjeve bankare bashkëlidhur përgjigjes nr. \*\*\* prot., datë 24.9.2019, të “Intesa Sanpaolo Bank”.

<sup>61</sup> Pas largimit nga funksioni si Prokuror i Përgjithshëm i bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit.

<sup>62</sup> Në vërtetim përcaktohet se për shkak se universiteti është mbyllur, nuk mund të gjendet dokumentacioni për të përcaktuar saktë shumën e pagesës së kryer. Mbetet i paqartë legjitimiteti i deklaruesit dhe përmbajtja e deklaratës, pasi është lëshuar shumë kohë pas mbylljes së universitetit “K.” dhe i pa bazuar në dokumentacion provues lidhur me specifikimin e shumave të përfituara si këshilltar dhe ato për mësimdhënie, si dhe në kontratat/marrëveshjet paraprake të dhënies së këtyre shërbimeve nga bashkëshorti i subjektit në favor të kësaj shoqërie.

<sup>63</sup> Shkresë nr. extra prot.



tatim në burim mbi të ardhurat ndër vite, por nuk është e mundur që të individualizohet emri i bashkëshortit të subjektit, për shkak se pagesat janë kryer në total.

165. Në këto kushte, Komisioni ka përllogaritur si të ardhura me burim të ligjshëm për këtë pasuri vetëm pagesat kalimtare të përfituara nga ISSH-ja. Shumat e përfituara nga transfertat e kryera nga shoqëria “K.” sh.p.k., në llogari të bashkëshortit të subjektit (përfshirë edhe ato që kanë shënimin në kllapa “K.” sh.p.k.), në këtë stad nuk merren në konsideratë, për sa kohë ende nuk ka rezultuar e provuar mjaftueshëm marrëdhënia e punësimit/shërbimit me universitetin dhe pagesat e parashikuara (për konsulencë dhe për mësimdhënie – pasi ato nuk janë cituar veçmas/saktë as në DIPP-të përkatës).

**Tabela nr. 4** – analiza e burimeve për blerjen e apartamentit në Kryemëdhenj, Kavajë

Të ardhura nga pagesat kalimtare	1,228,817
Të ardhura nga K*** Sh.p.k	-
Shpenzim për blerje apartamenti në Kavajë	- 3,000,000
<b>Rezultati</b>	<b>- 1,771,183</b>

166. Nisur nga sa më sipër, Komisioni i ka kaluar subjektit barrën e provës për këto rezultate:
- Duket se subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar në DIPP-në e vitit 2009 burimin e krijimit të pasurisë apartament me sip. 70.56 m<sup>2</sup>, në K., Kavajë.
  - Duket se subjekti i rivlerësimit ka pasur një mungesë të burimeve të ligjshme financiare në shumën 1,771,183 lekë, për blerjen e pasurisë në fjalë.

#### **Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit**

167. Pasi është njohur me rezultatet e mësipërme, subjekti i rivlerësimit, në mënyrë të përmbledhur, ka pretenduar se Komisioni, në mënyrë të padrejtë, nuk ka përfshirë në analizën financiare të ardhurat e përfituara nga bashkëshorti nëpërmjet bashkëpunimit me universitetin “K.”. Subjekti ka shpjeguar se shkresat e shoqërisë “K.” sh.p.k. janë të ligjshme, pavarësisht heqjes së licencës së universitetit me VKM-në nr. \*\*\*, datë 6.8.2014, dhe statusit të shoqërisë “K.” sh.p.k. “i pezulluar” që nga data 20.8.2014. Shoqëria ekziston, pavarësisht heqjes së licencës për universitetin. Ajo ushtron veprimtari të tjera që janë përshkruar në objektin e veprimtarisë së shoqërisë “K.” sh.p.k. Statusi “i pezulluar” i veprimtarisë së shoqërisë nuk ia heq legjitimitetin organeve të shoqërisë. Ky status shërben kryesisht për të pezulluar marrëdhëniet e subjektit tregtar me organet fiskale.
168. Po ashtu, sipas subjektit, nuk qëndron pretendimi i Komisionit se nuk dokumentohet specifikimi veçmas i shumave të përfituara si këshilltar pranë universitetit “K.” dhe veçmas i atyre të përfituara nga mësimdhënia në këtë universitet, si dhe mungesa e kontratave përkatëse për dhënien e shërbimeve në favor të shoqërisë në fjalë nuk mundëson konsiderimin e këtyre të ardhurave. Subjekti pretendon se konstatimet e mësipërme nuk mund të mohojnë/zhbëjnë faktet e pagesave të kryera në favor të bashkëshortit, pasi *statement*-et bankare janë fakte dhe një provë e plotë që pagesat janë kryer. Po kështu, shkresa e DRT-së Tiranë konfirmon pagesat për tatimin në burim që

janë të mjaftueshme për të krijuar bindjen që të ardhurat nga pagesat e kryera nga shoqëria “K.” sh.p.k. janë nga burime të ligjshme.

169. Gjithashtu, së bashku me prapësimet, subjekti i rivlerësimit ka depozituar si provë të re:
- a. vërtetim i vitit 2009, lëshuar nga shoqëria “K.” sh.p.k. që shtetasi A. K. është punonjës në kompani në pozicionin drejtor ekonomik;
  - b. deklaratë noteriale, datë 10.6.2021, e shtetasit A. K., i cili është shprehur se drejtoria e financës kryente pagesat e stafit akademik dhe se mban mend se z. Th. S. ka qenë pedagog i jashtëm i universitetit “K.”, si dhe këshilltar i kësaj/tij shoqërie/institucioni dhe se ai ka përfiturat pagesat me transfertat bankare apo me derdhje *cash* në bankë nga punonjësit e kompanisë. Shtetasi A. K. citon se për çdo pagesë të kryer në favor të z. Th. S. janë kryer pagesat e tatimit në burim në drejtorinë tatimore.

### **Vlerësimi i trupit gjykues**

170. Komisioni vlerëson se edhe provat e reja të paraqitura nga subjekti pas njohjes me rezultatet e hetimit, mbeten vetëm në nivel deklarativ, për sa kohë nuk është paraqitur ndonjë dokument tjetër i kohës, që të provojë marrëdhënien e punësimit të bashkëshortit të subjektit me shoqërinë “K.I” sh.p.k. Megjithatë, parë në panoramën e përgjithshme dhe nisur kryesisht nga fakti se pjesa më e madhe e të ardhurave, të pretenduara si të realizuara nëpërmjet bashkëpunimit me shoqërinë “K.” sh.p.k., kanë kaluar në favor të z. Th. S. nëpërmjet sistemit bankar, trupi gjykues çmon t’i përllogarisë në analizën financiare këto të fundit. Kjo vendimmarrje bazohet në kombinimin e situatës faktike të provuar (përfitimet e shumave nëpërmjet sistemit bankar), me rrethanat e pretenduara (marrëveshja/et mbi kompensimin/pagesën për çdo lloj bashkëpunimi dhe pagesa e tatimeve specifike) dhe në pamundësi për t’i provuar në mënyrë të drejtpërdrejtë konsiderohen të provuara në mënyrë të tërthortë dhe që nuk mund të injorohen/përrjashtohen si të ardhura me burime të ligjshme. Kjo duke mbajtur në konsideratë veç të dhënave bankare mbi pagesat edhe deklaratën e DRT-së Tiranë lidhur me pagesat për tatimin në burim, si dhe deklaratat e tjera, ndonëse mbetet e paprovuar plotësisht dhe në mënyrë të detajuar, në mungesë të provës së kundërt, duke parë nivelin e provueshmërisë së provave në rrethanat specifike dhe kontekstin e përgjithshëm, krijohet bindja se përfitimi i këtyre të ardhurave rrjedh nga një burim i ligjshëm dhe duhet në përllogaritë në analizën financiare përkatëse.
171. Në vijim dhe për rrjedhojë të sa më sipër, nisur nga këto të dhëna dhe duke përllogaritur në analizën financiare përfitimet e periudhës përkatëse që përkon dhe konfirmohet edhe nga të dhënat e dokumenteve/lëvizjeve bankare për periudhën që mund të gjeneronte kursime për këtë pasuri - deri në shkurt të vitit 2009 kur është kryer pagesa e pasurisë në fjalë – rezultojnë një mjaftueshmëri e burimeve të ligjshme për këtë pasuri – ndryshe nga sa ishte njoftuar me rezultatet e hetimit administrativ (në - 1,771,183 lekë).

## **7. Apartament me sipërfaqe 64 m<sup>2</sup>, në Sarandë**

172. Kjo pasuri është deklaruar për herë të parë nga subjekti i rivlerësimit në DIPP-në e vitit 2015, me vlerën 32,500 euro dhe me burim nga të ardhurat e biznesit të bashkëshortit si avokat.
173. Nga dokumentacioni i administruar ka rezultuar se pasuria është përfituar nga bashkëshorti i subjektit me kontratën e shitblerjes së datës 19.10.2012 dhe nuk rezulton që të jetë deklaruar si pasuri në DIPP-në e vitit 2012 dhe në vijim deri në DIPP-në e vitit 2015, as nga subjekti i rivlerësimit dhe as nga bashkëshorti.
174. Nëpërmjet pyetësorit nr. 5, Komisioni i ka kërkuar shpjegime subjektit mbi arsyet e mosdeklarimit të kësaj pasurie nga DIPP-ja e vitit 2012 e në vijim deri në DIPP-në e 2015. Në përgjigje të sa më sipër, subjekti ka bërë me dije se kjo ka ardhur si pasojë e një ngatërrese të krijuar nga vendosja e një mase kufizuese mbi pasurinë nga ana e regjistruarit në Sarandë, nga një rekomandim i KLSH-së për disa pasuri, ku përfshihej edhe apartamenti në fjalë. Për këtë, subjekti ka paraqitur një vërtetim hipotekor të datës 31.10.2012, ku mbi pasurinë është shënuar komenti nga regjistruari “Në bazë të urdhrin nr. \*\*\*, datë 3.12.2008, mbi këtë pasuri u vendos kufizim”.
175. Në DIPP-në e vitit 2016, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar dhurimin e apartamentit në fjalë vajzës A. S.. Ndërsa në deklaratën Vetting të personit të lidhur A. S. ka deklaruar këtë pasuri të dhuruar nga prindërit me kontratë dhurimi të datës 10.2.2016.
176. Lidhur me këtë pasuri, Komisioni ka administruar dokumentacionin, si vijon:
- a. kontratë shitjeje pasurie të paluajtshme nr. \*\*\*, datë 19.10.2012, të lidhur ndërmjet shitësit A. V. dhe blerësit Th. S., kundrejt çmimit 32,500 euro, të konvertuar në 4,550,000 lekë;
  - b. kontratë dhurimi pasuri e paluajtshme nr. \*\*\*, datë 10.2.2016, ku pala dhuruese Th. S., me pëlqimin e subjektit të rivlerësimit, i kanë dhuruar vajzës A. S. këtë apartament;
  - c. ASHK-ja Sarandë, me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 14.10.2019, ka konfirmuar se kjo pasuri është shitur nga vajza e subjektit të rivlerësimit A. S. me kontratën e shitblerjes nr. \*\*\*, datë 13.6.2019 shtetases italiane M. S.<sup>64</sup>, përkundrejt çmimit 60,000 euro.

### **Lidhur me analizimin e burimeve për krijimin e kësaj pasurie**

177. Subjekti i rivlerësimit ka deklaruar burimin e krijimit të kësaj pasurie nga të ardhurat e aktivitetit të bashkëshortit si avokat. Drejtoria Rajonale Tatimore, me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 16.10.2019, ka informuar se në emër të bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit figuron i regjistruar në datën 30.4.2008 Personi Fizik “Th. S.”, me aktivitet “avokat”. Gjatë vitit 2012, ky aktivitet ka realizuar qarkullim/xhiro në masën 21,581,903 lekë dhe fitim neto pas tatimit në masën 15,571,264 lekë, i cili nga pasqyrat financiare të shoqërisë ka rezultuar të jetë tërhequr nga pronari gjatë këtij viti.

---

<sup>64</sup> Përfaqësuar në këtë kontratë nga shtetasi B. M., me prokurën e posaçme nr. \*\*\*, datë 25.5.2019.

178. Subjekti i rivlerësimit ka përfituar të ardhura nga paga në masën 1,272,322 lekë në vitin 2012 dhe deri në datën 19.10.2012 ka tërhequr nga llogaria e saj e pagës 950,000 lekë. Komisioni ka përlllogaritur edhe shpenzimet e kryera nga familja e subjektit për të njëjtën periudhë, të cilat rezultuan në masën 6,228,127 lekë<sup>65</sup>.

**Tabela nr. 5** – analiza e burimeve për blerjen e apartamentit në Sarandë

Të ardhura nga paga janar-19.10.2012	950 000
Të ardhura nga aktivitetit jan-sht 2012	11 678 448
Shpenzime për blerje apartamenti në Sarandë	- 4 550 000
Shpenzime janar-19.10.2012	- 6 228 127
<b>Rezultati</b>	<b>1 850 321</b>

179. Lidhur me diferencën midis çmimit të shitjes së kësaj pasurie prej 60,000 euro në vitin 2019 dhe çmimit të blerjes prej 4,550,000 lekësh në vitin 2012, subjekti ka shpjeguar se me shitjen e pasurisë është marrë një agjenci imobiliare në Sarandë dhe se rritja e vlerës së apartamentit ka të bëjë gjithashtu me faktin se në përgjithësi, në Shqipëri, çmimi i shitjes ndër vite ka ndryshuar në drejtim rritës.
180. Nisur nga sa më lart, Komisioni ka konstatuar se subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshorti kanë pasur mundësi për blerjen e kësaj pasurie me burime të ligjshme financiare në vitin 2012.

#### **8. Apartament me sipërfaqe 57 m<sup>2</sup> dhe verandë me sipërfaqe 31 m<sup>2</sup>, në Dh., Vlorë**

181. Nisur nga dokumentacioni i administruar nga ILDKPKI-ja, nga ku ka rezultuar një kontratë porosie me nr. \*\*\*, datë 7.6.2013, të nënshkruar përpara noterit M. M., nga bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit Th. S., si palë porositëse dhe shoqërisë “I. C. P. D.” sh.p.k. në cilësinë e sipërmarrësit, për porositjen e një apartamenti në kompleksin e banimit “S. V.” në Dh., me sipërfaqe totale 57 m<sup>2</sup> dhe sipërfaqe verande 31 m<sup>2</sup>, kundrejt çmimit total prej 30,000 euro, pagesë kjo e kryer jashtë zyrës noteriale.
182. Pasi është konstatuar se kjo pasuri nuk është deklaruar në asnjë nga DIPP-të nga ana e subjektit të rivlerësimit apo bashkëshortit të saj, duke filluar nga viti 2013 e në vijim dhe as në deklaratën Vetting, Komisioni i ka kërkuar shpjegime subjektit të rivlerësimit, me anë të pyetësorit nr. 3<sup>66</sup>, lidhur me arsyet e mosdeklarimit të kësaj pasurie në deklaratat e saj periodike.
183. Në përgjigje të sa më sipër, subjekti është shprehur se: *“Kontrata e mësipërme nuk është deklaruar sepse është revokuar brenda një muaji. Kontrata u nënshkrua duke u bazuar në të dhënat dokumentare që afroi firma ndërtuese, planimetria e apartamentit, si dhe planimetria e ambienteve të kompleksit. Por, rezultoi se përshkrimet në kontratë nuk përputheshin me gjendjen në fakt, pasi ishin bërë ndryshime të projektit. Në këto kushte, pas debateve të shumta, u ra dakord që kontrata nr. \*\*\*, datë 7.6.2013, të zgjidhej duke*

<sup>65</sup> Në shpenzimet e familjes janë konsideruar të gjitha shpenzimet e vitit për jetesë, pagesë kredie, pagesë kartë krediti, arsimimi dhe udhëtimi të familjes, në mënyrë përpjesëtimore, në raport me shpenzimet totale të vitit.

<sup>66</sup> Referojuni përgjigjes së pyetjes 9, të pyetësorit nr. 3.

*u kthyer palët në gjendjen e mëparshme. Shoqëria ndërtuese ktheu pagesën prej 30,000 euro, që i ishte paguar cash para momentit të nënshkrimit të kontratës, datë 7.6.2013, me premimin që në të ardhmen do të shikonte mundësinë e gjetjes së një apartamenti me çmim për metër katror pothuajse të njëjtë. Në datën 18.7.2013 është nënshkruar aktmarrëveshja 'për zgjidhjen e kontratës së porosisë nr. \*\*\*, datë 7.6.2013' me shoqërinë. Ndërkohë, në datën 22.3.2018 është nënshkruar kontrata e porosisë me shoqërinë 'I. C. P. D.' sh.p.k. për një apartament të ndodhur në të njëjtin kompleks ku ndodhej apartamenti objekt i kontratës së revokuar, por me sipërfaqe dhe mënyrë pagese ndryshe nga apartamenti i parë. Ky apartament është deklaruar në deklaratën periodike të vitit 2018 pranë ILDKPI-së”.*

184. Ndërsa, në përgjigje të pyetësorit nr. 4, subjekti i rivlerësimit ka bërë me dije gjithashtu se për pagesën e kryer prej 30,000 euro në vitin 2013, si burim kanë shërbyer të ardhurat e aktivitetit të bashkëshortit, të mbartura dhe ato të vitit 2013.
185. Lidhur me këtë pasuri, Komisioni ka administruar dokumentacionin, si vijon:
- i. ASHK-ja Vlorë, me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 17.4.2020, ka konfirmuar se në emër të subjektit të rivlerësimit dhe personave të lidhur nuk figuron e regjistruar pasuri e paluajtshme;
  - ii. kontratë porosie nr. \*\*\*, datë 7.6.2013, e lidhur midis bashkëshortit të subjektit Th. S., si palë porositëse, dhe shoqërisë “I. C. P. D.” sh.p.k., në cilësinë e sipërmarrësit, për porositjen e një apartamenti në kompleksin e banimit “S. V.” në Dh., me sipërfaqe totale 57 m<sup>2</sup> dhe sipërfaqe verande 31 m<sup>2</sup>, kundrejt çmimit total prej 30,000 euro;
  - iii. aktmarrëveshje (e panoterizuar) e datës 18.7.2013 “për zgjidhjen e kontratës së porosisë nr. \*\*\*, datë 7.6.2013”, në të cilën palët kanë deklaruar dhe kthimin e shumës së paguar prej 30,000 euro;
  - iv. kontratë porosie (e panoterizuar) e datës 22.3.2018, e lidhur midis z. Th. S. dhe shoqërisë “I. C. P. D.” sh.p.k. për porositjen e një apartamenti me sip. 82 m<sup>2</sup> dhe verandë me sip. 15 m<sup>2</sup>, kundrejt çmimit 40,000 euro;
  - v. shkresë kthim përgjigje e datës 23.6.2020, nga shoqëria “I. C. P. D.” sh.p.k., në të cilën kanë konfirmuar kryerjen e transaksioneve si më sipërdeklaruar nga subjekti i rivlerësimit, duke bashkëlidhur edhe kontratat e sipërpërmëndura, si dhe kanë informuar se procedurat e regjistrimit të apartamentit në ASHK-në Sarandë nuk kanë përfunduar ende.

#### **Lidhur me analizimin e burimeve për krijimin e kësaj pasurie**

186. Subjekti i rivlerësimit ka deklaruar në përgjigje të pyetësorit nr. 4, se burimi i të ardhurave që ka shërbyer për pagesën e shumës prej 30,000 euro për porositjen e kësaj pasurie në vitin 2013 rrjedh nga të ardhurat e aktivitetit të bashkëshortit të mbartura dhe të vitit 2013. Drejtoria Rajonale Tatimore, me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 16.10.2019, ka informuar se gjatë vitit 2013 Personi Fizik “Th. S.” ka realizuar qarkullim/xhiro në masën 19,839,135 lekë (6,508,435 lekë si biznes i vogël dhe 13,330,700 lekë si biznes i madh) dhe fitim neto pas tatimit në masën 14,431,491 lekë (4,554,509 lekë si biznes i vogël dhe 9,876,982 lekë si biznes i madh).

187. Në analizën e pasurisë në fjalë janë konsideruar tërheqjet e subjektit të rivlerësimit nga llogaria e saj e pagës, si dhe tërheqjet nga kartat e kreditit, deri në datën e kryerjes së transaksionit. Ndërsa, sa i përket të ardhurave të realizuara nga aktiviteti i bashkëshortit, nga shqyrtimi dhe analizimi i pasqyrave financiare të dorëzuara prej këtij të fundit<sup>67</sup> ka rezultuar se gjatë periudhës janar – prill 2013 që aktiviteti ka qenë biznes i vogël, bashkëshorti i subjektit ka tërhequr shumën e fitimeve të kësaj periudhe, në masën 4,554,510 lekë.
188. Ndërkohë, nga bilanci i dorëzuar për periudhën maj – dhjetor 2013 është konstatuar se fitimi i realizuar prej 9,876,982 lekësh nuk është tërhequr prej bashkëshortit të subjektit gjatë këtij viti, pasi në pasqyrën e rrjedhjeve të flukseve monetare të kësaj periudhe është konstatuar se zëri “tërheqje nga pronari” nuk ka ndonjë vlerë të përshkruar. Ka rezultuar se këto fitime janë mbartur në vitin pasardhës dhe kanë qenë gjendje në arkën e personit fizik tregtar në fund të vitit 2013, të cilat, për rrjedhojë, referuar edhe jurisprudencës së KPA-së<sup>68</sup>, nuk mund të konsiderohen si një burim i ligjshëm financiar, i disponueshëm dhe i përdorshëm për ekonominë familjare dhe investimet apo pagesat e kryera.
189. Nisur nga sa më sipër arsyetuar, Shërbimi i Njesisë Ligjore të Komisionit ka kryer analizën financiare, duke përllogaritur të ardhurat me burim të ligjshëm dhe shpenzimet e kryera nga familja e subjektit për të njëjtën periudhë<sup>69</sup>, ku është përfshirë edhe pagesa e kryer për blerjen e automjetit tip “Audi A6” prej 1,402,100 lekësh<sup>70</sup>.

**Tabela nr. 6** – analiza për blerjen e apartamentit në Dh.

Të ardhura nga aktiviteti janar-maj	4,554,510
Tërheqja nga paga dhe CC janar-maj	747,110
Shpenzim për blerje apartamenti në Dh***	- 4,206,300
Shpenzim për blerje automjeti Audi A6	- 1,402,100
Shpenzime janar-maj	- 2,354,257
<b>Rezultati</b>	<b>- 2,661,037</b>

190. Në përfundim të hetimit administrativ lidhur me këtë pasuri, Komisioni, duke i kaluar barrën e provës, i ka njoftuar subjektit rezultatet si vijon:
- Duket se për kryerjen e pagesës prej 30,000 euro për porositjen e apartamentit në Dh., Vlorë, si dhe kryerjen e shpenzimeve dhe investimeve të tjera deri në atë datë, subjekti i rivlerësimit ka pasur një mungesë të burimeve të ligjshme financiare në masën 2,661,037 lekë.

<sup>67</sup> Bilancet e publikuara nga bashkëshorti i subjektit në [www.qkb.gov.al](http://www.qkb.gov.al).

<sup>68</sup> Vendimi nr. 27/2019 (JR), datë 24.10.2019.

<sup>69</sup> Në shpenzimet e familjes janë konsideruar të gjitha shpenzimet e vitit për jetesë dhe pagesë kredie në mënyrë përpjesëtimore, në raport me shpenzimet totale të vitit, si dhe pagesë kartë krediti, arsimimi dhe udhëtimi të familjes deri në datën e transaksionit.

<sup>70</sup> Të blerë me kontratën nr. \*\*\*, datë 27.5.2013.

- Duket se çmimi i kontratës së porosisë së kësaj pasurie nuk pasqyron vlerën e tregut – duke pasur parasysh vendndodhjen dhe funksionin e saj – dhe, për rrjedhojë, duket se është aplikuar një çmim preferencial, i pa deklaruar.
- Duket se revokimi i i kontratës së porosisë së kësaj pasurie nuk është kryer me një akt noterial, për të provuar vullnetin e palëve lidhur me zgjidhjen e kësaj marrëdhënieje porosie.

### **Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit**

191. Pasi është njohur me rezultatet e mësipërme, subjekti i rivlerësimit ka kundërshtuar analizën financiare të kryer nga Komisioni, pasi, sipas tij, nuk pasqyron aftësinë paguese deri në momentin e pagesës së shumës. Subjekti pretendon se bashkëshorti i saj, duke qenë i vetëpunësuar (Person Fizik) të gjitha të ardhurat që krijon i ka të tijat personale dhe ka të drejtën t'i përdorë në çdo kohë për nevoja vetjake. Subjekti ka llogaritur tërheqjet e kryera nga bashkëshorti i saj në llogaritë bankare, të cilat kanë rezultuar në shumën 7,345,568 lekë.
192. Gjithmonë sipas pretendimeve të subjektit, marrëdhënia e parave të individit që përfaqëson statusin e Personit Fizik të licencuar, me vetë arkën dhe bankën e tij, është e pa kufizuar. Kjo, veç të tjerash, nënkupton se të gjitha hyrjet dhe daljet, në dhe nga arka, dhe për rrjedhojë edhe gjendja e arkës në çdo kohë, është në zotërim të individit. Nuk ka asnjë kufizim ligjor që individi, të bëjë në çdo kohë tërheqje totale apo pjesore të parave nga arka e Personit Fizik, sepse këto tërheqje ligjërisht asnjëherë nuk kanë qenë objekt i deklarimeve vjetore tatimore dhe kontabël, gjithashtu nuk janë kualifikuar si dividend, si dhe nuk janë objekt i tatimit mbi të ardhurat, etj. Rregullisht Personi Fizik ka paguar detyrimet tatimore, të ardhurat, shpenzimet dhe fitimi nga ky aktivitet është lehtësisht i verifikueshëm.
193. Sa i përket të ardhurave të aktivitetit të bashkëshortit të subjektit në vitin 2013, të cilat duket se janë mbartur si rezerva të shoqërisë në vitin pasardhës, subjekti ka pretenduar se kemi të bëjmë me një gabim kontabiliteti në deklarim, të bërë nga ekonomisti (personi kompetent që realizon këtë proces) dhe jo para realitetit të një mbartjeje të fitimeve në vitin pasardhës. Nuk ka asnjë logjikë ekonomike dhe as ligjore që fitimet e Personit Fizik të rrinë në arkë të papërdorura, duke e vënë në kushtet e mungesës së burimeve të ligjshme për të mbuluar shpenzimet e kryera dhe pasuritë e krijuara në këto vite nëpërmjet mosllogaritjes së të ardhurave nga aktiviteti i avokatisë së personit të lidhur, si të ardhura në dispozicion të nevojave të njësisë familjare. Me qëllim arritjen e një vendimmarrjeje sa më të drejtë për çështjen, subjekti ka çmuar të arsyeshme që këto të ardhura nga aktiviteti i avokatisë të bashkëshortit të pranohen, pasi ato janë tërhequr fizikisht nga arka e Personit Fizik dhe janë vënë në dispozicion të ekonomisë familjare, duke u përdorur për nevojat e tyre dhe pasaktësia në deklarim nga kontabilisti nuk mbart asnjë pasojë ligjore.
194. Lidhur me konstatimin e mospërputhjes së çmimit të kësaj pasurie me vlerën e tregut, subjekti është shprehur se nuk kemi të bëjmë me një çmim preferencial, pasi kontrata nuk është lidhur për shkak të detyrës. Po ashtu, ka paraqitur kontrata të ngjashme të

lidhura nga kjo shoqëri shitëse me persona të tretë. Në lidhje me kontratën e revokimit, subjekti është shprehur se nuk kërkohet forma noteriale për të qenë e vlefshme dhe vullneti i palëve nuk provohet domosdoshmërisht me akt noterial, për sa kohë Kodi Civil përcakton veprimet juridike të cilat kërkojnë detyrimisht formën noteriale, duke cituar edhe vendimin nr. 27/2019, të Kolegjtit: “Për rrjedhojë, në kushtet që referuar legjislacionit në fuqi, akti i revokimit të kontratës është një akt i vlefshëm, sa i takon formës me anë të së cilës është materializuar vullneti i palëve, pretendimi i Komisionerit Publik që ky akt për të përbërë provë do duhet të kishte formën e aktit noterial, vlerësohet nga trupi gjykues se nuk qëndron”.

195. Gjithashtu, subjekti i rivlerësimit ka paraqitur në cilësinë e provës tri kontrata porosie të lidhura nga shoqëria shitëse “I. C. P. D.” sh.p.k., me porositës të ndryshëm, nga ku rezulton një çmim mesatar i përafërt me atë të paguar edhe për pasurinë në analizë. Konkretisht, nga kontratat e ngjashme të paraqitura, çmimi mesatar ka rezultuar në vlerën 400.10 euro/m<sup>2</sup>, ndërsa subjekti e ka përfituar me çmimin 413.8 euro/m<sup>2</sup>. Në këto kushte, shpjegimet e subjektit lidhur me këtë rezultat/dyshim vlerësohen bindëse.

### **Vlerësimi i trupit gjykues**

196. Nisur nga rezultatet e Komisionit dhe nga pretendimet e argumentimet e subjektit, trupi gjykues in primis vlerëson të qartësojë se, ndonëse është e vërtetë nga njëra anë që subjekti/titullari nuk ka kufizime ligjore, në kuptimin sasior apo kohor, për tërheqjen dhe përdorimin e mjeteve monetare që rezultojnë gjendje në arkën e Personit Fizik që ai përfaqëson, nga ana tjetër legjislacioni dhe udhëzimet/rregulloret përkatëse për mbajtjen e kontabilitetit në njësitë ekonomike parashikon/urdhëron dhe kërkon si kusht regjistrimin dhe pasqyrimin me vërtetësi dhe besueshmëri të gjendjes financiare, performancës, ndryshimeve në gjendjen financiare dhe rrjedhjeve të parasë së njësisë ekonomike.
197. Për rrjedhojë, dhe për sa kohë një gjë e tillë nuk është bërë nga bashkëshorti i subjektit lidhur me shumat e pretenduara si të përdorura – edhe pse në raste të tjera lëvizje/tërheqje të ngjashme janë përshkruar – mbetet e paprovuar shuma e tërhequr dhe momenti i disponimit dhe i përdorimit të tyre dhe nuk mund të mjaftojnë deklaratat e bëra përgjatë procesit të Vetting-ut për të mundësuar konsiderimin e këtyre shumave të pretenduara si të përdorura, si realisht të disponuara/përdorura.
198. Pavarësisht mungesës së efekteve tatimore nëse fitimet do të tërhiqeshin prej pronarit të Personit Fizik, faktikisht në pasqyrat financiare nuk është deklaruar kjo tërheqje, përkatësisht në bilancin 8-mujor të vitit 2013 (maj - dhjetor) dhe në bilancin e vitit 2016. Ndonëse tërheqjet nga llogaritë bankare të bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit mund të jenë në vlera më të larta se shuma e fitimit të vitit përkatës, kjo nuk përjashton kryerjen e pagesave në funksion të aktivitetit dhe nuk provon pasjen e këtyre fondeve për përdorim personal të pronarit të shoqërisë.
199. Për më tepër që mbartja e fitimeve në kapitalin e pronarit dhe mos tërheqja e tyre prej pronarit konfirmohet edhe në pasqyrën e ndryshimeve në kapital dhe në pasqyrën e rrjedhjes së flukseve monetare, nga ku është konstatuar se, ndonëse detyrimet tatimore



mbi të ardhurat e realizuara nga aktiviteti i bashkëshortit janë paguar, ato të ardhura, referuar disa prej pasqyrave financiare të dorëzuara në organet tatimore, nuk kanë qenë të disponueshme për përdorim personal/familjar, për sa kohë aty është përshkruar shprehimisht vijueshmëria e pasjes së shumave të fituara, si të ruajtura/mbartura dhe jo të përdorura.

200. Lidhur me pretendimin e subjektit mbi gabimet e kryera nga kontabilisti, referuar edhe vendimit nr. 27/2019 (JR), datë 24.10.2019, të Kolegjit: “Në referencë të parashikimeve të nenit 29, pika 1 e ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998, ‘Për tatimin mbi të ardhurat’, i ndryshuar, neneve 57 dhe 64, pika 1 dhe 65, pika 4 e ligjit nr. 9920, datë 19.5.2008, ‘Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë’, nenit 3, pika 1, neneve 6, 7 dhe 18, pika 1 e ligjit nr. 9228, datë 29.4.2004, ‘Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare’, personi i lidhur në ushtrimin e aktivitetit si Person Fizik, regjistruar pranë organeve tatimore, është personi përgjegjës për pasqyrat financiare të miratuara prej tij dhe të depozituara pranë organeve kompetente e në këtë kuadër legjislacioni i kërkon atij verifikimin e informacionit të paraqitur në pasqyrat financiare”.
201. Gjithsesi, edhe në rast se do të ishte konstatuar nga z. Th. S. ndonjë gabim material - njerëzor, i kryer prej personelit kontabilist, ai vetë dhe shoqëria/Personi Fizik ka pasur të gjitha mundësitë që të paraqiste/bënte korrigjimet përkatëse në pasqyrat financiare të viteve të mëpasshme, gjë e cila nuk ka ndodhur.
202. Për rrjedhojë, Komisioni, nisur nga dispozitat ligjore përkatëse dhe duke mbajtur në konsideratë jurisprudencën e Kolegjit, të lartpërmendur, ka përllogaritur në analizën financiare të kryer nga Njësia e Shërbimit Ligjor, të gjitha të ardhurat e deklaruara dhe të vërtetuara të subjektit të rivlerësimit dhe të bashkëshortit e familjes së tij, dhe në konkluzion, në këtë rast, rezultati i njoftuar subjektit, në vijim të mbylljes së hetimit administrativ, për këtë pikë nuk ndryshon, duke mbetur një vlerë negative për krijimin e kësaj pasurie në masën prej 2,661,037 lekësh.

#### **9. Automjet tip “Citroen 5”, me targa \*\*\***

203. Kjo pasuri është deklaruar për herë të parë në DIPP-në e vitit 2009, me vlerë 30,000 euro. Në deklaratën Vetting, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar si burim të krijimit të kësaj pasurie shumë prej 27,346 euro, të përfituar nga shitja e truallit në Golem<sup>71</sup> dhe të ardhura nga biznesi i bashkëshortit.
204. Pagesa e shumës prej 30,000 euro është kryer si vijon:
  - a. Në datën 26.3.2009, z. Th. S. ka transferuar nëpërmjet “Tirana Bank” shumë prej 15,000 euro për shoqërinë “A. F.” sh.p.k. për blerje automjeti me targa \*\*\*; në datën 26.3.2009 në “Intesa Sanpaolo Bank” është realizuar transferimi i shumës 4,000 euro nga llogaria në emër të subjektit të rivlerësimit dhe bashkëshortit në llogari të shoqërisë “A. F.” sh.p.k., me përshkrimin “pagesë e veturës me targa \*\*\*”;

---

<sup>71</sup>Shumë e mbetur nga çmimi i shitjes prej 127,346 euro, pas pagimit të apartamentit dhe garazhit në vlerën 100,000 euro, të trajtuara në pikat 5 dhe 6 të këtij relacioni.

b. Në datën 27.3.2009, shtetasi T./T.Ç.<sup>72</sup> ka depozituar *cash* në “Tirana Bank” shumën 11,000 euro në llogari të shoqërisë “A. F.” sh.p.k., me përshkrimin “pagesë e veturës me targa \*\*\*”.

205. Nga shqyrtimi i DIPP-së së vitit 2009 nuk është konstatuar deklarimi i ndonjë marrëdhënieje të mundshme kredie/debie financiare me shtetasin T. Ç.. Për rrjedhojë, lidhur me pagesën prej 11,000 euro të kryer nga babai i subjektit të rivlerësimit për blerjen e automjetit në fjalë, Komisioni i ka kërkuar subjektit të rivlerësimit, nëpërmjet pyetësorit nr. 2, për të sqaruar mbi arsyet e mosdeklarimit të kësaj pagese si dhe burimit të ligjshëm të krijimit të shumës prej 11,000 euro nga babai T. Ç. së bashku me dokumentacionin përkatës. Në përgjigje të sa më sipërkërkuar, subjekti i rivlerësimit ka bërë me dije se: “Pagesa prej 11,000 euro është pjesë e pagesës prej 30,000 euro për blerjen e automjetit, me burim nga të ardhurat familjare dhe kursimet ndër vite. Ky shërbim është kryer nga ana e T. C., për shkak të pamundësisë për ta bërë personalisht apo bashkëshorti. Në këto kushte nuk kam pasur detyrim për deklarimin e kësaj pagese nga ana e babait tim T. Ç.<sup>73</sup>”.

206. Lidhur me këtë pasuri, Komisioni ka administruar dokumentacionin si vijon:

a. Kontratë shitblerjeje e datës 24.3.2009, lidhur ndërmjet palës shitëse “A. F. sh.p.k. dhe palës blerëse Zegjine Sollaku, për shitjen e automjetit tip “Citroen, C5”, me targa \*\*\*, me nr. shasie \*\*\*, kundrejt çmimit 30,000 euro. Në kontratë është përcaktuar se shtetaset Zegjine dhe A. S. (e bija) janë porositëse të automjetit.

b. Faturë tatimore nr. \*\*\*, datë 24.3.2009, lëshuar nga shoqëria “A. F.” sh.p.k., për shitjen e artikullit automjet tip “Citroen C5” (me të dhënat e shasisë si më sipër) kundrejt çmimit 3,933,900 lekë (ekuivalente e shumës prej 30,000 euro).

c. DPSHTRR-ja, me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 26.9.2019, ka konfirmuar pronësinë e automjetit në fjalë, me targa \*\*\*, në emër të subjektit të rivlerësimit duke bashkëlidhur edhe dosjen përkatëse.

### **Lidhur me analizimin e burimeve për krijimin e kësaj pasurie**

207. Nga shqyrtimi i llogarive bankare të bashkëshortit të subjektit është konstatuar se nga burimi i deklaruar prej subjektit në deklaratën Vetting, për krijimin e kësaj pasurie – të ardhurat nga shitja e tokës arë në G. – vetëm shuma prej 15,000 euro është transferuar nga kjo gjendje në llogarinë e bashkëshortit në “Tirana Bank”. Diferenca prej 15,000 euro është transferuar përkatësisht shumat 4,000 euro nga llogaria e bashkëshortit nga “Intesa Sanpaolo Bank” dhe 11,000 euro është derdhur nga babai i subjektit të rivlerësimit në llogari të shoqërisë shitëse. Përveç pagesës së parë prej 15,000 euro, për të cilën ka rezultuar i verifikueshëm burimi i ligjshëm i të ardhurave, nga dokumentacioni i administruar është konstatuar se shuma prej 4,000 euro, e transferuar nga llogaria në “Intesa Sanpaolo Bank” rrjedh nga një derdhje parash në vlerën 12,000 euro, e kryer nga shtetasi F. Sh.<sup>74</sup> në datën 5.9.2008.

<sup>72</sup>Babai i subjektit të rivlerësimit.

<sup>73</sup>Përgjigje e pyetjes nr.1 të pyetësorit nr. 2, për të cilën subjekti i rivlerësimit nuk ka bashkëngjitur dokumentacion provues.

<sup>74</sup>Referuar deklarimeve të subjektit të rivlerësimit në ILDKPKI, shtetasi F. Sh. ka qenë shoferi i bashkëshortit të subjektit.

208. Nga Komisioni janë analizuar veprimet në llogaritë e subjektit dhe të bashkëshortit, për të përcaktuar mundësitë e tyre për të depozituar shumën prej 12,000 euro, në vitin 2008, nga z. F. Sh.. Tërheqjet e kryera nga subjekti dhe bashkëshorti, deri në datën 5.9.2008 kanë rezultuar në total në vlerën 1,856,914 lekë<sup>75</sup>. Po ashtu, janë përlllogaritur të ardhurat nga aktiviteti i bashkëshortit, të cilat referuar shkresës së DRT-së Tiranë, për vitin 2008 fitimi neto ka qenë në masën 3,743,512 lekë. Për periudhën e analizuar është konsideruar nga Komisioni, në mënyrë përpjesëtimore, në raport me fitimin total të vitit, një e ardhur prej 1,871,756 lekësh<sup>76</sup>. Pas përlllogaritjes dhe shpenzimeve të kryera nga familja e subjektit deri në atë moment, ka rezultuar se deri më 5.9.2008, ata mund të dispononin shumën 12,000 euro, me burime të ligjshme financiare.

**Tabela nr. 7** – mundësitë për disponimin e shumës 12,000 euro

Tërheqje nga SR & B/SH (janar-gusht 08')	1 856 914
Të ardhura nga aktiviteti	1 871 756
Derdhur shuma prej 12,000 Euro nga F.Sh.	- 1 478 190
Shpenzime janar-korrik 2008	- 1 094 282
<b>Rezultati</b>	<b>1 156 198</b>

209. Komisioni ka verifikuar gjithashtu edhe tërheqjet nga llogaritë e subjektit të rivlerësimit dhe bashkëshortit, përgjatë muajve janar – mars të vitit 2009, për të përcaktuar mundësitë e dhënies së shumës prej 11,000 euro, babait të subjektit të rivlerësimit për të paguar pjesën e mbetur të çmimit të automjetit të shoqëria shitëse.

**Tabela nr. 8** – mundësitë për disponimin e shumës 11,000 euro

Tërheqje nga SR & B/SH (janar-mars 09')	7 447 970
Paguar kësti III automjetit (nga babai SR)	- 1 508 870
Shpenzime janar-mars 2009	- 650 011
<b>Rezultati</b>	<b>5 289 089</b>

210. Nisur nga sa më sipër, Komisionit i ka rezultuar se subjekti i rivlerësimit ka pasur mjaftueshmëri të burimeve të ligjshme financiare për kryerjen e pagesave të pasurisë në analizë.

#### **10. Automjet tip “Audi 6”, me targa \*\*\***

211. Kjo pasuri është deklaruar për herë të parë nga subjekti i rivlerësimit në DIPP-në e vitit 2013, me vlerën 10,000 euro, por nuk është deklaruar burimi i krijimit të saj. Në deklaratën Vetting, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar si burim krijimi për këtë pasuri të

<sup>75</sup>Më konkretisht 970,000 lekë dhe 7,200 euro, shuma këto të tërhequra nga llogaritë e tyre përkatësisht në “Credins Bank”, “Raiffeisen Bank” dhe “Tirana Bank”.

<sup>76</sup>Duke qenë se aktiviteti i bashkëshortit është regjistruar në datën 30.4.2008, të ardhurat i përkasin një periudhe totale 8-mujore.

ardhurat nga biznesi i bashkëshortit dhe ka cituar: “... fitim i deklaruar për vitin 2012 – 17,301,404 lekë dhe 2013 – 16,035,990 lekë”.

212. Ky automjet është përfituar me anë të kontratës së shitblerjes nr. \*\*\*, datë 27.5.2013, të lidhur ndërmjet djalit të subjektit të rivlerësimit me palën shitëse O. Zh., kundrejt çmimit total prej 10,000 euro. Ka rezultuar se automjeti në fjalë është blerë nga pala shitëse O. Zh.<sup>77</sup>rreth 6 muaj më herët se shitja e lartpërmendur, kundrejt çmimit 18,000 euro, në bazë të kontratës së datës 12.12.2012, të lidhur me shoqërinë “A. O.” sh.p.k. dhe faturës tatimore nr. \*\*\*, datë 12.12.2012.
213. Komisioni i ka kërkuar subjektit të rivlerësimit, nëpërmjet pyetësorit nr. 2, të bëjë me dije mbi shkaqet e blerjes së automjetit në një çmim më të ulët, pas një periudhe të shkurtër 6-mujore nga blerja e tij prej palës shitëse. Në përgjigje të pyetësorit<sup>78</sup>, subjekti i rivlerësimit ka bashkëngjitur një deklaratë noteriale nr. \*\*\*, të datës 4.5.2020, në të cilën shtetasi O. Zh. ka deklaruar se bashkëshortin dhe të birin e subjektit të rivlerësimit nuk i njihte më parë, por si ndërmjetës ka shërbyer një i njohur i përbashkët. Ai është detyruar ta shesë automjetin sepse i nevojiteshin paratë, si dhe sepse automjeti jepte shenjat e një defekti. Në këtë deklaratë dhe në përgjigje të pyetësorit nga subjekti i rivlerësimit është cituar se pala shitëse e ka blerë automjetin me faturë me TVSH, ku vlera 15,000 euro ka qenë çmimi dhe 3,000 euro pagesa për TVSH, ndërsa shitjen e ka kryer pa TVSH. Në këtë kuadër, subjekti i rivlerësimit ka pretenduar se diferenca e çmimit është vetëm 5,000 euro.
214. Lidhur me këtë pasuri, Komisioni ka administruar dokumentacionin si vijon:
- i. kontratë shitblerjeje nr. \*\*\*, datë 27.5.2013, e lidhur ndërmjet palës shitëse O. Zh. dhe palës blerëse B. S. (i biri i subjektit të rivlerësimit) dhe z. Th. S., për blerjen e automjetit tip “Audi”, model A6, prodhim i vitit 2009, me nr. shasie \*\*\*, me targa \*\*\*, kundrejt çmimit 10,000 euro, likuiduar jashtë zyrës noteriale;
  - ii. deklaratë noteriale nr. \*\*\*, të datës 4.5.2020, lëshuar nga shtetasi O. Zh., lidhur me arsyet e shitjes së automjetit për një kohë të shkurtër dhe me një çmim më të ulët dhe, konkretisht: (i) nevoja për realizimin e gjendjes *cash* për kryerjen e pagesave; (ii) vështirësia e gjetjes në treg të personave me gjendje *cash* për të investuar në blerjen e mjetit në fjalë; (iii) shenja të një defekti të mundshëm në kambio;
  - iii. DPSHTRR-ja, me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 26.9.2019, ka konfirmuar që automjeti në fjalë është në pronësi të bashkëshortit dhe djalit të subjektit të rivlerësimit, duke bashkëlidhur edhe praktikën përkatëse<sup>79</sup>.

### **Lidhur me analizimin e burimeve për krijimin e kësaj pasurie**

215. Referuar shkresës me nr. \*\*\* prot., datë 16.10.2019, të DRT-së Tiranë, ka rezultuar se aktiviteti i bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit ka realizuar për vitin 2013,

<sup>77</sup>Për shtetasin O. Zh. rezulton se nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 5.3.2020, ka rezultuar materiali kallëzues nr. \*\*\*, i vitit 2012 për të cilin është marrë vendimi për mosfillimin në datën 3.12.2012.

<sup>78</sup>Referojuni përgjigjes së pyetjes nr. 4.

<sup>79</sup>Në praktikën e ardhur nga DPSHTRR-ja apo kontratat në dispozicion nuk janë përcaktuar dëmtime apo defekte lidhur me automjetin.

qarkullimin/xhiron si biznes i vogël në shumën 6,508,435 lekë dhe si biznes i madh në shumën 13,330,700 lekë, ndërsa fitimi neto pas tatimit si biznes i vogël ka qenë në shumën 4,554,509 lekë dhe si biznes i madh në shumën 9,876,982 lekë.

216. Lidhur me mundësinë për pagesën e shumës prej 10,000 euro për blerjen e automjetit në fjalë, më poshtë janë të përmbledhura të ardhurat dhe shpenzimet<sup>80</sup> e kryera deri në momentin e blerjes së automjetit.

**Tabela nr. 9 – analiza për blerjen e automjetit**

Të ardhura nga aktiviteti janar-maj	4 554 510
Tërheqja nga paga dhe CC janar-maj	747 110
Shpenzim për blerje automjeti Audi A6	- 1 402 100
Shpenzime janar-maj	- 2 354 257
<b>Rezultati</b>	<b>1 545 263</b>

217. Nisur nga sa më sipër, Komisionit i ka rezultuar se subjekti i rivlerësimit ka pasur mjaftueshmëri të burimeve të ligjshme financiare për krijimin/blerjen e pasurisë në analizë.

#### **11. Lidhur me deklarinin e gjendjeve *cash* në banesë**

218. Nga shqyrtimi i deklarimeve vjetore të subjektit të rivlerësimit është konstatuar se nuk është deklaruar në asnjë nga DIPP-të e saj, gjendje e disponuar cash në banesë, përveçse në DIPP-të e vitit 2004, të bashkëshortit të saj, në të cilën është deklaruar gjendje lekë prej 1,500,000 lekësh. Gjithashtu, ka rezultuar se në asnjë nga DIPP-të në vijim, nuk është deklaruar as nga subjekti i rivlerësimit dhe as nga bashkëshorti i saj shtime apo pakësime të kësaj gjendjeje cash. Pasi është pyetur nga Komisioni, nëpërmjet pyetësorit nr. 5, subjekti i rivlerësimit ka shpjeguar se kjo shumë e deklaruar në vitin 2004, është pakësuar me vlerën 600,000 lekë në vitin pasardhës 2005 për arredimin e apartamentit të ndodhur në rrugën “P. R.”, Tiranë dhe pjesa tjetër në fund të vitit 2006. Subjekti ka shtuar gjithashtu se në fund të vitit 2006 e më pas, nuk ka pasur gjendje cash në shtëpi, të detyrueshme për t’u deklaruar.
219. Për sa kohë nga subjekti apo bashkëshorti nuk është deklaruar ndonjë pakësim apo gjendje cash e ndryshuar dhe e mbartur/mbetur në DIPP-në e vitit 2006, në zbatim të dispozitave ligjore përkatëse dhe duke mbajtur në vëmendje edhe jurisprudencën e Kolegjit, lidhur me gjendjet *cash*<sup>81</sup> në analizën financiare të kryer nga Komisioni, kjo gjendje është konsideruar si e shpenzuar në vitin pasardhës – për sa kohë nuk është

<sup>80</sup>Në analizë janë konsideruar tërheqjet e subjektit të rivlerësimit nga llogaria e saj e pagës dhe nga kartat e kreditit, deri në datën e kryerjes së transaksionit, ndërsa të ardhurat nga aktiviteti i bashkëshortit janë konsideruar ato që kanë rezultuar të tërhequra nga aktiviteti. Nga Komisioni janë përlogaritur dhe shpenzimet e kryera nga familja e subjektit deri në atë moment, ku janë përfshirë shpenzimet jetike për një periudhë 5-mujore, shpenzimet e udhëtimeve, shpenzimet e arsimit të djalit, si dhe shpenzimet e kredive e të kartës së kreditit të bashkëshortit.

<sup>81</sup>Vendimet e Kolegjit të Posaçëm të Apelimit kanë trajtuar në disa vendime lidhur me deklarinin e likuiditeteve, konkretisht në vendimet (JR) nr. 11/2019, në pikën 27.12.18 të paragrafit 27; (JR) nr. 19/2019 në paragrafin 84; (JR) nr. 20/2019 në paragrafin 59 dhe (JR) nr. 29/2019 në paragrafin 31, si dhe në vendimin (JR) nr. 27, datë 22.10.2020.

mbartur/ deklaruar dhe pretenduar prej tyre në deklaratën Vetting – pasi deklarimet e subjektit përgjatë hetimit administrativ bien ndesh më deklarimet vjetore të pasurive.

## 12. Deklarimet e gjendjeve në llogaritë bankare të subjektit dhe bashkëshortit

220. Nga përmbajtja e deklarimeve periodike dhe deklaratës Vetting ka rezultuar se – përveçse në deklaratat e viteve 2003, 2004 dhe 2005 – subjekti nuk ka deklaruar gjendjet/shtesat apo pakësimet monetare në llogaritë bankare rrjedhëse apo të depozitave në vitet e tjerë. Në DIPP-në e vitit 2015, subjekti ka deklaruar vetëm gjendjet e dy prej llogarive bankare dhe, më pas, në deklaratën Vetting nuk ka deklaruar asnjë prej gjendjeve në llogaritë bankare apo në depozitë – ndryshe nga parashikimet ligjore në ligjin nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.
221. Nisur nga sa më sipër, Komisioni i ka kërkuar shpjegime subjektit të rivlerësimit, nëpërmjet pyetësorit nr. 7, mbi arsyet e mosdeklarimit të likuiditeteve në llogaritë bankare, në depozitë apo gjendje cash në deklaratat ndër vite, si dhe në deklaratën Vetting. Në përgjigje të këtij pyetësi, subjekti është shprehur se në deklarimet<sup>82</sup> e saj dhe/apo të bashkëshortit janë deklaruar shtesat e të ardhurave si pasojë e shitblerjeve të pasurive, ndërkohë që gjendjet/shtesat apo pakësimet në llogaritë e pagave nuk janë deklaruar, pasi janë deklaruar si të ardhura në rubrikën përkatëse të të ardhurave. Llogaritë e bashkëshortit të aktivitetit të tij tregtar nuk janë deklaruar, duke qenë se ato deklaroheshin në bilancet e shoqërisë. Po ashtu, subjekti ka shtuar se në kuptimin e saj deklarimet janë bërë të sakta, por në rast se do të konstatohet mosdeklarimi në ndonjë nga llogaritë bankare, kjo ka ardhur si pasojë e ndonjë lapsusi, nxitimi apo mosvëmendjeje, pa pasur qëllimin e fshehjes apo deklarimit të rremë.

---

<sup>82</sup>Subjekti ka bërë sqarimet konkretisht: “Në vitin 2006 gjendja e likuiditetit në bankë ka qenë e pandryshuar, me përjashtim të llogarisë së pagës. Në vitin 2007 kemi shtuar 57,375 euro në ‘Tirana Bank’ nga shitblerje pasurish, deklaruar te deklarata pas largimit nga funksioni të bashkëshortit dhe llogari bankare të pagës time dhe bashkëshortit. Në vitin 2008 kam deklaruar blerje automjeti në shumën 20,000 euro dhe pagesë kësti apartamenti 30,000 euro, të cilat janë pakësuar nga llogaria e bashkëshortit pranë ‘Tirana Bank’. Këto deklarime verifikohen dhe nga lëvizjet e llogarisë megjithëse nuk janë deklaruar më vete. Llogaritë e tjera janë: (a) llogaritë e pagës deklaruar si e ardhur; dhe (b) llogaritë e aktivitetit të bashkëshortit nga ushtrimi i veprimtarisë, të cilat nuk janë deklaruar prej meje duke vlerësuar se i nënshtrohen legjislacionit për shoqëritë tregtare dhe deklarohen në bilancet e aktivitetit. Në vitet 2009 dhe 2010 janë të njëjtat numra llogarish bankare në të cilat janë kryer disa lëvizje bankare për shitblerje pasurie, lehtësisht të verifikueshme. Llogaria e pagës ka lëvizje vetëm për të ardhurat nga paga, ndërsa llogaritë e biznesit të bashkëshortit i nënshtrohen legjislacionit dhe rregullave të kontabilitetit për tregtarët dhe shoqëritë tregtare dhe që deklarohen në bilancet e shoqërisë. Në vitin 2011 kemi pasur në bankë gjendje të vogla likuiditetesh, rezultat i veprimeve bankare në vitet 2009-2010 me përjashtim të llogarisë së pagës time pranë ‘Credins Bank’ në shumën 947,370 lekë me të ardhurat nga punësimi të deklaruara si të ardhura. Në vitin 2012 gjendja e likuiditeteve në bankë ka qenë 867,386 lekë në llogarinë e pagës time pranë ‘Credins Bank’ krijuar me të ardhurat nga punësimi të deklaruara si të ardhura. Bashkëshorti më ka sqaruar se ka pasur një overdraft pranë ‘Union Bank’ në shumën 100,000 euro në llogarinë si person fizik për llogari të aktivitetit të tij tregtar të deklaruar në bilancin e veprimtarisë tregtare konform rregullave të kontabilitetit dhe legjislacionit përkatës. Në vitin 2013 totali i likuiditeteve në banka ka qenë 855,668 lekë dhe ka qenë kryesisht i krijuar nga gjendja e llogarisë time nga paga në ‘Credins Bank’. Në vitin 2014 e vetmja llogari me balancë pozitive ka qenë llogaria e pagës time. Në vitin 2015 kam deklaruar gjendje pranë ‘Tirana Bank’ 2,540,000 lekë dhe gjendje pranë ‘Credins Bank’ 1,343,363 lekë, pra kam deklaruar të gjitha llogaritë ku kam pasur gjendje likuiditetesh. Në vitin 2016 familja ime nuk ka pasur gjendje likuiditetesh në bankë. E vetmja llogari me balancë pozitive ka qenë llogaria e pagës time pranë ‘Credins Bank’”.

222. Nga shqyrtimi i deklaratave periodike të viteve 2012 – 2016 është konstatuar se prej subjektit dhe bashkëshortit janë deklaruar të ardhura familjare, si dhe marrja e kredive bankare, në vlera të konsiderueshme, ndërkohë që përgjatë të njëjtës periudhë, prej subjektit apo bashkëshortit nuk është deklaruar ndonjë shpenzim/investim apo gjendje e kursimeve të mundshme. Komisioni i ka kërkuar subjektit të rivlerësimit, nëpërmjet pyetësorit nr. 7, të japë shpjegimet mbi mënyrën e përdorimit apo të ruajtjes së tyre.
223. Në përgjigje të sa më sipër, subjekti i rivlerësimit është shprehur se: “Shumat e të ardhurave familjare të deklaruara në vitet 2012-2016 përbëhen nga të ardhurat e biznesit të bashkëshortit si avokat. Këto të ardhura gjenden të deklaruara edhe në bilancet e biznesit të bashkëshortit për ato vite. Përdorimi apo ruajtja e tyre është sqaruar në bilancet vjetore përkatëse të biznesit të bashkëshortit, si gjendje arke apo tërheqje nga pronari. Transaksionet bankare dhe kreditë e evidentuara nëpërmjet gjendjeve të bankës janë kryesisht të bashkëshortit tim në funksion të aktivitetit të tij si tregtar apo veprime të tjera tregtare të vlerësuara prej tij. Ato janë të gjitha veprime të kryera nëpërmjet sistemit bankar me të ardhura nga kredi bankare apo veprimtari të tij si tregtar”.
224. Në përfundim të hetimit administrativ, lidhur me këtë pasuri, Komisioni, duke i kaluar barrën e provës, i ka njoftuar subjektit rezultatet e mëposhtme:
- Duket se subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshorti nuk kanë deklaruar në DIPP-të ndër vite (2006 – 2016) shtesat apo pakësimet në llogaritë e tyre bankare.
  - Po ashtu, duket se subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshorti kanë kryer deklaram të pamjaftueshëm në deklaratën Vetting, për sa kohë nuk është deklaruar asnjë nga gjendjet e disponuara në llogaritë e tyre bankare, në mospërbushje të parashikimeve të ligjit nr. 84/2016.

#### **Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit**

225. Pasi është njohur me rezultatet e mësipërme, subjekti i rivlerësimit ka shpjeguar se ka menduar që duke deklaruar numrat e llogarive ka deklaruar edhe përkatësisht gjendjet e tyre. Nuk ka asnjë mundësi që nëpërmjet mosdeklarimit të shtesës ose pakësimit të ketë dashur të fshehë apo të bëjë deklaram të pasaktë, pasi ato janë veprime bankare të dukshme dhe lehtësisht të provuara, të cilat nuk mund të mosdeklarohen apo të fshihen.
226. Po ashtu, veprimet janë lehtësisht të verifikueshme sikurse edhe burimi i të ardhurave, për sa kohë duke deklaruar llogarinë ka përmbushur detyrimin dhe krijuar mundësi për çdo verifikim të mëtejshëm. Subjekti ka cituar vendimin nr. 13, datë 20.6.2019 të KPA-së, ku shprehet se: “Ligji nr. 84/2016, në nenin 61, pika 3, ka përcaktuar se masa disiplinore e shkarkimit nga detyra jepet kur rezulton se subjekti ka bërë deklaram të pamjaftueshëm për kontrollin e pasurisë, sipas parashikimeve të nenit 33 të këtij ligji. Në vijim të analizës dhe interpretimit të dispozitave ligjore si më sipër, sipas ligjit nr. 84/2016 pamjaftueshmëria e deklaramit për deklarimet e mëparshme periodike të pasurisë, nëse subjekti ka bërë deklaram të pasaktë, ka fshehur pasurinë apo ka bërë deklaram të rremë, në vitet përkatëse, nuk është element i mjaftueshëm për t’u konsideruar si një shkak i vetëm dhe i veçuar, që prodhon situatën e deklaramit të

pamjaftueshëm, në kuptim të neneve 33, pika 5 dhe 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016 për shkarkimin e subjektit”.

### **Vlerësimi i trupit gjykues**

227. Lidhur me sa më lart, trupi gjykues vlerëson të evidentojë faktin se së pari, në rastin konkret – sikurse është shprehur qartë edhe rezultatet e hetimit të bëra me dije subjektit dhe të përshkruara më sipër - nuk kanë të bëjnë vetëm me pasaktësi apo pamjaftueshmëri në deklaratimet periodike, por kjo problematikë është konstatuar edhe për sa i përket deklaratës Vetting. Së dyti, për një analizë dhe vlerësim sa më objektiv dhe gjithëpërfshirës, përpos tipologjisë specifike të mosdeklarimeve të konstatuara në këtë pikë, kjo problematikë do të çmohet së bashku me problematikat e tjera të kësaj natyre, në konkluzionet përfundimtare lidhur me vlerësimin e kriterit të pasurisë.

### **13. Lidhur me disa pasuri të tjera të deklaruara në deklaratën Vetting**

228. Në deklaratën Vetting, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar gjithashtu se përveç pasurive të përmendura më sipër, ndër vite, ka pasur në pronësi edhe pasuritë e mëposhtme, me të cilat janë përfituar burime financiare pasi janë kryer transaksionet e tyre, si vijon:

#### **13.1 Pasuria apartament 2+1, lagjja “K. P.”, Fier**

229. Kjo pasuri është trajtuar pjesërisht në pasurinë nr. 1 dhe në pasuritë nr. 5 dhe 6. Siç është përshkruar dhe më lart, kjo pasuri është përfituar me anë të kontratës për privatizimin e banesës në vitin 1992, kundrejt çmimit 2,561 lekë, si dhe rezulton të jetë shitur me anë të kontratës së shitblerjes nr. \*\*\* regj., nr. \*\*\* kol., datë 7.1.1998, kundrejt çmimit 1,100,000 lekë. Sa i përket blerjes së kësaj pasurie në vitin 1992, në shumën 2,561 lekë, nuk janë konstatuar problematika lidhur me burimet financiare.

#### **13.2 Garazh, ndërtim provizor, në Tiranë, shitur në vitin 1997, në shumën 800,000 lekë**

230. Kjo pasuri nuk ka rezultuar e regjistruar/tjetërsuar në asnjë nga përgjigjet e ASHK-së Tiranë me shkresat nr. \*\*\* prot., datë 15.10.2019<sup>83</sup>, nr. \*\*\* prot., datë 15.10.2019<sup>84</sup>, nr. \*\*\* prot., datë 15.10.2019<sup>85</sup>, nr. \*\*\* prot., datë 21.10.2019<sup>86</sup> dhe nr. \*\*\* prot., datë 14.10.2019<sup>87</sup> në përgjigje të kërkesës së Komisionit, si dhe në shkresën nr. \*\*\* prot., datë 15.12.2018, nga ZQRPP-ja, të dërguar ILDKPKI-së. Në këto kushte, Komisioni i ka kërkuar subjektit të rivlerësimit, nëpërmjet pyetësorit nr. 3, të paraqesë dokumentacionin përkatës mbi mënyrën e përfitimit të kësaj pasurie, si dhe të shitjes më pas të saj.

231. Në përgjigje të kërkesës së Komisionit, subjekti ka paraqitur:

a. Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 11.5.2020, nga Drejtoria e Kontrollit të Zhvillimit të Territorit në të cilën është bashkëngjitur vendimi me nr. \*\*\*, datë 2.7.1996, i KRRT-

<sup>83</sup>ASHK-ja Tirana Jug.

<sup>84</sup>ASHK-ja Tirana Rurale 2.

<sup>85</sup>ASHK-ja Kamëz – Vorë.

<sup>86</sup>ASHK-ja Tirana Veri.

<sup>87</sup>ASHK-ja Tirana Rurale 1.



së për miratimin e lejes së ndërtimit të përkohshëm të një garazhi në rrugën “S. F.”, në emër të shtetasit Th. S..

- b. Deklaratë noteriale nr. \*\*\*, datë 27.5.2020, nga shtetasi L. M., i cili ka deklaruar se në vitin 1996 ka ndihmuar bashkëshortin e subjektit të rivlerësimit duke i ndërtuar një garazh provizor me materialet që i kishin tepruar dhe punëtorët e tij, si dhe për shkak të marrëdhënieve miqësore nuk i ka kërkuar asnjë pagesë.
- c. Deklaratë noteriale nr. \*\*\*, datë 21.5.2020, nga shtetasi B. T., i cili ka deklaruar se nga fundi i vitit 1996/fillimi i vitit 1997 ka blerë nga bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit garazhin, kundrejt çmimit 800,000 lekë, i cili është paguar *cash*. Ai ka deklaruar se kanë bërë një kontratë dore për të, si dhe garazhi më pas është prishur.
232. Nga dokumentacioni i paraqitur prej subjektit, ndonëse është marrë një leje ndërtimi për garazhin e pretenduar si të shitur, nuk ka rezultuar e provuar ekzistenca/ndërtimi dhe/ose regjistrimi i tij pas përfundimit të punimeve të ndërtimit, si dhe nuk është paraqitur asnjë kontratë shitblerjeje që të provojë shitjen më pas të tij. Në këto kushte, të ardhurat e pretenduara në shumën prej 800,000 lekësh, nga shitja e garazhit në fjalë, mbeten vetëm në nivel deklarativ dhe, për rrjedhojë, nuk janë përfshirë në analizën financiare si të ardhura me burim të ligjshëm, për sa kohë deklarimet apo dëshmitë nuk mund të provojnë një fakt që në bazë të dispozitave ligjore duhet të kryhet në mënyrën dhe format e parashikuara – sikurse është tjetërsimi i një pasurie të paluajtshme, për të cilën veç të tjerash nuk është provuar as disponimi/pronësia e të drejtave reale mbi të, madje as ekzistenca fizike e pasurisë në fjalë.

#### **14. Apartament me sipërfaqe 52.3 m<sup>2</sup>, kompleksi X., G., Durrës, në shumën 25,000 USD<sup>88</sup>**

233. Nga dokumentacioni i administruar nga Komisioni ka rezultuar se ky apartament është blerë me anë të kontratës së shitblerjes nr. \*\*\*, datë 29.3.2007, e lidhur ndërmjet bashkëshortit të subjektit dhe shoqërisë shitëse “G.” sh.p.k., kundrejt çmimit 25,000 USD. Në këtë kontratë, palët kanë deklaruar se çmimi është likuiduar *cash* në datën 22.10.2006, si dhe është bashkëngjitur mandatpagesa që mban po këtë datë. Ky apartament është shitur më pas me anë të kontratës nr. \*\*\*, datë 30.3.2016, në shumën 2,000,000 lekë.
234. Burimi për këtë pasuri është deklaruar nga të ardhurat nga shitja e apartamentit cituar më sipër në vlerën 45,000 USD. Nga shqyrtimi i lëvizjeve bankare të bashkëshortit të subjektit është konstatuar se shuma prej 45,000 USD, e derdhur nga shtetasi A. H., nga ky moment e në vijim deri në janar të vitit 2007, nuk është bërë asnjë tërheqje apo transfertë e asnjë shume nga kjo llogari. Rrjedhimisht, kjo shumë nuk mund të ishte përdorur si burim për blerjen e apartamentit në G., Kavajë në datën 22.10.2006.
235. Ndërkohë, nga shpjegimet e saj, në përgjigje të pyetësorit nr. 7<sup>89</sup>, subjekti është shprehur se: “Për pagesën e kështit 25,000 USD kanë shërbyer kursimet familjare (gjendja *cash* në shtëpi deri në këtë moment duke e bërë 0 dhe të ardhurat e atij viti”. Lidhur me këtë

<sup>88</sup>Ekuivalenti prej 2,341,800 lekësh sipas kursit mesatar të fundit të vitit 2006, ku 1 USD këmbehej me 93,672 lekë.

<sup>89</sup>Në të cilin subjekti është pyetur mbi disponimin dhe deklarimin e gjendjeve *cash* në shtëpi apo në llogaritë e saj bankare.

deklarim, siç është shpjeguar dhe më lart, kursimet e fundit të vitit 2004, të pretenduara në përgjigje të pyetësorit, si të mbetura pjesërisht në shtëpi, edhe në vitin 2006, nuk mund të konsiderohen, për sa kohë, subjekti nuk ka deklaruar në vitin 2005 apo 2006, disponimin e ndonjë kursimi të mbetur apo pakësimi të tij. Për rrjedhojë, në analizën financiare përkatëse janë përfshirë vetëm të ardhurat e vitit 2006, deri në momentin e kryerjes së pagesës.

**Tabela nr. 10** - analiza për blerjen e pasurisë në G., Kavajë

Të ardhura janar - tetor 2006	2 573 745
Gjendje cash e disponuar në shtëpi	-
Shpenzim për blerje apartamenti në Golem	- 2 341 800
Ndryshimi në likuiditete	- 443 713
Shpenzime janar - 22 tetor 2006	- 1 515 207
<b>Rezultati</b>	<b>- 1 726 975</b>

236. Në përfundim të hetimit administrativ, lidhur me këtë pasuri, Komisioni, duke i kaluar barrën e provës, i ka njoftuar subjektit rezultatet e mëposhtme:

- Duket se ka pasaktësi në deklarimin e subjektit në deklaraten Vetting, sa i përket burimit të krijimit të kësaj pasurie, pasi të ardhurat e pretenduara nga shitja e apartamentit në Fier, duket se nuk janë përdorur si burim për pagesën e këtij apartamenti në analizë.
- Duket se për kryerjen e pagesës prej 25,000 USD për blerjen e pasurisë në fjalë, si dhe kryerjen e shpenzimeve deri në atë moment, subjekti i rivlerësimit ka pasur një mungesë të burimeve të ligjshme financiare në masën 1,726,975 lekë.

#### **Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit**

237. Lidhur me burimet e krijimit të kësaj pasurie, subjekti ka pretenduar se për pagesat e kësaj pasurie janë përdorur gjendjet cash prej 900,000 lekë, të disponuara si gjendje të mbetura në fund të vitit 2005, pasi ishte përdorur shuma prej 600,000 lekësh prej shumës së deklaruar cash në deklaraten e vitit 2004, për një total prej 1,500,000 lekësh. Po ashtu, subjekti lidhur me shpenzimet e udhëtimit gjatë vitit 2006 ka kërkuar të merret në konsideratë fakti se ka pasur shumë udhëtime zyrtare nga bashkëshorti i saj për shkak të pozicionit të punës së tij si Prokuror i Përgjithshëm i Republikës së Shqipërisë, por për udhëtimet që janë paguar nga palët pritëse është në pamundësi për të gjetur dokumentacion. Veç sa më lart, pretendohet se ka pasur edhe të ardhura të tjera të cilat sot është në pamundësi objektive për t'i provuar për shkak të kohës së largët referuar pikës 2, të nenit 32, të ligjit nr. 84, datë 30.8.2016 – por pa i cituar as të ardhurat dhe as vështirësitë apo pamundësitë konkrete që do të mund të bënin të aplikueshëm në rastin konkret këtë dispozitë.

#### **Vlerësimi i trupit gjykues**

238. Sa i përket gjendjes cash të vitit 2004, të pretenduar si të mbartur në vitin 2005 dhe të përdorur në vitin 2006, siç është argumentuar edhe më lart, ky pakësim nuk është

deklaruar prej subjektit në DIPP-në e vitit 2005, si dhe këto kursime cash nuk janë përmendur si burim as në DIPP-në e vitit 2006 dhe as në deklaratën Vetting. Për rrjedhojë, në mungesë të deklarimit të pakësimit të gjendjes cash dhe të shpenzimit të kryer me këtë burim, të pa cituar në vitin 2006 dhe në deklaratën Vetting, duke mbajtur në vëmendje edhe jurisprudencën specifike të KPA-së<sup>90</sup>, ky pretendim i subjektit nuk mund të pranohet. Sikurse trupi gjykues nuk gjen shkaqe për aplikimin e nenit 32 të ligjit nr. 84/2016, lidhur me pamundësinë objektive për të provuar burime financiare alternative – të cilat as nuk janë përshkruar apo evidentuar në këtë pretendim të subjektit, i konsideron të pabazuara.

239. Lidhur me shpenzimet për udhëtimet e bashkëshortit të vet, subjekti, në analizën e kryer ka pretenduar uljen e shpenzimeve të periudhës 2005 – 2007, në total në vlerën 964,040 lekë (përkatësisht shumat: 311,252 lekë në vitin 2005; 369,872 lekë në vitin 2006; dhe 282,916 lekë në vitin 2007), e cila mbetet e paprovuar, si e përballuar nga institucione apo persona të tretë dhe, për rrjedhojë, nuk mund të pranohen pretendimet e subjektit pasi ato mbështeten vetëm në supozime dhe mbeten në nivel deklarativ – ndonëse faktet edhe mund të kenë qenë sipas pretendimeve.
240. Gjithsesi, për të shuar çdo dyshim mbi një vlerësim objektiv, vërehet se edhe në rast të pranimit të pretendimeve të subjektit, mbi uljen e shpenzimeve të udhëtimeve, lidhur me këtë pasuri do të rezultonte sërish një pamundësi financiare në vlerën negative prej – 1,357,103 lekësh, ndërkohë që në rezultatet e hetimit ishte konstatuar një pamjaftueshmëri financiare në vlerën negative prej 1,726,975 lekësh – ndryshim ky që nuk do të pasqyroste asnjë përmbysje të mundshme në analizën financiare dhe, për rrjedhojë, as në vlerësimin përfundimtar të kriterit të pasurisë, parë në një panoramë të përgjithshme.

### **15. Automjet tip “Toyota”, me targa \*\*\*, me vlerë 50,000 euro**

241. Nga dokumentacioni i administruar nga Komisioni ka rezultuar se ky automjet është marrë me qira financiare nga shoqëria “T. L.” sh.a., me anë të kontratës themelore të qirasë financiare nr. \*\*\*, datë 22.4.2008, sipas së cilës vlera totale e pasurisë ishte 50,000 euro, nga të cilat 40% e vlerës (20,000 euro) duhet të paguheshin brenda datës 18.4.2008 dhe pjesa tjetër prej 30,000 euro do të paguhej në bazë mujore.
242. Burimi financiar i kësaj pasurie në deklaratën *Vetting* është deklaruar nga: (i) shuma 20,000 USD e mbetur nga shitja e apartamentit në vlerën 45,000 USD, në Fier; (ii)

---

<sup>90</sup>Kolegji i Posaçëm i Apelit ka trajtuar në disa vendime lidhur me deklarimin e likuiditeteve, konkretisht në vendimet (JR) nr. 11/2019, në pikën 27.12.18 të paragrafit 27; (JR) nr. 19/2019 në paragrafin 84; (JR) nr. 20/2019 në paragrafin 59 dhe (JR) nr. 29/2019 në paragrafin 31, ku tashmë është konsoliduar dhe e aplikuar në disa subjekte rivlerësimi me situata të ngjashme. Konkretisht, në vendimin (JR) nr. 27, datë 22.10.2020, Kolegji, ndër të tjera, arsyeton se: “... në dritën edhe të jurisprudencës së deritanishme të Kolegjit (shih vendimet nr. 6/2018, nr. 8/2018, nr. 9/2018, nr. 11/2018, nr. 12/2018, nr. 5/2019, nr. 19/2019, nr. 20/2019 etj.), në kushtet kur shpjegimet mbi gjendjen e likuiditeteve cash jashtë sistemit bankar bien ndesh me deklarimet e vetë subjektit të rivlerësimit në deklaratat e interesave private periodike vjetore, të cilat konsiderohen provë në procesin e rivlerësimit, në zbatim të nenit 32, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, dhe së bashku me deklaratën Vetting përbëjnë të vetmen mënyrë verifikimi të ekzistencës së kësaj pasurie në funksion të procesit të rivlerësimit... ndërsa deklarimet periodike vjetore përbëjnë dokument zyrtar sipas ligjit dhe janë të vetmet referenca të ekzistencës së likuiditeteve cash jashtë sistemit bankar, dhe kanë vlerë prove në procesin e rivlerësimit në zbatim të nenit 32, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, analiza e deklaratës Vetting dhe e shpjegimeve të subjekteve në proces përkundër deklaratave periodike është esenciale në vlerësimin e krijimit të pasurive në analizë të mundësive të krijimit me burime të ligjshme”.

kursimet familjare në vite nga të ardhurat nga pagat dhe shpërblimet; dhe (iii) të ardhurat nga biznesi i bashkëshortit. Me kontratën e zëvendësimit të qiramarrësit nr. \*\*\*, datë 27.8.2009, është marrë shuma 20,000 euro mbrapsht dhe automjeti i është dorëzuar shoqërisë “T. L.” sh.a., duke vazhduar kontrata e qirasë financiare nga shoqëria “N.” sh.p.k.<sup>91</sup>.

243. Nga shqyrtimi i lëvizjeve në llogaritë bankare të bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit është konstatuar se shuma prej 20,000 euro është paguar nga llogaria e tij në euro, në “Tirana Bank”, gjendje kjo e cila është krijuar nga pagesat (50,000 euro në vitin 2006) e shtetasit A. T. për blerjen e pasurisë së llojit “truall” në G., ndërkohë që shuma prej 45,000 USD nga shitja e apartamentit në Fier vazhdon ende të mbetet e papërdorur.
244. Në përgjigje<sup>92</sup> të pyetësit nr. 2, të dërguar nga Komisioni, subjekti ka paraqitur kontratën për zëvendësimin e qiramarrësit me nr. \*\*\*, të datës 27.8.2009, të lidhur ndërmjet shoqërisë “T. L.” sh.a. (në cilësinë e qiradhënësit) dhe z. Th. S. (qiramarrës) dhe shoqërisë “N.” sh.p.k. (qiramarrës zëvendësues), përfaqësuar nga znj. N. N. (e cila rezulton dhe dorëzanëse).
245. Po ashtu, në lëvizjet bankare të “Tirana Bank” është provuar dhe transferimi i shumës prej 20,000 euro nga llogaria e shoqërisë “N.” sh.p.k. në llogarinë e z. Th. S., në datën 16.7.2009, me përshkrimin: “pagesë për blerje makine”.
246. Në përfundim të hetimit administrativ, lidhur me këtë pasuri, Komisioni, duke i kaluar barrën e provës, i ka njoftuar subjektin rezultatet e mëposhtme – të cilat konfirmohen për sa kohë nuk kanë pësuar ndryshime për shkak të prapësimeve të subjektit.
- Duket se ka pasaktësi në deklarinë e subjektit në deklaratën Vetting, për sa i përket burimit të krijimit të kësaj pasurie, pasi nga lëvizjet bankare ka rezultuar se burimi i përdorur për këtë pasuri rrjedh nga të ardhurat e shitjes së truallit në G. dhe qirasë financiare dhe jo nga burimet e përshkruara si të tilla në deklarinë e subjektit.
  - Duket se nuk janë konstatuar problematika lidhur me mundësitë financiare për blerjen e kësaj pasurie.

## **16. Automjet tip “Mercedes Benz”, me targa \*\*\*, me vlerë 50,000 euro**

247. Nga dokumentacioni i administruar ka rezultuar se ky automjet është përfituar nëpërmjet faturës nr. \*\*\*, datë 16.9.2009, nga P. L. G., për z. Th. S., për blerjen e automjetit tip “Mercedes Benz S320 CDi”, viti i prodhimit 2008, kundrejt vlerës 42,016.81 euro dhe 7,983.19 euro vlere e TVSH-së, e cila, referuar faturës është depozituar si kapar deri në momentin e njoftimit të eksportit. Nga llogaria e bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit pranë “Intesa Sanpaolo Bank” është kryer edhe pagesa e zhdoganimit të këtij automjeti në datën 22.9.2009, në shumën 1,242,884 lekë.

---

<sup>91</sup>Fillimisht, në DIPP-në e vitit 2008, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar blerjen e automjetit tip “Toyota Land Rover” në çmimin total prej 50,000 euro, nga të cilat 20,000 euro janë paguar dhe 30,000 euro janë marrë me leasing pranë “T. L.” sh.a. Më pas në DIPP-në e vitit 2009, ajo ka deklaruar se ka shitur këtë automjet në shumën 20,000 euro.

<sup>92</sup>Referojuni përgjigjes së pyetjes nr. 10, në pyetësin nr. 2.

248. Burimi financiar i përdorur për këtë pasuri është deklaruar nga të ardhurat nga shitja si më sipër e automjetit tip “Toyota” (20,000 euro), të ardhurat nga pagat, nga biznesi i bashkëshortit (2008-2009), si dhe nga mësimdhënia në universitetet private “M. B.”, “K.”, Universiteti E., etj. Automjeti në fjalë është shitur me anë të kontratës së shitblerjes me nr. \*\*\*, datë 12.11.2015, kundrejt çmimit 18,000 euro.
249. Për sa i përket burimeve të deklaruara nga subjekti në deklaratën Vetting, nga verifikimet e kryera në lëvizjet e llogarive bankare, është konstatuar se shuma prej 20,000 euro e transferuar nga shoqëria tregtare “N.” sh.p.k., në llogarinë e z. Th. S. në datën 16.7.2009, nuk është tërhequr dhe nuk është transferuar deri në shtator të vitit 2009 kur është kryer blerja e automjetit tip “Mercedes-Benz”. Rrjedhimisht, kjo shumë nuk mund të ishte përdorur si burim për blerjen e automjetit në fjalë, në shtator të vitit 2009. Sa i përket të ardhurave nga mësimdhënia e bashkëshortit, nga lëvizjet bankare, është konstatuar gjithashtu se të ardhurat nga universiteti “K.” dhe pagesat kalimtare nga ISSH-ja, janë përdorur për blerjen e apartamentit të ndodhur në K., Kavajë. Po ashtu, të ardhurat nga Universiteti E. nuk janë tërhequr deri në vitin 2010 dhe rrjedhimisht nuk mund të ishin përdorur për blerjen e automjetit.
250. Për rrjedhojë, Komisioni ka përlllogaritur tërheqjet nga llogaritë e subjektit dhe të bashkëshortit, për periudhën prill<sup>93</sup> deri në momentin e kryerjes së pagesës, si dhe të ardhurat nga aktiviteti i bashkëshortit, në mënyrë përpjesëtimore, për të përcaktuar mundësinë e disponimit të kursimeve në masën 50,000 euro në shtator të vitit 2009, duke zbritur gjithashtu edhe shpenzimet e së njëjtës periudhë. Komisioni ka shtuar edhe diferencën pozitive prej 5,289,089 lekësh<sup>94</sup>, si kursime të mbetura në fund të muajit mars 2009, të rezultuara nga analiza pas blerjes së automjetit tip “Citroen 5”.

**Tabela nr. 11** – analiza për blerjen e pasurisë automjet tip “Mercedes-Benz”

Tërheqje nga llogaritë prill-gusht 2009	1 403 000
Të ardhura nga aktivitetit prill-gusht 2009	3 515 289
Të mbetura pas blerjes së automjetit në mars	5 289 089
Shpenzime për blerje automjeti	- 6 858 500
Shpenzime prill-gusht 2009	- 2 212 293
<b>Rezultati</b>	<b>1 136 584</b>

251. Lidhur me pagesën e kryer prej 1,242,884 lekësh për zhdoganimin e automjetit janë përdorur të ardhurat nga mësimdhënia në universitetin “K.” dhe të ardhurat nga pagesat kalimtare nga ISSH-ja, të cilat ishin gjendje në llogarinë e bashkëshortit në “Intesa Sanpaolo Bank”.
252. Gjithashtu, është konstatuar se në datën 7.10.2009, në llogarinë e bashkëshortit të subjektit, pranë “Tirana Bank” është kthyer mbrapsht shuma e TVSH-së prej 7,958,70 euro nga pala shitëse P. L. G..

<sup>93</sup>Nisur nga fakti se deri në fund të marsit të vitit 2009, Komisioni ka kryer analizën financiare për kryerjen e pagesës për blerjen e automjetit tip “Citroen 5”, të trajtuar në pasurinë me nr. 9.

<sup>94</sup>Referojuni tabelës në pasurinë nr. 9.

253. Në përfundim edhe lidhur me këtë pasuri, Komisioni i ka njoftuar subjektit rezultatet e mëposhtme – të cilat edhe në këtë rast konfirmohen për sa kohë nuk kanë pësuar ndryshime për shkak të prapësimeve të paraqitura nga subjekti.
- Duket se ka pasaktësi në deklarimin e subjektit në deklaratën Vetting, sa i përket burimit të krijimit të kësaj pasurie, pasi nga lëvizjet bankare ka rezultuar se burimet e përmendura në deklarimin e subjektit nuk janë përdorur për këtë qëllim.
  - Duket se nuk janë konstatuar problematika lidhur me mjaftueshmërinë e burimeve të ligjshme financiare për blerjen e kësaj pasurie.

### **17. Gjetje të tjera nga dokumentacioni i administruar**

254. Nga lëvizjet bankare të bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit në bankat e nivelit të dytë apo institucione të tjera financiare janë konstatuar transferta të parave të shumave të ndryshme, me përshkrimet përkatëse dhënie/kalim apo kthim borxhi.
255. Lidhur me këto transferta dhe për të verifikuar marrëdhënien juridike, mënyrën e krijimit të detyrimit me secilin nga shtetasit në fjalë, si dhe arsyen e mosdeklarimit të këtyre marrëdhënieve në asnjë nga deklaratat periodike, përfshirë dhe në deklaratën Vetting, Komisioni ftoi subjektin e rivlerësimit të sqaronte sa më sipër nëpërmjet pyetësorit nr. 2.
256. Në përgjigje<sup>95</sup> të sa më sipër, subjekti i rivlerësimit ka bërë me dije se: “Nuk kam qenë asnjëherë në dijeni sepse kanë qenë veprime të kryera nga bashkëshorti dhe se ato kanë qenë pjesë e veprimtarisë private të tij si avokat. Për më tepër, duke qenë se marrëdhëniet financiare të bashkëshortit janë mbyllur brenda vitit kalendarik, në çdo datë 31 dhjetor nuk ka pas asnjë marrëdhënie financiare të hapur me personat e listuar. Pra, bashkëshorti im nuk ka trashëguar vitin pasardhës asnjë marrëdhënie huamarrje apo huadhënie”.
257. Lidhur me konfliktin e mundshëm të interesave, në përgjigje të pyetësorit nr. 5, subjekti është shprehur se: “... siç kam shpjeguar edhe në pyetësorët e mëparshëm, unë personalisht nuk kam pas asnjë dijeni për marrëdhëniet financiare të bashkëshortit tim me personat e mëposhtëm. Nga informimi që ai më ka bërë, pasi u vura në dijeni nga pyetësori juaj, rezultoi se marrëdhëniet e tij me personat e përmendur më poshtë, janë në kuadrin e ndihmës reciproke shoqërore dhe miqësore, dhe kurrsesi ato nuk kanë shërbyer për të justifikuar shtimin e pasurisë familjare. Ato kanë qenë veprime të ligjshme pasi ai si çdo shtetas tjetër është i lirë në qarkullimin civil. Këto marrëdhënie të krijuara mes tij dhe personave të mëposhtëm nuk kanë asnjë lidhje apo konflikt interesi me detyrën time si gjyqtarë. Ritheksoj edhe njëherë, se personat e mëposhtëm, për arsyet e mësipërme, nuk mund të konsiderohen persona ‘të tjerë të lidhur’ në kuptim të nenit 3, pika 4 dhe 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016. Ata nuk kanë pasur asnjë lidhje interesi me mua si subjekt i rivlerësimit, qoftë edhe në dukje”.
258. Më poshtë janë përshkruar transaksionet e analizuara së bashku me dokumentacionin që ka paraqitur subjekti i rivlerësimit bashkëngjitur pyetësorëve nr. 2, 3, 5 dhe 6:

---

<sup>95</sup>Referojuni përgjigjeve nr. 3 dhe nr. 12.

- a) Në datën 22.7.2013 është transferuar nga llogaria e bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit në llogarinë e shtetasit K. P., shuma prej 100,000 euro me përshkrimin “kthim borxhi sipas kontratës së kredisë”.
259. Kjo marrëdhënie huaje është trajtuar si burim/çështje në analizimin e pasurive nr. 5<sup>96</sup> të lartpërkruara, për rrjedhojë referohen konkluzionet përkatëse, pa i përsëritur ato këtu.
- b) Në datën 12.1.2015 është transferuar nga llogaria e bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit në llogari të shtetasit S. Ç.<sup>97</sup>, shuma prej 200,010 USD, me përshkrimin “kthim borxhi sipas deklaratës së datës 5.1.2015”.
- c) Në datën 17.7.2017, shtetasi L. L. ka transferuar në llogarinë e përbashkët të subjektit të rivlerësimit me bashkëshortin, shumën 100,000 euro, me përshkrimin “borxh deri në 30 tetor 2017”.
- d) Në datën 28.7.2017 shtetasi D. B. ka transferuar në llogarinë e bashkëshortit të subjektit shumën prej 3,500,000 lekësh me përshkrimin “ndihmesë për hua”.
- e) Në datën 29.7.2015 Nj. L. Person Fizik ka transferuar në llogari të bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit shumën prej 10,000,000 lekësh me përshkrimin “shlyerje detyrimi”.
- f) Në datën 21.7.2014 znj. J. S. ka transferuar shumën prej 2,700,000 lekësh në llogari të bashkëshortit me përshkrimin “dhënie borxhi personal”.
- g) Në datën 4.3.2015 është transferuar në llogari të bashkëshortit të subjektit, pranë “Tirana Bank”, shuma prej 19,975 euro nga B/O Q. me përshkrimin “P.”.
- h) Në datën 23.9.2015, bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit ka transferuar në llogari të shtetasit H. G. shumën prej 4,200,000 lekësh me përshkrimin “kalim sipas deklaratës noteriale nr. \*\*\*”.
- i) Në datën 18.7.2008, bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit ka transferuar në llogari të shtetasit A. V. shumën prej 1,000,000 lekësh, me përshkrimin “dhënie borxhi”.
- j) Në datën 25.11.2008, shtetasi T. Ç. ka transferuar shumën prej 1,400,000 lekësh në llogari të bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit.
- k) Në datën 12.2.2015, shtetasi Y. E. S. A. A. E. E. ka transferuar nëpërmjet Unionit Financiar Tiranë (Western Union), shumën prej 11,650 euro në favor të bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit.

### **Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit**

260. Lidhur me transfertat dhe marrëdhëniet e lartpërmendura, në germat “b”-“k”, Komisioni ka kryer hetime dhe ka pyetur subjektin e rivlerësimit për detaje të mëtejshme, mbi shkaqet e transferimeve, mbi burimet e krijimit, mbi kohën e dhënies/kthimit. Subjekti i rivlerësimit ka pohuar se ato veprime financiare ishin kryer nga bashkëshorti, pa dijeninë e saj, duke specifikuar se të gjitha ato janë mbyllur brenda viteve përkatëse, pa prodhuar

<sup>96</sup>Trajtuar në pikën 5 të pasurive, në analizimin e pasurive për të cilat është deklaruar si burim, përdorimi i huas nga ky shtetas.

<sup>97</sup>Konstatohet se z. Th. S. ka marrë kredi në datën 12.1.2015 nga “Credins Bank”, shumën 200,000 USD, e cila më pas është transferuar në llogari të shtetasit S. Ç..

efekte financiare në vitet pasardhëse, dhe për këtë shkak as nuk kishte detyrim/mundësi për t'i deklaruar.

### **Vlerësimi i trupit gjykues**

261. Lidhur me veprimet financiare të përshkruara në geramat “b”-“k”, duke mbajtur në konsideratë përgjigjet dhe shpjegimet e subjektit të rivlerësimit të kombinuara dhe krahasuara këto me sa është konstatuar nga shqyrtimi dhe analizimi i dokumentacionit të administruar nga Komisioni, është konstatuar një paqartësi për sa i takon shkaqeve, shpesh me shpjegime jobindëse, si dhe jo gjithmonë kanë rezultuar të provuara me dokumentacion ligjor burimet financiare të shumave të qarkulluara.
262. Megjithatë, nisur nga kushtet që: (i) këto veprime financiare janë kryer nga bashkëshorti i subjektit dhe janë mbyllur/zeruar/neutralizuar/kthyer brenda vitit - pa prodhuar efekte financiare mbi kursime apo gjendje të disponuara apo të përdorura në vitet pasardhëse - me përjashtim të një rasti; (ii) shumat objekt i huave/transfertave të lartpërmendura nuk janë përdorur si burim financiar për ndonjë prej pasurive aktuale apo të ardhshme të familjes së subjektit - me përjashtim të një rasti, si investim i përkohshëm; (iii) këto shuma nuk kanë qenë pjesë e pasurive të deklaruara nga subjekti në deklaratën Vetting dhe nuk janë përdorur si burime të tyre; (iv) parë në një vlerësim të përgjithshëm të kriterit të pasurisë – duke mbajtur në vëmendje rezultatet përfundimtare lidhur me pasuritë e trajtuara deri në këtë pikë dhe ato të analizës financiare, për sa i përket objektit të rivlerësimit kalimtar, këto transaksione/huadhënie nuk rezultojnë përmbysëse/ndryshuese të rezultatit përfundimtar - trupi gjykues e çmon të panevojshëm analizimin e detajuar të të dhënave të rezultuara përgjatë hetimit administrativ, për të mbërritur në një konkluzion përfundimtar lidhur me secilën prej tyre.

### **17.1 Lidhur me transfertat të tjera financiare**

263. Përpos transfertave të përmendura dhe analizuara më sipër, nga verifikimi i llogarive bankare të bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit janë konstatuar edhe disa transfertat të tjera parash në favor të tij, të kryera nga shoqëri të ndryshme, me përshkrim “likuidim faturash” dhe konkretisht është konstatuar sa vijon:

**a) Shoqëria “V. A.” sh.a. ka transferuar në llogari të bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit përkatësisht shumat 35,100 euro në datën 26.8.2016 dhe 90,000 euro në datën 9.9.2016**

264. Lidhur me këto transfertat, Komisioni iu drejtua shoqërisë për të vënë në dispozicion dokumentacionin e plotë ligjor në bazë të të cilit ka lindur marrëdhënia juridiko-financiare me bashkëshortin e subjektit të rivlerësimit. Shoqëria “V. A.” sh.a., me anë të shkresës nr. \*\*\*, datë 30.3.2020, ka paraqitur marrëveshjen e shërbimit të lidhur midis saj, në cilësinë e përfituesit të shërbimit dhe avokat Th. S., në cilësinë e ofruesit të shërbimit. Bazuar në këtë marrëveshje, bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit do të jepte shërbime përfaqësimi në gjykatë deri në marrjen e vendimit gjyqësor të formës së prerë dhe vendimin e urdhërkërkutimit për përfituesin e shërbimit. Për këtë shërbim, z. Th. S. do të përfitonte një pagesë totale prej 117,000 euro (pa TVSH), ku 40,000 euro do të ishte tarifa e suksesit, e cila do të transferohej në llogarinë e Person Fizik “Th. S.” pranë



“Tirana Bank”. Ndërkohë shumat prej 35,100 euro dhe 90,000 euro janë transferuar në llogarinë personale të z. Th. S. pranë “Alpha Bank”. Shoqëria ka bashkëngjitur në përgjigjen e saj faturat tatimore të lëshuara nga av. Th. S. me nr. \*\*\* (për shërbim ligjor sipas kontratës, paradhënie) dhe nr. \*\*\* (shërbim ligjor sipas kontratës), me anë të të cilave janë kryer transfertat e shumave në fjalë. Faturat e lëshuara përkojnë me shumat e transferuara në llogari të bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit.

265. Komisioni iu drejtua edhe Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve për të konfirmuar deklarin e këtyre faturave në sistemin tatimor, nga përgjigjja e së cilës me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 29.5.2020, ka konfirmuar deklarin e tyre nga bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit, si dhe nga shoqëria “V. A.” sh.a. si dhe që nuk janë anuluar më pas. Gjithashtu, Drejtoria e Tatimpaguesve të Mëdhenj ka konfirmuar me anë të shkresës nr. \*\*\* prot., datë 11.6.2020, për vitin 2014 se në librat e shitjes së shoqërisë “V. A.” sh.a. nuk ka pasur shitje për bashkëshortin e subjektit të rivlerësimit.

**b) Shoqëria “T. A.” sh.a. ka transferuar në llogari të bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit përkatësisht shumat 30,000 euro në datën 29.7.2016, 81,000 euro në datën 8.9.2016 dhe 81,000 euro në datën 9.9.2016**

266. Lidhur me këto transfertat, Komisioni iu drejtua shoqërisë për të vënë në dispozicion dokumentacionin e plotë ligjor në bazë të të cilit ka lindur marrëdhënia juridiko-financiare me bashkëshortin e subjektit të rivlerësimit. Shoqëria “T. A.” sh.a., me anë të shkresës nr. \*\*\* prot., datë 19.3.2020, ka paraqitur kontratën e shërbimit të lidhur me av. Th. S., në cilësinë e ofruesit të shërbimit. Referuar kësaj kontrate, tarifa për shërbimet ligjore do të ishte 135,000 euro (pa TVSH) dhe tarifë suksesi me vlerë 40,000 euro (pa TVSH).

267. Gjithashtu, Komisioni iu drejtua edhe Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve për të konfirmuar deklarin e këtyre faturave në sistemin tatimor, nga përgjigjja e së cilës me anë të shkresës nr. \*\*\* prot., datë 29.5.2020, ka konfirmuar deklarin e tyre nga bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit, nga shoqëria “T. A.” sh.a., si dhe që nuk janë anuluar më pas.

**c) Shoqëria “K. G. E.” sh.p.k. ka transferuar në llogari të bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit, përkatësisht, shumat 9,000 euro në datën 16.5.2014, 10,800 euro në datën 6.8.2014 dhe 72,000 euro në datën 22.10.2014**

268. Lidhur me këto transfertat, Komisioni iu drejtua shoqërisë për të vënë në dispozicion dokumentacionin e plotë ligjor në bazë të të cilit ka lindur marrëdhënia juridiko-financiare me bashkëshortin e subjektit të rivlerësimit. Shoqëria “K. G. E.” sh.p.k. me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 28.5.2020, ka sqaruar se shoqëria ka përfituar shërbimin e konsulencës juridike nga av. Th. S. dhe ka paraqitur faturat tatimore nr. \*\*\*, datë 15.5.2014; nr. \*\*\*, datë 4.8.2014 dhe nr. \*\*\*, datë 21.10.2014, të lëshuara nga Personi Fizik “Th. S.”, në bazë të të cilave janë kryer transfertat në fjalë.

269. Komisioni iu drejtua edhe Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve për të konfirmuar deklarin e këtyre faturave në sistemin tatimor, nga përgjigjja e së cilës me anë të shkresës nr. \*\*\* prot., datë 29.5.2020, ka konfirmuar deklarin e tyre nga bashkëshorti

i subjektit të rivlerësimit dhe nga shoqëria “K. G. E.” sh.p.k., si dhe që nuk janë anuluar më pas.

270. Në përfundim të hetimit administrativ lidhur me këto të ardhura/transaksione, Komisioni nuk ka konstatuar problematika dhe i ka njoftuar subjektit rezultatet e mëposhtme:

➤ Duket se marrëdhëniet financiare të përshkruara në pikat e mësipërme (a-c), kanë qenë të motivuara dhe janë deklaruar saktë edhe pranë organeve tatimore – për rrjedhojë ato konsiderohen të përfshira në të ardhurat me burime të ligjshme të aktivitetit të bashkëshortit të subjektit, të konfirmuara këto të dhëna edhe nga DPT-ja dhe nga pasqyrat financiare të shoqërisë.

### **18. Lidhur me investimin e djalit të subjektit të rivlerësimit në shoqërinë “F. F.” sh.p.k.**

271. Nga dokumentacioni i administruar nga Komisioni përgjatë hetimit administrativ ka rezultuar se djali i subjektit të rivlerësimit, z. B. S., ka qenë ortak zotërues i 25% të kuotave në shoqërinë “F. F.” sh.p.k., me \*\*\*<sup>98</sup> - restorant për të cilin nuk ka deklaruar të ardhurat nga shpërndarja e dividendëve në masën 15,980 lekë, në vitin 2015.

272. Në përfundim të hetimit administrativ, Komisioni i ka njoftuar subjektit rezultatet e mëposhtme:

➤ Duket se subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar në DIPP-në e vitit 2015 dhe as në rubrikën “angazhime nga veprimtari publike/private” të deklaratës *Vetting* të ardhurat e përfituara nga djali, nga shpërndarja e dividendit në vitin 2015 – ndonëse shuma në fjalë është minimale.

### **Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit**

273. Lidhur me modeklarimin e të ardhurave të përfituara nga djali i subjektit, nga shpërndarja e dividendëve në masën 15,980 lekë, në vitin 2015, subjekti është shprehur se nuk ka qenë në dijeni për investimin e djalit në shoqërinë/restorantin “F. F.”. Më pas, kur është vënë në dijeni ka rezultuar i mbyllur ky aktivitet tregtar. Referuar historikut të shoqërisë, periudha kohore ka qenë tepër e shkurtër (rreth 5 muaj) dhe nga bilanci, ku shihet se vlera është e pakonsiderueshme, nuk ka qenë qëllimi i fshehjes, por e gjitha ka ardhur si pasojë e mospasjes dijeni.

### **Vlerësimi i trupit gjykues**

274. Trupi gjykues, duke mbajtur në vëmendje shpjegimet e subjektit dhe peshën specifike minimale të fitimeve të padeklaruara, do ta vlerësojë edhe këtë rrethanë në harmoni dhe së bashku me problematikat e deklarimeve, për sa kohë ky rast - ndonëse ka qenë detyrim i subjektit, që nëpërmjet një përkujdesjeje të shtuar, të diktuar nga rëndësia e deklaratës *Vetting*, ta njëhte dhe ta deklaronte - në vetvete nuk mund të përbëjë shkak për aplikimin e ndonjë mase.

---

<sup>98</sup>Aktualisht statusi i shoqërisë “F. F.” sh.p.k. është i pezulluar.

## REZULTATET E ANALIZËS FINANCIARE

275. Në vijim të analizës financiare të kryer mbi deklaratimet periodike ndër vite, pas përlllogaritjeve të kryera në mënyrë të detajuar sipas viteve, në Aneksin 1 që i bashkëngjitet këtij dokumenti janë paraqitur të gjitha të dhënat mbi të ardhurat, shpenzimet, kursimet, detyrimet dhe nga përlllogaritja krahasimore e tyre mund të vlerësohet dhe konkludohet mbi mjaftueshmërinë e burimeve financiare, për çdo vit, për të përballuar investimet, shpenzimet apo kursimet e deklaruara dhe/ose të konstatuara, me të ardhura nga burime të ligjshme, në kuptimin e nenit D të Aneksit të Kushtetutës.
276. Në përfundim të procesit të rivlerësimit, Komisioni vlerëson se për sa i takon kriterit të pasurisë, bazuar në analizën financiare të kryer nga Njësia e Shërbimit Ligjor, subjekti i rivlerësimit, znj. Zegjine Sollaku, nuk ka pasur burime financiare të mjaftueshme, sipas përcaktimeve të nenit D të Aneksit të Kushtetutës, për të kryer të gjitha investimet e konstatuara dhe, njëkohësisht, për të përballuar shpenzimet, apo për të realizuar kursimet e deklaruara, për rrjedhojë – duke përfshirë dhe përthithur këtu edhe problematikat që kanë rezultuar mbi deklarimin e gjendjes cash prej 10,000 euro në deklaratën Vetting, si dhe mbi deklaratimet e pamjaftueshme të pasurive, pa qenë nevoja për t'u ndalur në argumentime specifike për secilën prej tyre – trupi gjykues çmon se në këtë rast duhet të aplikohet pika 3 e nenit 61, të ligjit nr. 84/2016.
277. Subjekti ka cituar pretendimet e veta mbi analizën financiare, përveç atyre të përmendura dhe trajtuara në analizimet e pasurive/të ardhurave që kanë shërbyer si burime/shpenzimet përkatëse, për të cilat trupi gjykues ka vendosur dhe përshkruar më lart marrjen ose jo në konsideratë të pretendimit, mes të cilave edhe pretendimin si në vijim:
- i) Korrigjimin e shpenzimeve të mobilimit në vitin 2006, në shumën 400,000 lekë sikur nuk është kryer dhe nuk është deklaruar një shpenzim i tillë në këtë vit.
278. Lidhur me këtë pretendim, subjekti ndonëse është pyetur nga Komisioni mbi periudhat e sakta të kryerjes së shpenzimeve të mobilimit, nuk ka dhënë përgjigje. Në mungesë të periudhës së saktë, nga Komisioni, siç është cituar në rezultatet e hetimit, janë vendosur shpenzimet e deklaruara prej subjektit në përgjigje të pyetësorit, si të kryera në vitet përkatëse të blerjes së pasurive. Subjekti ka kundërshtuar kryerjen e këtyre shpenzimeve në këtë vit, por nuk ka dhënë shpjegime mbi një periudhë tjetër të kryerjes së këtyre shpenzimeve. Për rrjedhojë, ky pretendim nuk është marrë në konsideratë.
279. Në përfundim të analizës së kryer, duke marrë në konsideratë provat e paraqitura nga subjekti, në prapësime, ka rezultuar një bilanc negativ në vlerën 5,062,268 lekë për periudhën 2003 – 2016 dhe në vlerën 283,071 lekë në periudhën përpara vitit 2003.

## Aneksi nr. 1 – analiza financiare e periudhës 2003 – 2016

	2003	2004	2005	2006	2007	2008	2009	2010	2011	2012	2013	2014	2015	2016
<b>PASURI</b>	<b>4,030,744</b>	<b>1,314,641</b>	<b>5,291,804</b>	<b>2,931,568</b>	<b>16,879,131</b>	<b>6,423,358</b>	<b>7,714,332</b>	<b>29,968,989</b>	<b>-10,017,002</b>	<b>4,156,951</b>	<b>19,312,324</b>	<b>234,617</b>	<b>28,453,765</b>	<b>-2,890,769</b>
Apartament 3+1 ne Rr. S. D. (privatizuar ne 1994)														
Apartament 2+1 ne L. ***, Fier 120 m2	1,900,000													
Apartament i privatizuar ne Fier ne b/ponesi me prinderit														
Truall dhe ndertese ne L. ***, Fier (dharuar b/sh nga prinderit)														
Take are 600m2 ne G***, Kavaje														
Take pyll ne L***, Tirane	600,000													
Apartament 135 m2 Rr. P. R.														
Apartament 60 m2 Rr. P. R.			700,400											
Garazh 22.2 m2 Rr. P. R.														
Apartament ne G*** nga shoq. G***				2,341,800										32,087
Apartament 97m2 + garazh 35m2 nga firma K***					8,463,700	3,695,475								
Makine Toyota Land Rover TR***P						6,159,125								
Veture Citroen C5 TR***OS							3,933,900							
Veture Mercedes Benz TR***2S							6,858,500							
Apartament 70 m2 ne G***, P. A.							3,000,000							
Apartament 184.2 m2, Rr. S. F., T***														
Apartament 82.4 m2, Rr. S. F., T***								27,762,000			14,021,000			
Tre garazhe, Rr. S. F., T***														
Veture Audi A6 e djalt AA***FJ											1,402,100			
Apartament 64 m2 ne Sarande (A***)										4,550,000				
Apartament 57m2 dhe verande 31 m2 ne I. C. (D***)												4,206,300		
Investim me shoqerine H*** (A. R.)													25,328,000	
Ndryshim likuiditeti	1,530,744	1,314,641	4,591,404	589,768	8,415,431	-3,431,242	-6,078,068	2,206,989	-10,017,002	-393,049	-317,076	234,617	3,093,678	-2,890,769
<b>TOTAL LIKUIDITETE DEKLARUAR</b>	<b>3,737,812</b>	<b>5,052,454</b>	<b>9,643,858</b>	<b>10,233,626</b>	<b>18,649,057</b>	<b>15,217,815</b>	<b>9,139,746</b>	<b>11,346,735</b>	<b>1,329,733</b>	<b>936,684</b>	<b>619,608</b>	<b>854,225</b>	<b>3,947,903</b>	<b>1,057,134</b>
<b>DETYRIME</b>	<b>-207,174</b>	<b>-207,174</b>	<b>-207,174</b>	<b>-207,174</b>	<b>-207,174</b>	<b>2,899,312</b>	<b>-779,838</b>	<b>27,498,248</b>	<b>-1,229,587</b>	<b>-1,258,592</b>	<b>25,803,417</b>	<b>1,712,260</b>	<b>22,714,726</b>	<b>-1,949,346</b>
Dhene hua 60,000 USD, K*** (porositur apartament)														
Kredi pranë Bankes së Kursimeve	-207,174	-207,174	-207,174	-207,174	-207,174	-207,174	-207,174	-207,174	-207,174	-207,174	-207,174	-207,174	-207,174	-111,767
Leasing me Tirana Leasing Sha						3,106,486	-572,664							
Kredi per shëpi pranë ISP Bank (ABA 04.07.2007)								27,505,492	-1,022,413	-1,047,224	-1,204,558	-1,142,220	-1,370,900	-1,157,073
Kredi per shëpi e biznes Tirana Bank											26,599,660	-1,153,173	-1,203,799	-1,038,806
Kredi per mobilim shtëpie Tirana Bank											2,910,335	-365,585	-310,384	
Kredi per shlyerje detyrimi Credins Bank													25,328,000	-25,658,000
Kredi Credins Bank 26mhl														25,943,520
Kredi konsumatore Tirana Bank												675,863	-105,739	-101,252
Overdraft tek Union Bank si PF														
Detyrim kartë krediti RZB Th*** S***								0	199,931	0	-4,194	615,490	628,629	670,386
Detyrim kartë krediti RZB A*** S***														-30,360
Dhene hua L*** M***														199,247
<b>PASURI NETO</b>	<b>4,237,918</b>	<b>1,521,816</b>	<b>5,498,979</b>	<b>3,138,742</b>	<b>17,086,305</b>	<b>3,524,045</b>	<b>8,494,170</b>	<b>2,470,740</b>	<b>-8,787,415</b>	<b>5,415,543</b>	<b>-6,491,094</b>	<b>-1,477,643</b>	<b>5,739,039</b>	<b>-941,423</b>
<b>TE ARDHURA dokumentuar</b>	<b>8,934,905</b>	<b>3,009,519</b>	<b>7,727,490</b>	<b>3,088,494</b>	<b>19,006,959</b>	<b>11,005,803</b>	<b>15,086,481</b>	<b>8,182,737</b>	<b>2,714,385</b>	<b>17,184,680</b>	<b>10,598,903</b>	<b>40,783,437</b>	<b>18,759,729</b>	<b>4,589,275</b>
Te ardhura SR vertetuar	694,981	1,014,943	5,674,033	1,090,390	16,490,001	900,477	3,946,155	1,191,731	1,240,950	1,272,322	1,288,037	1,376,532	3,849,831	3,410,126
Te ardhura BSH vertetuar	2,233,357	1,994,576	2,053,457	1,998,104	2,516,958	10,105,326	11,140,326	6,991,006	1,473,435	15,571,264	8,760,810	38,620,598	14,115,148	365,044
Te ardhura vajza vertetuar	-	-	-	-	-	-	-	-	-	341,094	550,056	786,307	794,750	796,212
Te ardhura djalti vertetuar	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	17,893
Kursime të mbetura (1999-2002)	6,006,567													
<b>SHPENZIME</b>	<b>375,456</b>	<b>1,033,332</b>	<b>1,993,265</b>	<b>1,866,396</b>	<b>2,007,982</b>	<b>2,158,446</b>	<b>3,780,834</b>	<b>5,613,653</b>	<b>4,225,621</b>	<b>7,049,771</b>	<b>6,208,302</b>	<b>11,381,725</b>	<b>14,522,961</b>	<b>7,086,723</b>
Shpenzime jetese	375,456	375,456	438,228	438,228	492,354	546,480	546,480	546,480	546,480	564,096	564,096	879,992	897,104	940,368
Shpenzime arsimeri per femijet										251,496	252,378			
Pagese zhdoganimi per automjet							1,242,884							
Pagese tatimi per shlyerje e tokes ne Golem					458,827									
Pagese tatimi per shlyerje e apartamentit			85,500											14,056
Shpenzime interesi kredia Intesa SanPaolo 200,000 Euro								569,605	835,086	854,092	537,607	546,039	536,184	431,503
Shpenzime interesi kredia Tirana Bank + sigurimet											825,949	1,812,822	1,909,285	1,057,797
Shpenzime interesi kredia Credins Bank 200,000 USD													2,183,684	
Shpenzime interesi overdraft + kredi tek Union Bank										656,263	1,321,132			
Kthyer shuma prej 30,000 Euro T*** C***														4,129,500
Shpenzime arredimi			600,000	400,000			400,000						3,580,000	
Shpenzime udhëtimi		657,876	869,537	1,028,168	1,056,801	917,966	1,278,859	993,746	1,311,254	793,918	434,349	1,217,950	1,297,350	1,218,264
Shpenzime me kartë krediti RZB Th*** S***							312,610	3,503,821	3,458	1,286,923	1,565,884	1,826,309	917,708	1,621,161
Shpenzime me kartë krediti RZB A*** S***														1,115,549
Shpenzime me kartë krediti Tirana Bank Th. S***						694,000			1,529,344	2,642,983	706,908	1,518,614	1,522,542	706,234
<b>Analiza dokumentuar</b>	<b>4,321,530</b>	<b>454,372</b>	<b>235,247</b>	<b>-1,916,644</b>	<b>-87,328</b>	<b>5,323,312</b>	<b>2,811,478</b>	<b>98,344</b>	<b>7,276,179</b>	<b>4,719,365</b>	<b>10,881,695</b>	<b>30,879,354</b>	<b>-1,502,271</b>	<b>-1,556,025</b>
CASH në lekë		1,500,000	0											
<b>DIFERENÇA E PA MBULUAR</b>		<b>-5,062,268</b>												

## **B. KONTROLLI I FIGURËS**

280. Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (DSIK) ka kryer kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit. Për këtë qëllim, në përputhje me nenin 39 të ligjit nr. 84/2016, është përcjellë pranë Komisionit një raport për subjektin e rivlerësimit me nr. \*\*\* prot., datë 30.10.2017, me të cilin është konstatuar përshtatshmëria e subjektit të rivlerësimit Zegjine T. Sollaku, për vazhdimin e detyrës.
281. Me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 8.10.2019, DSIK-ja i ka komunikuar Komisionit se raporti i sipërcituar është deklasifikuar plotësisht me vendimin nr. \*\*\*, datë 4.10.2019, të KDZH-së
282. Në vijim të komunikimeve të mëtejshme me organet ligjzbatuese, përgjatë hetimit administrativ të kryer nga Komisioni, nuk kanë rezultuar informacione apo fakte të reja për këtë subjekt, që mund të lidheshin me këtë kriter dhe që mund të bënin të nevojshme hetime të mëtejshme nga Komisioni.
283. Rrjedhimisht, Komisioni, bazuar në sa më sipër, e vlerëson të përshtatshëm subjektin e rivlerësimit, për sa i përket kriterit të figurës.

## **C. RIVLERËSIMI I AFTËSIVE PROFESIONALE**

### **C/1 VLERËSIMI I AFTËSIVE PROFESIONALE NGA KLGJ-ja**

284. Komisioni, në bazë të neneve 40-44 të ligjit nr. 84/2016, pasi ka analizuar raportin e KLGJ-së, si dhe dokumentacionin e bashkëngjitur me të, ka kryer rivlerësimin e aftësive profesionale në përputhje me nenin E të Aneksit të Kushtetutës. Raporti me nr. \*\*\* prot, datë 27.6.2019, është përgatitur nga Këshilli i Lartë Gjyqësor si organi ndihmës për vlerësimin profesional, i cili ka analizuar të dhënat e rezultuara nga dokumentet, duke iu referuar kriterëve të mëposhtme të vlerësimit: (a) aftësitë profesionale; (b) aftësitë organizative; (c) etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale; dhe (ç) aftësitë personale dhe angazhimi profesional.
285. Ky raport është bazuar në përshkrimin dhe analizimin e: (i) formularit të vetëdeklarimit, të tri dokumenteve ligjore të përzgjedhura nga subjekti i rivlerësimit, si dhe të dhënave dhe dokumenteve të tjera që shoqërojnë formularin e vetëdeklarimit dhe që janë paraqitur nga vetë subjekti i rivlerësimit; (ii) pesë dokumente ligjore të përzgjedhura, sipas një sistemi objektiv dhe rastësor; (iii) të dhënat nga burimet arkivore të KLGJ-së.

### **GJETJET NGA FORMULARI I VETËDEKLARIMIT DHE DOKUMENTET E PARAQITURA NGA SUBJEKTI I RIVLERËSIMIT.**

286. Subjekti i rivlerësimit në datën 27.1.2017, ka paraqitur në ish-Këshillin e Lartë të Drejtësisë, sot KLGj, aktet e mëposhtme: (i) formulari i vetëdeklarimit, gjithsej pesë fletë; (ii) 39 dokumente shoqëruese të Formularit të Vetëdeklarimit gjithsej 95 fletë; (iii) lista e inventarit të akteve është pjesë e dosjes së vlerësimit.
287. Nga analiza e dokumentacionit të paraqitur nga subjekti i rivlerësimit, konstatohet si vijon:

- a. Saktësia e Formularit të Vetëdeklarimit. Formulari i vetëdeklarimit paraqitet i plotë sipas shtojcës të ligjit, subjekti ka deklaruar si periudhë vlerësimi tri vitet kalendarike 2014, 2015 dhe 2016.
  - b. Përvoja profesionale në 10 vjetët e fundit. Sipas Formularit të Vetëdeklarimit, subjekti i rivlerësimit në periudhën maj 2006 deri aktualisht ka ushtruar funksionin e gjyqtares në Gjykatën e Apelit Tiranë.
  - c. Detyrat e kryera në tri vitet e fundit dhe të dhënat statistikore. Gjatë tri viteve kalendarike subjekti rivlerësimit ka ushtruar funksionin e gjyqtares në Gjykatën e Apelit Tiranë, e cila ka deklaruar se i janë caktuar gjithsej 1.140 çështje<sup>99</sup> ka përfunduar gjithsej 1.025 çështje, duke përfshirë si gjyqtare e deleguar edhe 50 çështje në Gjykatën e Apelit Administrativ dhe 2 në Gjykatën e Apelit Krimet të Rënda dhe ka mbartur vitin e fundit gjithsej 18 çështje gjyqësore<sup>100</sup>.
  - d. ç) Trajnimet në tri vitet e fundit. Gjatë viteve 2014, 2015 dhe 2016, subjekti i rivlerësimit ka qenë subjekt që trajnohet nga Shkolla e Magjistraturës.
288. Lidhur me tri dokumentet e përzgjedhura nga subjekti vërehet se paraqiten të standardizuar në drejtim të organizimit formal dhe të strukturës, duke përdorur thujtëse të njëjtën strukturë në hartimin e tyre.
289. Nga shqyrtimi i pesë dosjeve të përzgjedhura në mënyrë rastësore, veç vlerësimeve përgjithësisht pozitive, KLGJ-ja ka konstatuar, sa vijon:
- a. Në dispozitiv në përgjithësi nuk disponohet për shpenzimet gjyqësore dhe nuk tregohet e drejta dhe afati i rekursit sipas nenit 476 të Kodit të Procedurës Civile.
  - b. Konstatohet se gjykimet e çështjeve në përgjithësi kanë zgjatur përtej afatit standard 6-mujor të përcaktuar nga germa “h”, pika 5, të Aneksit 1 të Sistemit të Vlerësimit, sipas nenit 464 të Kodit të Procedurës Civile, ku në 1 rast gjykimi i çështjes ka zgjatur 1 vit 28 ditë (referojuni dosjes nr. 3).
  - c. Për sa i përket aspektit kohor, Aneksi 1 i Sistemit të Vlerësimit “Për kriteret matëse të veprimtarisë gjyqësore”, pika 5, gjerat “g” dhe “h”, cakton afatin 6-mujor për çështjet civile dhe penale, nga analiza e 5 dosjeve të përzgjedhura me short, rezultoi se kohëzgjatja e gjykimeve në çdo rast, ka qenë jashtë afatit standard apo ligjor.
  - d. Konstatohet se katër vendimet civile janë arsyetuar në një afat mesatar prej 23 ditësh, afat që është jashtë afatit 10-ditor të përcaktuar nga neni 308 i Kodit të Procedurës Civile<sup>101</sup>.
290. Sipas të dhënave në dosjen personale, gjyqtarja Zegjine Sollaku është diplomuar “jurist” nga Universiteti Tiranës në datën 5.7.1994. Në datën 12.4.1995, është emëruar gjyqtare në Gjykatën e Rrethit Tiranë dhe më 22.10.2003 është emëruar në detyrën e gjyqtares në

<sup>99</sup>Nga të cilat 374 çështje në vitin 2014, 378 çështje në vitin 2015 dhe 388 çështje në vitin 2016.

<sup>100</sup>Për të dhënat statistikore, ajo ka paraqitur vërtetimin nr. \*\*\* prot., datë 19.1.2017, të lëshuar nga Gjykata e Apelit Tiranë, i cili përputhet me të dhënat e deklaruara.

<sup>101</sup>Vendimi që është arsyetuar me vonesën më të lartë prej 30 ditë, ka qenë çështje civile me palë kundërshtarë me objekt lidhje pensioni pleqërie.

Gjykatën Apelit Tiranë, ku dhe vazhdon aktualisht. Sipas të dhënave nga regjistri i ankesave, rezulton se gjatë periudhës trevjeçare të rivlerësimit “8 tetor 2013 – 8 tetor 2016”, për gjyqtaren janë paraqitur gjithsej 14 ankesa në Inspektoratin e KLD-së (6 ankesa në vitin 2014, 3 ankesa në vitin 2015 dhe 5 ankesa në vitin 2016), si vijon:

- a. gjashtë ankesa (2 të vitit 2014, 2 të vitit 2015 dhe 2 të vitit 2016), janë arkivuar pas shqyrtimit fillestar me arsyetimin se katër prej pretendimet mund të zgjidhen përmes apelimit gjyqësor dhe 2 janë paraqitur tej afatit ligjor (parashkruar);
  - b. tetë ankesa të tjera janë verifikuar nga ku ka rezultuar: 1 ankesë e vitit 2015 për mosrespektim formal të ligjit është konstatuar shkelje dhe evidentuar gjyqtares për efekte të vlerësimit etiko-profesional; ankesa (1 e vitit 2014, nr. \*\*\* prot., datë 5.2.2014 dhe 1 e vitit 2015, informacion nga Kryetari i Gjykatës së Apelit Tiranë, shkresa nr. \*\*\* prot., datë 3.3.2015, me objekt “verifikim për vonesa në zbardhjen e vendimeve, e cila i është regjistruar subjektit të vlerësimit për efekt vlerësimit profesional). Mbi bazën e informacionit periodik të kryetarit të gjykatës për dorëzimin në afat të vendimeve janë konstatuar shkelje, si dhe i është evidentuar gjyqtares për efekt të vlerësimit etiko- profesional;
  - c. një ankesë e vitit 2014 mbi bazën e informacionit periodik të Kryetarit të Gjykatës është konstatuar shkelje dhe i është evidentuar gjyqtares si vërejtje me shkrim (ankesat me nr. \*\*\*, datë 12.2.2014 dhe nr. \*\*\*, datë 15.4.2014; ankesat një në vitin 2014 dhe një në vitin 2016), për mosrespektim formal të ligjit janë arkivuar, pasi nuk është konstatuar shkelje;
  - d. një ankesë e vitit 2016, për dorëzim të vendimit të arsyetuar me vonesë, nuk është konstatuar shkelje dhe është arkivuar; një ankesë e vitit 2016, për zbardhje të vendimit, është në vijim deri në përfundimin e çështjes në Gjykatën e Lartë; si dhe ankesa me nr. \*\*\* prot, datë 14.09.2016, e cila është mbajtur në vijim deri në përfundim të gjykimit në Gjykatën e Lartë.
291. Gjithashtu, sipas të dhënave të regjistrit të procedimeve disiplinore, për gjyqtaren Zegjine Sollaku përgjatë periudhës së rivlerësimit nuk është regjistruar asnjë kërkesë për procedim dhe nuk është dhënë asnjë masë disiplinore.

## **C/2 VLERËSIMI I AFTËSIVE PROFESIONALE NGA KOMISIONI**

292. Komisioni, në bazë të neneve 40 - 44 të ligjit nr. 84/2016, pasi ka analizuar raportin e KLGj-së, si dhe dokumentacionin bashkëngjitur, ka kryer rivlerësimin e aftësive profesionale në përputhje me nenin E të Kushtetutës, duke shqyrtuar edhe informacionet e marra nga denoncimet nga publiku dhe nga organet e tjera ligjzbatuese, si dhe ka analizuar dosjet profesionale të administruara për këtë qëllim.

## LIDHUR ME EKZISTENCËN E KONFLIKTIT TË INTERESIT

293. Lidhur me ekzistencën e konfliktit të interesit, për personat e lidhur në një marrëdhënie interesi me subjektin e rivlerësimit, Komisioni iu drejtua Gjykatës së Apelit Tiranë<sup>102</sup>, e cila shkresën nr. \*\*\* prot., datë 22.9.2020, vuri në dispozicion vendimet, të cilat u administruan në dosje. Nga analizimi i vendimeve ka rezultuar si vijon: (i) për shtetasit: S. K., F. R., B. A., M. A., T. A., F. Ç., M. Ç., L. M., O. Zh., J. Gj., F. Gj., D. B., H. G., K. P., Nj. L., M. S. dhe shtetasin B. M., nuk kanë rezultuar çështje të gjykuara në Gjykatën e Apelit Tiranë; (ii) për shtetasit A. J., A. V., D. Gj, për shoqërinë “A -F- A” sh.p.k., si dhe për shoqërinë “N&N” sh.p.k., me ortakë shtetasen N. N., kanë rezultuar çështje të gjykuara në Gjykatën e Apelit Tiranë, por subjekti i rivlerësimit nuk ka qenë pjesë e trupit gjykues; (iii) ndërsa për shtetasit e poshtëshënuar Gjykata e Apelit Tiranë përcolli dokumentacionin si vijon:
- a. Për shtetasin F. B. administrator i shoqërisë “K.” sh.p.k., rezulton një vendim i gjykuar nga subjekti i rivlerësimit, konkretisht vendimi nr. \*\*\*, datë 13.11.2014, ndërkohë që ka pasur një marrëdhënie juridiko-financiare me këtë shoqëri, lidhur me blerjen e apartamentit në vitet 2007-2008.
  - b. Për shtetasin B. M., përfaqësues shoqërisë i “T.” sh.p.k., rezulton i gjykuar një vendim nga subjekti i rivlerësimit dhe, konkretisht, vendimi nr. \*\*\*, datë 19.6.2018, ndërkohë që ka pasur një marrëdhënie juridiko-financiare me këtë shoqëri, lidhur me blerjen e apartamentit në vitet 2010-2013.
  - c. Për shtetasin P. Xh., administrator i UET-së janë gjykuar shtatë çështje gjyqësore dhe 2 prej tyre nga subjekti i rivlerësimit përkatësisht, vendimi nr. \*\*\*, datë 21.12.2013 dhe vendimi nr. \*\*\*, datë 4.12.2018, ndërkohë që ka pasur një marrëdhënie juridiko-financiare me të, lidhur me huamarrjen në vitet 2008-2010.
  - d. Për shtetasin R. H., administrator i shoqërisë “G.” sh.p.k., rezultojnë të gjykuara 73 çështje gjyqësore, nga të cilat nga subjekti i rivlerësimit ka dhënë 16 vendime gjyqësore. Gjykimet i përkasin periudhës 2011 – 2020, ndërkohë që leja e ndërtimit dhe shitja e sipërfaqes së tokës në G. është realizuar gjatë viteve 2005-2007.
  - e. Për shtetasin L. L., rezultojnë të jenë gjykuar 18 vendime gjyqësore dhe 2 prej tyre, vendimi nr. \*\*\*, datë 28.1.2016 dhe vendimi nr. \*\*\*, datë 7.4.2016, janë gjykuar nga subjekti i rivlerësimit, ndërkohë që marrëdhënia e huamarrjes ka lindur në gusht të vitit 2017 dhe është shuar në dhjetor të vitit 2017.
  - f. Për shoqërinë “T. L.”, të përfaqësuar nga shtetasi F. A., janë gjykuar gjithsej 9 çështje gjyqësore nga të cilat vetëm në vendimi nr. \*\*\*, datë 5.2.2015, subjekti ka qenë anëtare e trupit gjykues, ndërkohë që ka pasur marrëdhënie juridiko-financiare, lidhur me blerjen e automjetit në vitin 2008.
  - g. Me shkresën nr. \*\*\* prot, datë 28.4.2021, Gjykata e Apelit Tiranë ka informuar se nuk rezulton të jenë gjykuar çështje me palë : F. K. dhe T. Ç. përfaqësuesi shoqërisë

<sup>102</sup> Komisioni iu drejtua Gjykatës së Apelit Tiranë me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 29.7.2020, për vënien në dispozicion të vendimeve. Gjykata e Apelit Tiranë, me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 8.9.2021, vuri në dispozicion vendimet e Gjykatës së Apelit, të cilat janë përshkruar.



“I. C.” sh.p.k., A. T., përfaqësues i shoqërisë “A. C.”, A. M., administrator i “Universitetit K.”, S. D. dhe R. P., administrator i shoqërisë “M&P-I”, I. Q., L. M., M. M., S. B., L. A., F. Sh. dhe S. Ç., përfaqësues të shoqërisë “E.” sh.p.k., E. L., M. L. dhe M. L. administratorë të “E.” sh.p.k. dhe “P. I.” sh.p.k., si dhe H. G. dhe E. Sh., përfaqësues i shoqërisë “D.” sh.p.k.

- h. Për shtetasin H. Ç. është dhënë vendimi nr. \*\*\*, datë 4.12.2018, si përfaqësuesi UET-së, ku si kryesues ka qenë subjekti i rivlerësimit;
- i. Për shtetasin A. Xh., janë dhënë 4 vendime gjyqësore, përkatësisht: vendimi nr. \*\*\*, datë 6.2.2020; vendimi nr. \*\*\*, datë 13.3.2018; vendimi nr. \*\*\*, datë 30.1.2018 dhe vendimi nr. \*\*\*, datë 4.7.2016, ndërkohë që ka pasur një marrëdhënie juridiko-financiare, lidhur me kryerjen e pagesës dhe transfertës bankare të vitit 2009 dhe në vitin 2015 nënshkrimi i kontratës së shitjes me shoqërinë “B.” sh.p.k.
- j. Lidhur me shtetasin A. H., rezulton të jenë dhënë dy vendime dhe konkretisht: vendimi nr. \*\*\*, datë 15.11.2016; si dhe vendimi nr. \*\*\*, datë 25.6.2019 (shtetasit kanë gjeneralitet të ndryshme), ndërkohë që ka pasur një marrëdhënie juridiko-financiare, lidhur me kryerjen e pagesës së vitit 2005.
- k. Për shtetasin A. R. dhe për shoqërinë “R. K.” sh.p.k, Gjykata E Apelit Tiranë ka informuar se për të është dhënë vendimi nr. \*\*\*, datë 21.6.2011, ndërkohë që transaksionet bankare midis tij dhe bashkëshortit të saj janë kryer në vitit 2014.
294. Komisioni, pasi shqyrtoi materialin e administruar, përgjigjet e subjektit dhe të institucioneve përkatës, si dhe pasi analizoi periudhat/momentet kohore të trajtimit të disa çështjeve nga subjekti, në raport me kohën e ekzistencës së marrëdhënieve të interesit dhe/ose personale/familjare, që potencialisht mund të ngrinin dyshime mbi ekzistencën e konfliktit të interesit, nuk ka konstatuar rrethana/raste të tilla.
295. Gjithashtu, Komisioni i ka kërkuar informacion Prokurorisë së Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar (SPAK), e cila me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 19.4.2021, ka bërë me dije se për shtetasit: F. K., T. Ç., përfaqësues të shoqërisë “I. C.” sh.p.k., A. R. përfaqësues i shoqërisë “H.” sh.p.k., A. T., përfaqësues i shoqërisë “A. K.” sh.p.k., A. Xh. dhe A. M. administratorë të “U. K.”, S. D., R. P., përfaqësues i shoqërisë “M&P-I”, I. Q., L. M., M. M., S. B., L. A., A. H., F. Sh. dhe S. Ç. përfaqësues të shoqërisë “E.” sh.p.k., H. G., përfaqësues i shoqërisë “D.” sh.p.k., E. L., përfaqësues i shoqërisë “E.” dhe “P. I.” sh.p.k., nga ku ka informuar se në ngarkim të tyre, nuk rezulton të jetë regjistruar ndonjë procedim penal. Ndërkohë që për shtetasin H. Ç., përfaqësues i UET-së, rezulton të jetë regjistruar procedimi penal nr. \*\*\*, i cili është në fazën e hetimit.
296. Nga analiza e informacionit të lartpërmendur, nuk janë konstatuar rrethana që mund të ngrinin dyshime mbi subjektin, lidhur me ekzistencën e kontakteve të papërshtatshme, në përgjithësi, apo të konfliktit të interesit me këta persona.

#### **LIDHUR ME ANKESAT E DREJTUARA PRANË KLGJ-së**

297. Në vijim të hetimit administrativ, lidhur me analizimin e ankesave të paraqitura ndaj subjektit të rivlerësimit, Komisioni iu drejtua KLGJ-së me shkresën nr. \*\*\* prot., datë

9.12.2020, duke i kërkuar relatimet përkatëse për verifikimin e tyre. KLGj-ja, me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 17.12.2020, vuri në dispozicion praktikat, nga shqyrtimi i tyre ka rezultuar:

- a. ankesa nr. \*\*\* prot., datë 5.2.2014, e shtetasit F. D.,<sup>103</sup> nga shqyrtimi i të cilës është konkluduar se *ky vendim është dorëzuar në sekretari në datën 31.1.2014, pra, për një afat kohor prej 1 (një) muaj e 1 ditë, llogaritur nga data e shpalljes së vendimit*, në përfundim kjo çështje i është evidentuar për efekt të vlerësimit etik dhe profesional;
- b. relatimi mbi verifikimin e informacionit të dërguar nga Kryetari i Gjykatës së Apelit, Tiranë, me nr. \*\*\* prot., datë 12.2.2014<sup>104</sup> dhe informacioni nr. \*\*\*, datë 15.4.2014<sup>105</sup>, mbi të cilat është konkluduar *tërheqja e vëmendjes me shkrim në lidhje me mosdorëzimin në afat të vendimeve gjyqësore*, duke u bërë ajo pjesë e dosjes së vlerësimit dhe e përdorshme në rastin e vlerësimit profesional dhe etik, si dhe në rast përsëritje;
- c. relatimi mbi verifikimin e informacionit të dërguar nga Kryetari i Gjykatës së Apelit Tiranë, me shkresën nr. \*\*\* prot, datë 3.3.2015, mbi të cilat është konkluduar se bazuar në nenin 34 të Rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e Inspektoratit të Këshillit të Lartë të Drejtësisë”, shkeljet e konstatuara në drejtim të arsyetimit me vonesë të 57 vendimeve gjyqësore *t’i evidentohen subjektit të rivlerësimit, për efekt të vlerësimit profesional dhe etik*;
- d. relatimi mbi verifikimin e informacionit të dërguar nga Kryetari i Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë, datë 19.11.2014, që i përket informacionit nr. \*\*\*, datë 15.10.2014, mbi të cilat është konkluduar, dorëzimi me vonesë i dosjeve të gjykuara<sup>106</sup> nga subjekti i rivlerësimit Zegjine Sollaku, të llogaritet për efekt vlerësimi;
- e. lidhur me ankesën nr. \*\*\* prot., datë 14.9.2016, të shtetasit M. D., Komisioni iu drejtua ILD-së, me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 20.1.2021, pasi kjo ankesë ishte depozituar më parë pranë këtij institucioni;
- f. Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 27.1.2021, ka vënë në dispozicion praktikën, duke informuar se është akoma në fazën e verifikimit të saj<sup>107</sup>.

---

<sup>103</sup>Shtetasi F. D. në ankesën e tij ka pretenduar për mosdorëzimin në afat të vendimit gjyqësor të arsyetuar nga subjekti i rivlerësimit.

<sup>104</sup>Informacioni që i përket urdhrin të verifikimit nr. \*\*\*, datë 12.2.2014, të Kryetarit të Gjykatës së Apelit Tiranë lidhur me veprimtarinë gjyqësore të subjektit të rivlerësimit, mbi mosdorëzimin në afat të 15 vendimeve të arsyetuara.

<sup>105</sup>Informacioni që i përket urdhrin të verifikimit nr. \*\*\*, datë 12.2.2014, të Kryetarit të Gjykatës së Apelit, lidhur me veprimtarinë gjyqësore të subjektit të rivlerësimit, mbi mosdorëzimin në afat të 20 vendimeve të arsyetuara.

<sup>106</sup>Subjekti i rivlerësimit ka qenë komanduar në Gjykatën Administrative të Apelit ka dorëzuar rreth 50 vendime të arsyetuara me vonesë.

<sup>107</sup> Shtetasi M. D. ankohet për trupën gjyqësore në përbërje të së cilës ka qenë R. H., Gj. Gj. dhe Z. Sollaku se kanë zhvilluar çështjen gjyqësore të datës 13.9.2016, ora 12:50 pa praninë e tij, ai pretendon se ka qenë i pranishëm në sallë dhe se nuk është thirrur, për këtë ka kërkuar edhe filmimet e kamerave.

298. Nisur nga sa më sipër, mbi këtë pikë, Komisioni i ka njoftuar subjektin këtë rezultat të hetimit administrativ: duket se janë konstatuar vonesa të përsëritura lidhur me gjykimin e çështjeve dhe me dorëzimin e dosjeve apo të vendimeve përkatëse.
299. Subjekti ka paraqitur shpjegimet e saj, duke pretenduar se vonesat në fjalë kanë ardhur për shkak të ngarkesës së punës dhe në disa rrethana për shkaqe që nuk vareshin prej saj.

### DENONCIME NGA PUBLIKU

300. Pranë Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, bazuar në nenin 53 të ligjit nr. 84/2016, për subjektin e rivlerësimit Zegjine Sollaku, janë paraqitur gjithsej nga publiku 58 denoncime së bashku me materialet përkatëse (por disa prej tyre janë riparqitur në mënyrë të përsëritur, nga të njëjtët denoncues dhe/ose me të njëjtën përmbajtje të denoncimeve të mëparshme). Komisioni, pasi ka shqyrtuar në tërësi denoncimet, ka konstatuar se disa pjesë të tyre nuk përmbanin elemente/referenca për të mundësuar analizimin specifik ose nuk kishin lidhje me aktivitetin profesional të subjektit, ndërkohë që janë analizuar dhe shqyrtuar denoncimet e tjera, për të cilët janë kryer hetime dhe kërkuar dokumente, në vijim të të cilëve është konstatuar si vijon:

#### 1. Denoncimi nr. \*\*\* prot., datë 3.8.2020, i shtetases M. B.

Denoncime të përsëritura të shtetases M. B. regjistruar pranë Komisionit me nr. \*\*\* prot., datë 3.8.2020, nr. \*\*\* prot., datë 21.8.2020, nr. \*\*\* prot., datë 29.10.2019, nr. \*\*\* prot., datë 4.11.2019, si dhe nr. \*\*\* prot., datë 4.11.2019, drejtuar disa subjekteve rivlerësimi me objekt shkelje nga organet e drejtësisë, të cilët nuk kanë hetuar dhe kanë marrë vendime në shkelje të ligjit, lidhur me hetimet e kryera dhe gjykimin për vrasjen e bashkëshortit të saj në vitin 2019, për të cilin nuk është thirrur asnjëherë. Sipas denoncueses, referohet se subjekti i rivlerësimit ka dhënë vendim të padrejtë për nxjerrjen nga burgu të vrasësit të bashkëshortit të saj, duke zëvendësuar masën e sigurimit nga “arrest në burg” në “detyrim paraqitje në policinë gjyqësore një herë në muaj”.

#### 2. Denoncimet: nr. \*\*\* prot., datë 22.5.2019; nr. \*\*\* prot., datë 22.5.2019; nr. \*\*\* prot., datë 15.1.2020; si dhe nr. \*\*\* prot., datë 6.12.2019, të shtetasit S. T.

Shtetasi S. T. përshkruan një kronologji të gjatë të historikut të familjes së tij lidhur me pronësinë dhe trashëgimtarët ligjore ndër vite. Ky denoncim është marrë disa herë në shqyrtim nga Komisioni në përfundim të të cilit nuk janë vërejtur *indicie* për thellimin e hetimeve.

#### 3. Denoncimi nr. \*\*\* prot., datë 7.2.2018 dhe nr. \*\*\* prot., datë 20.4.2018, i shtetasit S. R.

Denoncimet e shtetasit S. R. janë marrë disa herë në shqyrtim nga Komisioni e në përfundim, nuk janë konstatuar *indicie* për thellimin e hetimit.

#### 4. Denoncimi nr. \*\*\* prot., datë 2.7.2019, i shtetasit A. P.

Drejtuar subjektit të rivlerësimit në cilësinë e kryesueses lidhur me vendimin nr. \*\*\*, datë 11.6.2016, të Gjykatës së Apelit Tiranë. Në këtë denoncim, denoncuesi ankohet se subjekti ka kryer shkelje procedurale gjatë shqyrtimit në Gjykatën e Apelit Tiranë të çështjes me palë

ndërgjygjëse: paditës A. G. dhe të paditur vetë denoncuesin me objekt përmbushje detyrimi kontraktual. Denoncuesi ka referuar në shkelje procedurale si:

- i. Në këtë gjykim Gjykata e Apelit Tiranë me vendimin nr. \*\*\*, datë 11.6.2016, nuk ka marrë parasysh kërkesën për riçelje të hetimit gjyqësor.
- ii. Gjithashtu, kjo gjykatë ka shkelur rregullat proceduralë që lidhen me gjykimin dhe zgjidhjen përfundimtare të mosmarrëveshjes civile sipas nenit 1 pg. 1<sup>108</sup> dhe 126 pg. II<sup>109</sup> të Kodit të Procedurës Civile. Kjo gjykatë ka tejkaluar vetë kryesisht kërkimet e padisë duke vendosur një vlerë detyrimi më të madhe sa është kërkuar dhe, për rrjedhojë, ka shkelur nenin 465 pg. i ku parashikohet se *Gjykata e Apelit shqyrton çështjen brenda kufijve të ankimit*. Sipas denoncuesit, gjykata ka pranuar një kërkim të ri, i cili nuk është paraqitur më parë në ankim por vetëm në seancën e datës 11.6.2019 nga pala paditëse, veprim ky i cili bie ndesh me nenin 465<sup>110</sup> pg. IV të Kodit të Procedurës Civile. Nëpërmjet pranimin të një detyrimi më të madh se sa ai i kërkuar në ankim, gjykata ka marrë atributet e një eksperti në fushën ekonomike, duke mos marrë parasysh përfundimet e ekspertës së caktuar për këtë qëllim të pranuar nga gjykata e shkallës së parë dhe paditësi.
- iii. Gjithashtu, duke vendosur mbi një vlerë detyrimi më të madhe, kjo gjykatë nuk ka arsyetuar mbi përjashtimin e të gjitha provave të paraqitura nga i padituri, lidhur me përcaktimin e vlerës së detyrimit si mandate bankare dhe faturë e ekstrakte të llogarive bankare.
- iv. Gjykata ka vepruar në kundërshtim me nenin 466 të Kodit të Procedurës Civile, i cili ka parashikuar një nga opsionet që duhet të vendosë gjykata pas përfundimit të shqyrtimit, pra, gjykata duhet të vendoste ose lënien në fuqi ose ndryshimin e vendimit, por kurrësi edhe lënien në fuqi edhe ndryshimin e vendimit (sipas pikave a dhe b).
- v. Gjykata nuk ka zbatuar mirë legjislacionin procedural në fuqi. Gjykata duhet të pushonte gjykimin dhe ta orientonte paditësin të kërkonte lëshimin e urdhrin mbi titullin ekzekutiv, pasi kontratat e huas janë tituj ekzekutiv sipas nenit 510 të Kodit të Procedurës Civile dhe, për rrjedhojë, ka vendosur me realizimin e tij mbi një mjet të gabuar juridik.
- vi. Denoncuesi ka bashkëlidhur dokumentacionin<sup>111</sup> që mbështet pretendimet e tij.

---

<sup>108</sup> Kodi i Procedurës Civile i Republikës së Shqipërisë cakton rregulla të detyrueshme, të njëjta e të barabarta, për gjykimin e mosmarrëveshjeve civile e të mosmarrëveshjeve të tjera të parashikuara në këtë kod e në ligje të veçanta.

<sup>109</sup> Vendimi përfundimtar, si dhe vendimet që i japin fund procesit gjyqësor civil të parashikuara prej nenit 127 të këtij Kodi jepen në emër të Republikës” dhe përkatësisht duhet të përmbajnë bazën, ligjore mbi të cilën bazohet zgjidhja e mosmarrëveshjes, analizën e provave dhe mënyra e zgjidhjes së saj.

<sup>110</sup> Në gjykimin në apel nuk mund të paraqiten kërkime të reja, të shtohen apo të ndryshohen elementët e padisë, me përjashtim të kërimit për shpenzimet e gjykimit në apel.

<sup>111</sup> Kontratë huaje, procesverbale të datave 3.3.2017 dhe 20.3.2017, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, aktvlerësimi pasuri paluajtshme, datë 4.5.2017 dhe përmbushje detyrimeve kontraktuale të kontratës, datë 31.12.2017, diskutime përfundimtare, datë 14.6.2017, vendim me nr. \*\*\*\*\*, datë 16.6.2017, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, ankim datë 30.6.2017, të palës paditëse, vendim nr. \*\*\*, datë 11.6.2019, të Gjykatës së Apelit Tiranë.

## **5. Denoncimi nr. \*\*\* prot., datë 12.6.2018, i shtetasit M. D.**

Denoncuesi M. D., ngre pretendime kryesisht mbi një tjetër subjekt rivlerësimi dhe shprehet se nëpërmjet një shtetasit në rolin e ndërmjetësit i është kërkuar 10% i vlerës së detyrimit, si dhe shprehet se ka qenë prezent në datën dhe orën e gjykimit, por se nuk është thirrur nga gjykata (denoncuesi pretendon se ka qenë rreth 45 minuta në ambientet e gjykatës). Nga shqyrtimi i vendimit, ku subjekti i rivlerësimit ka qenë anëtare, ka rezultuar se Gjykata e Apelit Tiranë me vendimin nr. \*\*\*, datë 13.9.2016, ka vendosur “lënien në fuqi të vendimit nr. \*\*\*, datë 16.7.2015, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë”, ky vendimi është ankimuar në Gjykatën e Lartë, regjistruar me çështjen nr. \*\*\*, aktualisht është në fazën e studimit. Nga verifikimi i vendimit nr. \*\*\*, datë 13.9.2019, konstatohet se vendimi është dhënë në mungesë të palës paditëse (denoncuesit).

## **6. Denoncimet: nr. \*\*\* prot., datë 15.1.2018; nr. \*\*\* prot., datë 27.2.2018; nr. \*\*\* prot., datë 28.5.2018; nr. \*\*\* prot., datë 25.10.2019; nr. \*\*\* prot., datë 25.10.2019 dhe nr. \*\*\* prot., datë 1.1.2019, i shtetasit F. D.**

Në denoncim shtetasi F. D. pretendon se në datën 30.12.2013 është zhvilluar seanca gjyqësore në ngarkim të Kryetarit të Gjykatës Pukë, Sh. Ll., akuzuar për veprën penale të korrupsionit dhe të ish-prokurori të Prokurorisë së Rrethit Pukë, P. P. Denoncuesi kërkon të shqyrtohet dosja dhe vendimi i datës 30.12.2013, pasi sipas tij, subjekti i rivlerësimit nuk ka zbatuar ligjin lidhur me dhënien e vendimit. Në vijimësi të denoncimeve lartpërmendur, pretendon se në datën 15.12.2017, ka depozituar një kallëzim penal në Prokurorinë e Përgjithshme në adresë të subjektit të rivlerësimit Zegjine Sollaku për veprat penale “shpërdorim detyre” dhe “veprime penale që pengojnë zbulimin e së vërtetës”, duke vënë në dispozicion shkresën nr. \*\*\* prot., datë 28.12.2017, të Prokurorisë së Përgjithshme, e cila i ka deleguar kallëzimin Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Durrës. Me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 18.1.2018, Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Durrës, ka njoftuar denoncuesin për vendimin e datës 17.1.2018 “për mosfillimin e procedimit penal për materialin kallëzues nr. \*\*\*”. Ky vendim është ankimuar dhe Gjykata Rrethit Gjyqësor Durrës me vendimin nr. \*\*\*, datë 19.2.2018, duke vendosur “mospranimin e ankimit” të denoncuesit F. D., ndaj subjektit të rivlerësimit Zegjine Sollaku.

Nga analizimi i dokumentacionit të disponuar, Komisionit i ka rezultuar se:

Shtetasi F. D. ka bashkëlidhur praktikën nr. \*\*\* prot., datë 14.7.2014, të KLD-së, në të cilën behët me dije se Gjykata e Apelit Tiranë me vendimin nr. \*\*\*, datë 30.12.2013, ku subjekti i rivlerësimit ka qenë relatore ka vendosur “miratimin e vendimit nr. \*\*\*, datë 8.12.2013, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë me objekt padie ‘caktimin e masës së sigurisë arrest me burg ndaj shtetasit F. D.’ dhe se pas verifikimit, ky vendim është dorëzuar në sekretari më 31.1.2014, pra, 1 (një) muaj pas shpalljes së tij në kundërshtim dhe në shkelje të përcaktimeve ligjore të nenit 113 të Kodit të Procedurës Penale<sup>112</sup>, nga ku përcaktohet afati 5-ditor dhe se i është evidentuar kësaj gjyqtareje për efekt vlerësimi profesional dhe etik.

---

<sup>112</sup> Neni 113, Depozitimi i akteve të gjykatës: “ *Origjinalet e akteve të gjykatës depozitohen në sekretari brenda pesë ditëve nga bërja e tyre*”.

#### **7. Denoncimi nr. \*\*\* prot., datë 23.11.2017, i shtetasit M. B.**

Kryesisht denoncimi drejtohet për një tjetër subjekti rivlerësimi, ku nga shqyrtimi i vendimit ka rezultuar se subjekti i rivlerësimit ka qenë anëtare në trupën gjyqësore të përbërë nga H. D., D. B. dhe Zegjine Sollaku, në dhënien e vendimit nr. \*\*\*, datë 12.9.2012. Ky denoncim është shqyrtuar edhe një herë nga Komisioni me vendimin nr. \*\*\*, datë 15.2.2019, faqe 49 dhe në përfundim është konkluduar se për sa kohë ky vendim është ankimuar në Gjykatën e Lartë, regjistruar me nr. \*\*\*, në fazën e studimit, për pasojë, çështja do t'i nënshtrohet gjykimit në gjykatat e shkallëve më lartë. Nuk përshkruhet në denoncim shkelje profesionale të lidhura ngushtësisht me subjektin e rivlerësimit.

#### **8. Denoncimi nr. \*\*\* prot., datë 17.1.2018, i shtetasit F. K.**

Shtetasi F. K., në denoncimin e tij pretendon marrjen e një shume parash nga subjekti i rivlerësimit, por nuk ka vënë në dispozicion fakte apo prova për të dëshmuar mbi këtë aferë korruptive dhe ka paraqitur në cilësinë e provës vetëm vendimin nr. \*\*\*, datë 21.9.2011, të Gjykatës së Apelit Tiranë. Nga shqyrtimi i dokumentacionit evidentohet se subjekti rivlerësimit ka qenë anëtare e trupës gjyqësore, të përbërë nga G. Sh. dhe Sh. M., në çështjen penale me objekt "shpërdorim të kompetencave". Nga vlerësimi i fakteve të denoncuar, si dhe vendimit të gjykatës, nuk konstatohen shkelje ligjore të kryera nga kjo trupë gjyqësore në marrjen e vendimit. Pretendimet e denoncuesit për vendim të padrejtë, ngrihen mbi themelin e vendimit, i cili nuk është objekt shqyrtimi nga Komisioni. Ky denoncim është shqyrtuar edhe më parë nga Komisioni me vendimin nr. \*\*\*, datë 4.8.2020, faqe 47, të subjektit të rivlerësimit G. Sh..

#### **9. Denoncimi nr. \*\*\* prot., datë 18.1.2018, i shtetasit K. D.**

Shtetasi K. D., denoncon subjektin e rivlerësimit, pasi e ka dhënë vendimin pa praninë e tij. Nga shqyrtimi i dokumentacionit, konstatohet se subjekti i rivlerësimit ka qenë relatore në vendimin nr. \*\*\*, datë 3.2.2000, por duke qenë se vlerësimi i aftësive profesionale sipas ligjit nr. 84/2016 shtrihet nga periudha 1.1.2006 dhe në vazhdim, ky denoncim nuk merret në konsideratë, pasi është jashtë periudhës së vlerësimit profesional<sup>113</sup>. Në vijim, Komisioni iu drejtua Gjykatës së Apelit Tiranë për të vënë në dispozicion vendim në emër të shtetasit K. D., dhe kjo e fundit vuri në dispozicion vendimin nr. \*\*\*, datë 23.9.2019, nga ku rezultoi se subjekti i rivlerësimit nuk ka qenë anëtare e trupës gjyqësore në dhënin e vendimit sipërcituar.

#### **10. Denoncimi nr. \*\*\* prot., datë 5.2.2019, i shtetasit R. D<sup>114</sup>.**

Shtetasja R. D., denoncon subjektin e rivlerësimit se ka dhënë vendim të padrejtë dhe jo në zbatim të procedurave ligjore. Trupa gjyqësore e Gjykatës së Apelit Tiranë, me kryesuese subjektin e rivlerësimit, ka dhënë vendimin nr. \*\*\*, datë 17.3.2016, ku ka vendosur ndryshimin e vendimit nr. \*\*\*, datë 31.1.2015, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe rrëzimin e kërkesë padisë<sup>115</sup>. Vendimi është ankimuar në Gjykatën e Lartë me nr. çështje \*\*\*, aktualisht

<sup>113</sup> Neni 41 ligji nr. 84/2016.

<sup>114</sup> Denoncuesja i është drejtuar edhe KLD-së me shkresën e datës 24.3.2016, duke parashtruar të njëjta pretendime të ngritura në denoncim.

<sup>115</sup> Me objekt padie detyrimin e palës së paditur Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë. Gjykata e Apelit Tiranë, me relatore gjyqtaren Zegjine Sollaku, me vendimin nr. \*\*\*, datë 28.9.2015, ka vendosur "ndryshimin e vendimit nr. \*\*\*, datë 21.7.2014, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë<sup>115</sup>". Lidhur me pretendimin e denoncuesit se gjykata nuk ka thirrur palët në gjykim, Komisionit, referuar vendimi të Gjykatës së Apelit Tiranë, i ka rezultuar se palët paditëse kanë qenë të përfaqësuara në seancë gjyqësore nga av. B. R., i cili në seancën e datës 28.9.2015 ka kërkuar *ndryshimin e vendimit dhe rrëzimin e kërkesë padisë*.

kjo çështje është në status studimi. Nuk shihen *indicie* për thellimin e këtij hetimi për aq kohë sa denoncimi kryesisht ka të bëjë me themelin e çështjes dhe nuk përshkruhen shkeljet procedurale të subjektit të rivlerësimit Zegjine Sollaku.

**11. Denoncimi nr. \*\*\* prot., datë 19.2.2018, i shtetasit A. B.**

Denoncimi drejtohet kundrejt një tjetër subjekti rivlerësimi për të cilin Komisioni është shprehur me vendimin nr. \*\*\*, datë 23.7.2020, F. S..

**12. Denoncimi nr. \*\*\* prot., datë 4.5.2018, i shtetasve I. Sh., L. F. dhe A. P.**

Denoncimi i shtetasve të lartpërmendur kryesisht ka të bëjë me disa subjekte rivlerësimi dhe nuk parashtron fakte dhe rrethana konkrete direkte lidhur me subjektin e rivlerësimit Zegjine Sollaku. Në denoncim nuk përshkruan ndonjë fakt apo shkelje procedurale dhe, në këto kushte, Komisioni iu drejtua Gjykatës së Apelit Tiranë për vënien në dispozicion të vendimit nr. \*\*\*, datë 4.4.2012, nga ku evidentohet se Gjykata e Apelit Tiranë, me anëtare subjektin e rivlerësimit, ka vendosur “ndryshimin e vendimit nr. \*\*\*, datë 12.2.2010, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, duke pranuar kërkesë padinë dhe detyrimin e palëve për njohjen bashkëpronar të sipërfaqes së tokës”. Shtetasit kanë drejtuar ankesën e tyre edhe në KLD, kjo e fundit me shkresat \*\*\* prot., datë 3.2.2015 dhe nr. \*\*\* prot., datë 5.3.2015, ka informuar arkivimin, pasi nuk janë gjendur elementët konkrete të shkeljeve procedurale. Nga shqyrtimi i procesverbaleve të disponuara të seancave gjyqësore, ka rezultuar se çështja ka filluar shqyrtimin në datën 17.2.2011 dhe ka përfunduar me vendim më 4.4.2012. Konstatohet se gjykimi i çështjes ka zgjatur gjithsej 13 muaj e 4 ditë, kohëzgjatje e cila është jashtë afatit standard 6-mujor të përcaktuar nga germa “h”, pika 5, të Aneksit 1 të Sistemit të Vlerësimit, “Kriteret matëse të vlerësimit”.

**13. Denoncimi nr. \*\*\* prot., datë 14.5.2018, i shtetasit Gj. Gj.**

Shtetasi Gj. Gj., pretendon se ndaj tij ka pasur tendencë negative nga trupa gjyqësore për të rrëzuar vendimin dhe ka pasur ndërhyrje. Me vendimin nr. \*\*\*, datë 6.3.2018, Gjykata e Apelit Tiranë me kryesues subjektin e rivlerësimit ka vendosur “prishjen e vendimit nr. \*\*\*, datë 18.7.2016, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë me një tjetër trup gjyqësor”. Kjo çështje është rekursuar në Gjykatën e Lartë dhe është regjistruar me nr. \*\*. Nga analiza e denoncimit të paraqitur në raport me elementet e nenit 53, pikat 1 dhe 2, të ligjit nr. 84/2016, lidhur me vendimin e relatuar nuk vërtetohen *indicie* apo pretendime të cilat të vlerësohen si shkelje ligjore, procedurale apo veprime korruptive të kryera prej saj dhe, për rrjedhojë, nuk shihen *indicie* për thellimin e hetimit.

**14. Denoncimi nr. \*\*\* prot., datë 30.5.2018, i shtetasit S. Ç.**

Kryesisht denoncimi i shtetasit S. Ç., ka të bëjë me themelin e çështjes, ku denoncuesi pretendon për dhënie të vendimi të padrejtë dhe të pambështetur në prova dhe në ligj nga

---

Nga analiza e denoncimit të paraqitur në raport me elementet e nenit 53, pikat 1 dhe 2, të ligjit nr. 84/2016, vlerësohet se në lidhje me subjektin e rivlerësimit, nuk referohet asnjë shkelje ligjore (e procedurale) apo veprime korruptive të kryera prej saj, që të pushojë cenimin e pronësisë duke mos e përsëritur më në të ardhmen, mbylljen e dritares kati IV dhe prishjen e rikonstruksionit të katit V.

**15. Denoncimi nr. \*\*\* prot., datë 18.7.2019, i studio ligjore “H. & L.”, i cili ka të njëjtin objekt denoncimi me atë të shtetas N. P., denoncimi nr. \*\*\* prot., datë 23.7.2019**

Studio ligjore “H. &L.”, të cilët janë përfaqësues me prokurë të shtetas N. P. kanë depozituar kërkesën nr. \*\*\*, datë 18.7.2019, për përjashtimin e gjyqtarës, ku kanë kërkuar që subjekti i rivlerësimit Zegjine Sollaku të japë dorëheqjen nga gjykimi i çështjes, me palë ndërgjyqëse palë paditëse N. P. dhe i paditur I. A. dhe zyra përmbartimore S. H., me pretendimin se prej saj është shfaqur mendim me shkrim për çështjen, mendim i cili ndodhet i depozituar në dosjen gjyqësore. Kërkesa e tyre nuk është marrë në konsideratë nga gjykata, e cila i ka rrëzuar pretendimet. Ata kanë depozituar kallëzim penal pranë Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krimet e Rënda në Tiranë dhe, më tej, i janë drejtuar Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Durrës, duke i kërkuar të pajisjen me një vërtetim për regjistrimin e procedimit penal dhe kopje të akteve. Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Durrësit ka informuar me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 28.6.2019, se ka regjistruar procedimin penal të vitit 2019 për veprën penale të parashikuar nga neni 245/1 i Kodit Penal.

a) Nisur nga sa më sipër, Komisioni iu drejtua Gjykatës së Apelit Tiranë për vënien në dispozicion të vendimit dhe procesverbaleve të seancave gjyqësore. Gjykata e Apelit Tiranë, me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 18.9.2020, vuri në dispozicion dokumentacionin e kërkuar me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 7.10.2020<sup>116</sup>, nga ku rezultoi se:

- Denoncuesja ka depozituar disa kërkesa për përjashtimin e subjektit të rivlerësimit nga shqyrtimi i çështjes së saj dhe të gjitha kërkesat janë rrëzuar nga trupat gjyqësore me vendimet përkatëse të disponuara nga Komisioni në dosje. Referuar procesverbalit të seancës gjyqësore, të datës 23.4.2019, përfaqësuesja me prokurë ka deklaruar se *gjatë studimit të dosjes kanë vënë re se ka një vendim të arsyetuar dhe kanë kërkuar dorëheqjen e subjektit të rivlerësimit më këtë argument. Subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se nuk ka bërë asnjë arsyetim vendimi dhe se ai ka qenë një projekt që tregon studimin e dosjes nga gjyqtarja*. Denoncuesja ka vazhduar me kërkesat për përjashtimin e subjektit të rivlerësimit, duke paraqitur një kallëzim penal<sup>117</sup> në seancën e datës 18.7.2019. Lidhur me paragjykimin e çështjes dhe ekzistencës së draft vendimit të hartuar edhe kjo kërkesë është hedhur poshtë nga gjykata si një kërkesë pa bazë ligjore.

**15.1 Denoncimi nr. \*\*\* prot., datë 18.6.2020, i shtetas N. P., firmosur nga av. N. Q.**

Shtetasja N. P., në këtë denoncim kërkon përjashtimin e subjektit të rivlerësimit, si dhe vlerësimin e veprimtarisë profesionale dhe etike të saj. Ajo ka parashtruar edhe një herë faktet dhe rrethanat e sipërpërmendura, lidhur me ekzistencën e draft-vendimit të gjetur në dosje. Gjithashtu, ka depozituar: vendimin nr. \*\*\*, datë 24.10.2019, me objekt “pushimin e procedimit penal nr. \*\*\*, datë 19.6.2019, të regjistruar për veprën penale të ushtrimit të ndikimit të paligjshëm nda personave që ushtrojnë funksione publike”, nga ku rezulton se hetimet nuk kanë qenë të plota dhe se dosja i duhet kthyer prokurorit për plotësimin e hetimeve; vendimin nr. \*\*\*, datë 24.10.2019, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, ku është vendosur

<sup>116</sup> Kopje të procesverbaleve të seancave gjyqësore + cd, si dhe 5 vendime të marra për mospranimin e kërkesës për përjashtimin e subjektit të rivlerësimit. Gjithashtu, lidhur me kërkesën për listën e zbardhjes së vendimeve më vonesë, Gjykata e Apelit është shprehur se nuk ka një regjistër zyrtar të sekretuar midis gjyqtarit dhe sekretarit për të vërtetuar datën e zbardhjes së vendimit.

<sup>117</sup>Referuar vendimit nr. \*\*\*, datë 19.7.2019, rezulton se Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Durrës, me shkresën nr. \*\*\* prot, datë 18.7.2019, ka cituar se: “Nuk ka regjistruar procedimin penale ndaj znj. Zegjine Sollaku”.



“mospranimin e kërkesës për pushimin e procedimit penal nr. \*\*\* dhe kthimin e akteve të këtij procedimi për vazhdimin e hetimeve”; shkresën nr. \*\*\* prot, datë 23.7.2019, nga Ministria e Drejtësisë drejtuar znj. N. P.; shkresën nr. \*\*\* prot., datë 22.7.2019, nga Kolegji, e cila ka bërë me dije se ankesa do të përcillet pranë organeve kompetente dhe OMN-së; shkresën nr. \*\*\* prot., datë 7.11.2019, nga Presidenti i Republikës, si dhe shkresën nr. \*\*\* prot., datë 19.11.2019, të KLGj-së, e cila informon se referuar ligjit nr. 115/206, kompetenca për verifikimin dhe hetimin disiplinor i ka kaluar Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë. Ky denoncim është bërë edhe mediatik në linkun: <https://shqiptarja.com/lajm/projektoi-vendimin-para-celjes-se-gjyqit-bashkeshortja-e-theodhori-sollakut-ne-hetim-nga-prokuroria?r=pop5s>.

Nga informacioni që disponohet, gjyqtarja e Gjykatës së Apelit Tiranë, znj. Zegjine Sollaku është vënë në verifikim nga Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Durrës, pasi është kallëzuar pak muaj më parë për “shpërdorim detyre”. Kallëzimi është depozituar fillimisht në Prokurorinë e Krimeve të Rënda nga znj. N. P., një trashëgimtare e disa pronave në qendër të Tiranës. Por prokurorët e Krimeve të Rënda shpallën moskompetencën dhe më pas çështja i ka kaluar për hetime të mëtejshme Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Durrësit. Momentalisht hetimi po administrohet nga prokurori Ndriçim Troplini, i cili ka objekt verifikimi gjyqtaren Zegjine Sallaku dhe njërën nga palët në procesin civil që po zhvillohet në Gjykatën e Apelit, I. A.. E gjithë çështja ka të bëjë me një projekt-vendim, sipas pretendimit të palës paditëse, që ka marrë gjyqtarja Zegjine Sollaku, i cili është administruar në dosje. Nga Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Durrës informohet se janë duke hetuar rrethanat e faktit dhe hetimi penal ka nisur për akuzën e “Ushtrimit të Ndikimit të Paligjshëm”. Nga ana tjetër pas publikimit të lajmit në “Shqiptarja.com” ka reaguuar dhe gjyqtarja Zegjine Sallaku, duke paraqitur një vërtetim të lëshuar nga kryeprokurorja e Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Durrës, znj. A. J., e cila vërteton me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 18.7.2019, se prokuroria që ajo drejton *nuk ka regjistruar asnjë procedim penal në emër të gjyqtarës Zegjine Sallaku*.

**16. Denoncimet nr. \*\*\* prot., datë 16.5.2019; nr. \*\*\* prot., datë 31.10.2019; nr. \*\*\* prot., datë 18.6.2020; si dhe nr. \*\*\* prot., datë 18.7.2019, i shtetas N. P.**

Në vijim të denoncimeve, që kanë të njëjtën përmbajtje, shtetasja N. P. i është drejtuar disa herë disa institucioneve ( KLD-së, Presidentit, Kryeministrit etj., sikurse është cituar edhe më sipër në denoncimin \*\*\*), ku ka kërkuar fillimin e procedimit disiplinor të subjektit të rivlerësimit, hetimin e veprimtarisë së saj etike dhe profesionale, si dhe të zbatimin e procedurës në çështjen e saj në gjykim, në të cilën si relatore ka qenë subjekti i rivlerësimit. Denoncuesja është në cilësinë e palës paditëse në çështjen civile me të paditur shtetasin I. A. dhe Zyrën Përmbarimore “ B...”. Ajo pretendon se në datën 23.4.2019, ora 11:15, i ka kërkuar relatores së kësaj çështje “*heqjen dorë nga shqyrtimi i çështjes*”, me argumentimin se prej saj (relatores) është shfaqur mendim. Sipas saj, ky fakt i është mohuar nga relatorja e seancës gjyqësore, duke u shprehur se ka qenë draft i përgatitur nga sekretaria për lehtësim të gjykatës. Gjithashtu, shtetasja pretendon se subjekti i rivlerësimit ka marrë pjesë në një tjetër vendim në të cilën janë përfshirë palët në këtë proces. Bashkëlidhur ndodhet një kopje e draft-vendimit të sipërcituar nga denoncuesja.

**16.1.** Për të qartësuar këtë moment, Komisioni iu drejtua subjektit të rivlerësimit nëpërmjet pyetsorit nr. 6, lidhur depozitimin e kallëzimit penal me nr. çështje \*\*\*, datë 19.6.2019,

regjistruar për veprën penale të “ushtrimit të ndikimit të paligjshëm ndaj personave që ushtrojnë funksione publike”, parashikuar nga neni 245/1 i Kodit Penal, nga shtetasja N. P.<sup>118</sup>. Në përgjigje të pyetjes nr. 5, të pyetësorit nr. 6, subjekti i rivlerësimit ka sqaruar se: *“Pas vendimit nr. \*\*\*, datë 24.10.2019, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, çështja është ankimuar nga prokurori dhe Gjykata e Apelit Durrës, me vendimin nr. \*\*\*, datë 17.01.2020, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të gjykatës së shkallës së parë duke arsyetuar, ndryshe nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës, se hetimet janë të plota dhe prokurori duhet të kërkonte në gjykatë jo vetëm pushimin e çështjes për veprën penale ‘ushtrim të ndikimit të paligjshëm ndaj personave që ushtrojnë funksione publike’, por edhe për veprën e kallëzuar ‘shpërdorim detyre’ për shkak se janë kryer një numër i konsiderueshëm veprimesh hetimore”*.

Pas kësaj, në datën 20.2.2020, prokurori ka vendosur shpalljen e moskompetencës duke ia dërguar aktet e këtij procedimi SPAK-ut. Drejtuesi i këtij të fundit, në datë 4.3.2020, vendosi ridërgimin e akteve të procedimit penal Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Durrës. Më tej, prokurori i çështjes në datën 1.6.2020, në zbatim të vendimit nr. \*\*\*, datë 17.1.2020, të Gjykatës së Apelit Durrës, paraqet në gjykatë kërkesën për pushimin e procedimit penal.

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës, me vendimin nr. \*\*\*, datë 22.9.2020, ka vendosur mospranimin e kërkesës për pushimin e procedimit dhe kthimin e akteve për vazhdimin e hetimeve duke i lënë afat një muaj për kryerjen e detyrave të lëna me vendimin nr. \*\*\*, datë 24.10.2019, të kësaj gjykate. Duke mos qenë dakord me këtë vendim, prokurori ka ushtruar të drejtën e ankimit dhe përfundimisht, Gjykata e Apelit Durrës, me vendimin nr. \*\*\*, datë 22.12.2020, ka vendosur ndryshimin e vendimit “pushimin e procedimit penal nr. \*\*\*, datë 19.6.2019, të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Durrës”. Pushimi i procedimit është bërë bazuar në germën “b”, të nenit 328/1, të Kodit të Procedurës Penale për shkak se: *“Del qartë se fakti nuk ekziston”*.

Bashkëlidhur, subjekti i rivlerësimit ka vënë në dispozicion: vendimin nr. \*\*\*, datë 24.10.2019, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës<sup>119</sup>; ankimin e prokurorit ndaj vendimi nr. \*\*\*, datë 24.10.2019<sup>120</sup>; vendimin nr. \*\*\*, datë 17.1.2020, të Gjykatës së Apelit Durrës<sup>121</sup>; vendimin e prokurorit, datë 20.2.2020, për shpalljen e moskompetencës lëndore<sup>122</sup>; vendimin e drejtuesit të SPAK-ut, datë 4.3.2020, për ridërgimin e akteve<sup>123</sup>; kërkesën e prokurorit, datë 1.6.2020, për pushimin e çështjes<sup>124</sup>; vendimin nr. \*\*\*, datë 22.9.2020<sup>125</sup>, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor

---

<sup>118</sup> Depozituar fillimisht në Prokurorinë pranë Gjykatës së Krimeve të Rënda dhe, më pas, për shkak të kompetencës, përcjellë në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës.

<sup>119</sup> Kallëzuesja N. P., të kallëzuar Zegjine Sollaki, I.A., me këtë vendim Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës ka vendosur mospranimin e pushimit të procedimit penal nr. \*\*\* dhe vazhdimin e hetimeve.

<sup>120</sup> Ankimi i Prokurorit i cili ka kërkuar, ndryshimin e vendimit, duke vendosur pushimin e vendimit.

<sup>121</sup> Gjykata e Apelit Durrës, ka vendosur lënien në fuqi të vendimin nr. \*\*\*, datë 24.10.2019, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës.

<sup>122</sup> Kërkesa e prokurorit për shpalljen e moskompetencës lëndore për hetimin procedural penal nr. \*\*\*.

<sup>123</sup> Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar, me vendimin e datës 4.3.2020 ka vendosur “mospranimin për kompetencë të akteve të procedimit penal nr. \*\*\*, të vitit 2019 të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Durrës, si dhe ridërgimin e tyre pranë kësaj prokurorie”.

<sup>124</sup> Kërkesë e prokurorit, datë 1.6.2020, për pushimin e çështjes penale nr. \*\*\* të vitit 2019.

<sup>125</sup> Vendimi nr. \*\*\*, datë 22.9.2020, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, për mospranimin e kërkesës për pushimin e procedimit penal nr. \*\*\*, kthimin e akteve dhe vazhdimin e hetimeve, duke i lënë afat 1-mujor, si dhe kryerjen e veprimeve nga prokurori të urdhëruara në vendimet e sipërcituara

Durrës; ankimin e prokurorit ndaj vendimit nr. \*\*\*, datë 22.9.2020<sup>126</sup>; si dhe vendimin nr. \*\*\*, datë 22.12.2020, të Gjykatës së Apelit Durrës<sup>127</sup>.

Ka rezultuar se vendimi i Gjykatës së Apelit Durrës është rekursuar në Gjykatën e Lartë dhe është aktualisht në status studimi me nr. çështje \*\*\*.

#### **17. Denoncimi nr. \*\*\* prot., datë 18.7.2018, i shtetasit F. K.**

Subjekti i rivlerësimit ka qenë kryesuese në dhënien e vendimit nr. \*\*\*, datë 5.10.2012, me palë paditëse F. K. dhe palë të paditur shoqërinë “U.” sh.p.k., me objekt padie “prishjen e ndërtimit për pjesën që cenon pronësinë e paditësit dhe dëmshpërblimin në masën 10.000.000 lekë”, në përfundim të shqyrtimit, gjykata ka vendosur “lënien në fuqi të vendimit nr. \*\*\*, datë 25.11.2011, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë”. Nuk shihen *indicie* për thellimin e hetimit. Ky denoncim është marrë në shqyrtimi më parë nga Komisioni me vendimin nr. \*\*\*, datë 15.2.2019, pika 63.14, faqe 50.

#### **18. Denoncimi nr. \*\*\* prot., datë 26.7.2018, i shtetasit A. B.**

Shtetasi A. B. denoncon shumë subjekte rivlerësimi, ndër të tjerë, edhe subjektin e rivlerësimit Zegjine Sollaku. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion nga denoncuesi, rezulton se subjekti i rivlerësimit nuk ka qenë anëtare e trupës gjyqësore në dhënien e vendimit.

#### **19. Denoncimet nr. \*\*\* prot., datë 30.7.2018 dhe nr. \*\*\* prot., datë 3.8.2018, i shtetasit B. R.**

Denoncuesi pretendon për vendim të padrejtë, si dhe marrje të vendimit në mungesë dhe pa njoftuar ketë të fundit. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion konstatohet se subjekti i rivlerësimit Zegjine Sollaku ka qenë pjesë e trupës gjyqësore në dhënien e vendimit nr. \*\*\*, datë 27.2.2018, me objekt “pjesëtimin e pasurisë bashkëshortore”. Nga dokumentacioni në dispozicion, Komisioni vlerëson se vendimi nr. \*\*\*, datë 27.2.2018, është dhënë në mungesë të palë së paditur (denoncuesit) B. R.<sup>128</sup>.

#### **20. Denoncimi nr. \*\*\* prot., datë 26.10.2018. i shtetasit J. P.**

Shtetasi J. P. akuzon disa subjekte rivlerësimi, ndër të tjerë, edhe subjektin e rivlerësimit, por nuk përshkruan shkelje ligjore që t’i atribuohen subjektit të rivlerësimit. Denoncuesi ka vënë në dispozicion vendimin nr. \*\*\* datë 26.6.2014, të Gjykatës së Apelit, ku si kryesuese e trupës gjyqësore ka qenë subjekti i rivlerësimit, si dhe ankimin e depozituar. Denoncuesi pretendon se nuk është thirrur në proces dhe duhet të ishte thirrur si palë në proces, pasi i cenohej e drejta e pronësisë. Nga shqyrtimi i vendimit të vënë në dispozicion rezulton se

subjekti i rivlerësimit ka qenë kryesuese në dhënien e vendimit dhe se palët ndërgjyqëse kanë qenë të përfaqësuar në proces nga përfaqësuesit të cilët kanë qenë prezent. Ndërsa lidhur me pretendimin se nuk është thirrur si person i tretë/ apo ndërhyrës në gjykim, si nga shkalla e

<sup>126</sup> Ankimi i prokurorit ndaj vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, për ndryshimin e vendimit nr. \*\*\*, datë 22.9.2020.

<sup>127</sup> Vendimi nr. \*\*\*, datë 22.12.2020, i Gjykatës së Apelit Durrës, për ndryshimin e vendimit penal nr. \*\*\*, datë 22.9.2020, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, pushimin e procedimit penal nr. \*\*\*, datë 19.6.2019, të Prokurorit të Rrethit Gjyqësor Durrës.

<sup>128</sup> Referuar vendimit nr. \*\*\*, datë 27.2.2018 të Gjykatës së Apelit Tiranë, është prezumuar dijenia e palës së paditur sipas ligjit.

parë dhe nga shkalla e dytë në gjykim, referuar neneve 192 dhe 193 të Kodit të Procedurës Civile, nuk rezulton që denoncuesi të këtë depozituar një kërkesë apo palët të kenë paraqitur një kërkesë të tillë, e cila nuk është pranuar nga gjykata. Nuk shihen *indicie* për thellimin e hetimit, si dhe ngelet e paqartë lidhja e denoncuesit me palët në proces.

#### **21. Denoncimi nr. \*\*\* prot., datë 5.12.2017, i shtetasit R. K.**

Shtetasi R. K. denoncon subjektin e rivlerësimit dhe një tjetër subjekt rivlerësimi për afera korruptive, si dhe pretendon se janë dhënë shuma parash nga kundërshtari i tij I. D. Shtetasi nuk ka vënë në dispozicion dokumentacion, prova apo fakte lidhur me vendimmarrje të subjektit të rivlerësimit. Komisioni iu drejtua Gjykatës së Apelit Tiranë për të vënë në dispozicion vendimin nr. \*\*\*, datë 15.7.2010, nga ku konstatohet se subjekti i rivlerësimit ka qenë kryesuese në dhënien e vendimit, në përfundim gjykata ka vendosur “lënien në fuqi të vendimit civil nr. \*\*\*, datë 3.11.2008, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë”. Vendimi është ankimuar në Gjykatën e Lartë, e cila me vendimin e Kolegjit të Gjykatës së Lartë me nr. \*\*\*, datë 4.7.2013, ka vendosur “mospranimin e ankimit të tij kundër vendimit të Gjykatës së Apelit Tiranë nr. \*\*\*, datë 15.7.2010, të bërë nga denoncuesi”. Për sa më sipër, nuk shihen *indicie* për thellimin e hetimit, pasi vlerësohet se pretendimet e denoncuesit janë kryesisht lidhur me themelin e çështjes, ato janë shqyrtuar nga një gjykatë në hierarki më të lartë, si dhe nuk ka parashtruar ndonjë shkelje ligjore, procedurale apo prova dhe fakte të lidhura drejtpërdrejtë që të provojnë pretendimet për afera korruptive në ngarkim të subjektit të rivlerësimit.

#### **22. Denoncimi nr. \*\*\* prot., datë 15.3.2018, i shtetasit F. M.**

Shtetasja F. M. akuzon disa subjekte rivlerësimi, ndër të tjerë, edhe subjektin e rivlerësimit, për shkelje të karakterit procedural dhe për zgjatje të gjykimit, nuk ka vënë në dispozicion dokumentacionin në mënyrë që të hetohet mbi shkaqet e denoncimit. Komisioni i është drejtuar Gjykatës së Apelit Tiranë për vënien në dispozicion të vendimit të sipërcituar. Nga analizimi i vendimit nr. \*\*\*, datë 20.2.2017, ka rezultuar se subjekti i rivlerësimit ka qenë kryesuese në dhënien e vendimit nga ku është vendosur “lënien në fuqi të vendimit nr. \*\*\*, datë 5.5.2014, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë”. Komisioni ka konstatuar se lidhur me pretendimin e denoncuesit për zgjatje të gjykimit, çështja nr. \*\*\* regj. them është regjistruar në datën 21.7.2014 dhe ka përfunduar me vendimin nr. \*\*\*, datë 20.2.2017, duke tejkaluar standardin kohor të parashikuar të gjykimit nga pika 5, germa “g”.

#### **23. Denoncimet nr. \*\*\* prot., nr. \*\*\* prot., nr. \*\*\* prot., datë 13.8.2018, si dhe nr. \*\*\* prot., datë 25.9.2019, i shtetasit S. M.**

Shtetasi S. M. ka statusin e të përndjekurit politik dhe pretendon se subjekti i rivlerësimit si relatore e çështjes ka kryer shkelje procedurale, pasi nuk ka zbardhur vendimin gjyqësor brenda afateve ligjore<sup>129</sup>, duke i mohuar atij të drejtën ligjore për ankimin ndaj vendimit të Gjykatës së Apelit Tiranë. Në këto kushte, Komisioni i është drejtuar Gjykatës së Apelit Tiranë për

<sup>129</sup> Komisioni iu drejtua Gjykatës së Apelit me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 18.9.2020, duke i kërkuar listën e vendimeve të zbardhura në tejkallim të afateve procedurale, nga subjekti i rivlerësimit për të gjithë periudhën e ushtrimit të funksionit. Gjykata e Apelit Tiranë, me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 7.10.2020, informoi se: “Për sa i përket listës së vendimeve të zbardhura në tejkallim të afateve, Gjykata e Apelit nuk ka asnjë regjistër zyrtar midis gjyqtarit dhe sekretarit gjyqësor për të vërtetuar datën e zbardhjes së vendimit”.

vënien në dispozicion të vendimit të sipërcituar, e cila me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 8.9.2020, vuri në dispozicion kopjen e vendimit dhe procesverbalet e seancave gjyqësore. Rezulton se në përfundim, Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin nr. \*\*\*, datë 2.11.2015, ka vendosur “ndryshimin e vendimit nr. \*\*\*, datë 16.3.2014, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe rrëzimin tërësisht të kërkesë padisë”. Nga administrimi i këtij vendimi është konstatuar se çështja është regjistruar më 22.7.2014 dhe ka përfunduar me vendimin e sipërcituar më 2.11.2015, pra, në tejkallim të afatit 6-mujor të parashikuar nga pika 5, germa “h”.

#### **24. Denoncimi nr. \*\*\* prot., datë 24.8.2018, i shtetasës D. T.**

Shtetasja D. T. pretendon se trupa gjyqësore ku ka qenë pjesë edhe subjekti i rivlerësimit, kanë shkelur procedurën ligjore, kanë marrë vendim në kundërshtim me ligjin dhe se ka gjykuar në kushtet e konfliktit të interesit, për shkak se një i afërm i anëtarit të trupës, punonte pranë palës paditëse në shoqërinë e sigurimeve “S. U. G. A.”. Komisioni iu drejtua Gjykatës së Apelit Tiranë, e cila vuri në dispozicion procesverbalin dhe vendimin e Gjykatës së Apelit Tiranë me nr. \*\*\*, datë 30.10.2014, nga ku ka vendosur “lënien në fuqi të vendimit nr. \*\*\*, datë 4.2.2013, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë”, duke rrëzuar kërkesën e denoncueses për pagimin e dëmshpërblimit për dëmin pasuror dhe jopasuror nga aksidenti automobilistik. Në vijim, nga shqyrtimi i procesverbaleve konstatohet se nga ana e denoncueses/përfaqësuesit ligjor të saj nuk është depozituar ndonjë kërkesë për përjashtimin e ndonjë anëtari/e të trupës gjyqësore, madje avokati i palës paditëse ka qenë dakord me formimin e trupës gjyqësore, kjo sipas procesverbalit të seancës gjyqësore, datë 31.10.2014, ora 10:51. Nuk provohen pretendimet e denoncueses për gjykimin në kushtet e konfliktit të interesit, ndërkohë që pretendimet për dhënien e vendimit të padrejtë, ngrihen mbi themelin e vendimit, i cili nuk është objekt shqyrtimi nga Komisioni, dhe për aq kohë sa ky vendim është ankimuar në Gjykatën e Lartë me nr. çështje \*\*\*, e aktualisht është në status në studim.

#### **25. Denoncimi nr. \*\*\* prot., datë 1.11.2018, i shtetasit S. M.**

Shtetasi S. M. pretendon se subjekti i rivlerësimit ka zgjatur dhe ka zvarritur seancën e gjykimit tej afateve të përcaktuara nga ligji, me qëllim që ky i fundit të mos gëzojë pronën e tij, sipas tij seanca është regjistruar në datën 25.5.2017 dhe ende nuk është përcaktuar datë për zhvillimin e saj. Nga shqyrtimi i faqes zyrtare rezulton se çështja me nr. \*\*\*, regjistruar në datën 25.5.2017, ende nuk ka një seancë gjyqësore të përcaktuar.

#### **26. Denoncimi nr. \*\*\* prot., datë 23.5.2018, i shtetasit N. M.**

Denoncuesi ka akuzuar disa subjekte rivlerësimi, ndër të tjera, edhe me subjektin e rivlerësimit Zegjine Sollaku. Shtetasi në denoncimin e tij nuk ka depozituar dokumentacion, por referon vendimin e Gjykatës së Apelit Tiranë dhe disa vendime të tjera gjyqësore, për të cilat përshkruan mbi ekzekutimin e tyre, si dhe mbi një kallëzim penal të mosfilluar, por që nuk referon shkelje procedurale të subjektit të rivlerësimit<sup>130</sup>.

---

<sup>130</sup> Ky denoncim është marrë edhe më parë në shqyrtim me vendimin për subjektin e rivlerësimit H. D., nr. \*\*\*, datë 15.2.2019, të subjektit të rivlerësimit, faqe 50.

## **27. Denoncimi nr. \*\*\* prot., datë 18.6.2020, i shtetasit S. K.**

Shtetasi S. K. denoncon subjektin e rivlerësimit për vendim të padrejtë dhe korruptiv, denoncuesi pretendon se vendimi nr. \*\*\*, datë 22.11.2018, është në kundërshtim me një vendim tjetër të dhënë po nga e njëjta trup gjyqësor vendimi me nr. \*\*\*, datë 8.3.2016. Ai përshkruan se subjekti i rivlerësimit është munduar ta konfondojë me këshillat se “sipas mendimit të saj të mos ankimojnë këtë vendim, sepse kishin një gjyq tjetër të fituar atë me nr. \*\*\*, datë 8.7.2011 dhe se ky vendim nuk i hynte në punë,” si dhe vendimi nr. \*\*\*, datë 8.3.2016, është “gjë e gjykuar”. Në këto kushte, Komisioni i është drejtuar Gjykatës së Apelit Tiranë, e cila me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 8.9.2020, vuri në dispozicion kopje të vendimeve të Gjykatës së Apelit Tiranë, nga ku konstatohet se subjekti i rivlerësimit ka qenë anëtare e trupës gjykuese<sup>131</sup> në vendimin nr. \*\*\*, datë 8.3.2016 dhe kryesuese në vendimin nr. \*\*\*, datë 22.11.2018<sup>132</sup>. Nga analizimi i vendimit gjyqësor nr. \*\*\*, datë 8.3.2016, ka rezultuar se objekti i padisë ka qenë “kundërshtim i veprimeve përmbartimore... pavlefshmëri të titullit ekzekutiv të vendimit të gjykatës nr. \*\*\*, datë 8.7.2011, të plotësuar më vendimin nr. \*\*\*, datë 27.9.2011”, ndërkohë që vendimi nr. \*\*\*, datë 22.11.2018 i Gjykatës së Apelit Tiranë, ku subjekti i rivlerësimit ka qenë kryesuese e trupës gjykuese ka pasur për objekt “plotësimin e vendimit civil nr. \*\*\*, datë 8.7.2011, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranës”.

Duket se subjekti i rivlerësimit ka shqyrtuar dy vendime, të cilat si objekt kërkimi në padi kanë pasur vendimin nr. \*\*\*, datë 8.7.2011, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranës.

## **28. Denoncimi nr. \*\*\* prot., datë 18.1.2018, i shtetasës M. Z.**

Shtetasja M. Z. ka denoncuar disa subjekte rivlerësimi, ndër të tjerë, edhe subjektin Zegjine Sollaku, për të cilët ka depozituar edhe në KLD ankesë lidhur me rastin konkret. KLD-ja, me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 18.4.2016, ka informuar shtetasen se të gjitha pretendimet e ngritura prej saj mund të zgjidhen vetëm ndërmjet apelimit gjyqësor të palëve, duke arkivuar edhe ankesën. Nga analizimi i vendimit nr. \*\*\*, datë 21.4.2014, evidentohet se subjekti i rivlerësimit ka dalë me vendimi kundër (*sipas shënimit në vendim “kundër”*), vendimi është ankimuar në Gjykatën e Lartë, e cila me vendimin nr. \*\*\*, datë 17.2.2017, ka vendosur “mospranimin e rekursit të paraqitur nga M. Z. kundër vendimit nr. \*\*\*, datë 21.4.2014, të Gjykatës së Apelit Tiranë”. Ky denoncim është marrë edhe më parë në shqyrtim nga Komisioni<sup>133</sup>.

## **29. Denoncim nr. \*\*\* prot., datë 26.10.2018, paraqitur nga BKT-ja drejtuar një trupi gjykues në Gjykatën e Apelit, ku subjekti i rivlerësimit ka qenë anëtare**

<sup>131</sup>Me vendimin nr. \*\*\*, datë 8.3.2016, Gjykata e Apelit Tiranë ka vendosur “lënien në fuqi të vendimit nr. \*\*\*, datë 25.2.2015, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, duke vlerësuar se vendimi është i drejtë dhe i bazuar në ligj dhe, si i tillë, duhet të lihet pasi nga aktet në dosje ka rezultuar se: “Me vendimin nr. \*\*\*, datë 8.7.2011, ka rezultuar që Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë të ketë disponuar se ka pranuar kërkesë padinë e shtetasve A. Q. dhe A. Q., duke i kthyer paditësit S. K. për shumën e dhënë hua. Kundër këtij vendimi nuk rezultoi të jetë bërë ankim duke marrë formë të prerë”.

<sup>132</sup>Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin nr. \*\*\*, datë 22.11.2018, ku kryesuese e trupës gjyqësore ka qenë subjekti i rivlerësimit Zegjine Sollaku, ka shqyrtuar padinë me objekt “plotësimin e vendimit civil nr. \*\*\*, datë 8.7.2011, të Gjykatës së Rrethit Tiranë”. Kjo gjykatë, pas shqyrtimit të provave, ka vlerësuar se vendimi nr. \*\*\* akti, datë 27.9.2011, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, pasi ka vlerësuar se Gjykata e Shkallës së Parë, nuk ka rezultuar të ketë hetuar nëse kërkesa ishte bërë në përputhje me parashikimet ligjore dhe afatet e përcaktuara, e në këto kushte ka vendosur “prishjen e vendimit nr. \*\*\*, datë 27.9.2011, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe dërgimin e çështjes për rigjykim asaj gjykate me një tjetër trup gjykues”.

<sup>133</sup>Vendimi nr. \*\*\*, datë 1.7.2020, i Komisionit, për subjektin e rivlerësimit V. H.

Në këtë denoncim trajtohen fakte të një procesi gjyqësor me objekt pavlefshmërie të akteve të shitblerjes dhe shkëmbimit, ku BKT-ja ka pasur cilësinë e personit të tretë në këtë proces gjyqësor dhe kanë siguruar kredinë e marrë nga një palë gjyqësore. BKT-ja pretendon se trupi gjyqësor ka kryer shkelje të rënda të parimeve kushtetuese, të cilët kanë cenuar vendimin e marrë. Trupi gjykues nuk ka arsyetuar vendimin e dhënë dhe, për pasojë, ka cenuar një nga parimet kryesore të drejtësisë atë të procesit të rregullt ligjor, nuk ka kryer një hetim të plotë dhe të gjithanshëm lidhur me marrjen e disa provave të rëndësishme për procesin, si dhe ka cenuar parimin e kontradiktoritetit, duke dhënë vendimin në pohime të njëjës palë, pa u bazuar në prova. Nga analizimi i vendimit, duket se nuk është kryer një hetim i plotë dhe i gjithanshëm nga gjykata, për t'i dhënë zgjidhje të gjitha pretendimeve të palëve (sikurse ka cituar në këtë denoncim BKT-ja). Duket se gjykata ka bazuar vendimin në pohimet e palëve, pa kryer një hetim të plotë dhe të bazuar në akte shkresore për të krijuar bindjen se lidhja e kontratave ka qenë e simuluar<sup>134</sup>. Rezulton se ndaj vendimit të Gjykatës së Apelit Tiranë, nga ankuesi BKT, është bërë rekurs në Gjykatën e Lartë, e cila është regjistruar më 7.10.2016 dhe është ende në pritje të gjykimit.

### **30. Denoncimi nr. \*\*\* prot., datë 5.12.2019, i shtetasit J. B.**

Shtetasi në fjalë nëpërmjet formularit të denoncimit ka informuar se në datën 24.9.2019, në seancën gjyqësore me relatores Zegjine Sollaku dhe anëtare F. S.i dhe E. Ll., nëpërmjet av. E. J. i është kërkuar një shumë parash prej 30.000 euro, të cilat nuk ka pranuar t'i jepte, dhe se ka qenë kjo arsyeja që çështja është rikthyer për rigjykim. Nuk konstatohet që denoncuesi të ketë depozituar prova apo fakte lidhur me sa pretendon. Në këto kushte, Komisioni iu drejtua Gjykatës së Apelit Tiranë, e cila vuri në dispozicion vendimin nr. \*\*\*, datë 1.10.2019 dhe procesverbalet e seancave gjyqësore. Rezulton se në seancën e parë gjyqësore zhvilluar në datën 29.1.2019, njëri nga anëtarët e trupës ka paraqitur kërkesën për dorëheqje, kërkesë e pranuar nga gjykata dhe i zëvendësuar ky i fundit më 26.3.2019, gjithashtu, anëtari tjetër i trupës, është zëvendësuar për shkak se më parë kishte dhënë një vendim që kishte lidhje me vendimin objekt gjykimi. Në përfundim, gjykata me vendimin nr. \*\*\*, datë 1.1.2019, ka vendosur “prishjen e vendimit nr. \*\*\*, datë 27.2.2017, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe dërgimin e çështjes për rigjykim me një tjetër trup gjyqësore”. Nga dokumentacioni në administrim, evidentohet se Gjykata e Apelit Tiranë ka prishur vendimin e Gjykatës së Shkallës së Parë, pasi kjo e fundit nuk kishte kryer një hetim të plotë dhe të gjithanshëm, si dhe kishte gjykuar çështjen në mungesë të palëve. Kjo çështje është regjistruar në datën 26.5.2017 dhe ka përfunduar më 1.10.2019, pra, tej afatit të lejuar nga pika 5, germa “h”.

### **31. Denoncimi nr. \*\*\* prot., datë 27.6.2018, i shtetasit H. R.**

Shtetasi H. R., në kërkesën e tij kryesisht, ngre pretendime ndaj një tjetër subjekti rivlerësimi H. D. Nga përmbajtja e denoncimit dhe e dokumentacionit bashkëlidhur referohet emri i subjektit të rivlerësimit si anëtare e trupës gjykuese në Gjykatën e Apelit Tiranë, nuk ka bashkëlidhur dokumentacion mbi të cilin të thellohen hetimet lidhur me subjektin e rivlerësimit.

### **32. Denoncimi nr. \*\*\* prot., datë 28.6.2019, i shtetasit B. K.**

---

<sup>134</sup> Vetëm për qëllim të marrjes së kredisë pranë BKT dhe, për rrjedhojë, të konstatohen të pavlefshme.

Denoncuesi B. K. pretendon se gjatë gjykimit të çështjes, nga trupa gjyqësore nuk janë marrë për bazë provat dhe faktet, si dhe janë shkelur të drejtat nga gjyqtarët e korruptuar. Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion, nuk konstatohet që subjekti i rivlerësimit të ketë qenë anëtare e trupës gjyqësore në dhënien e vendimit.

### **33. Denoncimi nr. \*\*\* prot., datë 18.7.2019, i shtetasës E. J.**

Shtetasja E. J. akuzon për dhënie vendim të padrejta nga disa subjekte rivlerësimi ndërmjet tyre dhe subjektin Zegjine Sollaku, sipas saj nuk kanë zbatuar procedurën ligjore dhe shfaqin mungesë profesionalizmi. Nga analizimi i dokumentacionit, rezulton se Gjykata e Apelit Tiranë me vendimin nr. \*\*\*, datë 14.5.2019, ku si kryesues (relator) i trupit gjyqësor ka qenë një tjetër subjekt rivlerësimi, ka vendosur “ndryshimin e vendimit nr. \*\*\* akti, datë 25.4.2018, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, si dhe lejimin e pjesëtimit të pasurisë etj.”. Ky vendim rezulton të jetë rekursuar në Gjykatën e Lartë në datën 27.6.2019 dhe aktualisht është në statusin e studimit me nr. çështje \*\*\*. Duket se ankimi lidhet me themelin e çështjes dhe, për pasojë, trajtimi i saj nuk është në kompetencë të Komisionit.<sup>135</sup>

### **34. Denoncimi nr. \*\*\* prot., datë 18.1.2021, i shtetasit F. D.**

Shtetasi F. D. pretendon për shkelje ligji nga subjekti i rivlerësimit lidhur me dy dosje me objekt “marrje mase sigurie”. Komisioni, me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 20.1.2021, kërkoi pranë Gjykatës së Apelit Tiranë kopje të vendimeve për dhënien e masave të sigurimit për shtetasit Sh. Ll. dhe P. P.. Gjykata e Apelit Tiranë, me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 29.1.2021, ka vënë në dispozicion kopje të vendimit penal nr. \*\*\*, datë 8.1.2014, të Gjykatës së Apelit Tiranë ( masë sigurimi), vendimin penal nr. \*\*\*, datë 30.12.2013, të Gjykatës së Apelit Tiranë (masë sigurimi) për shtetasin P. P.. Ka rezultuar nga shqyrtimi i vendimit nr. \*\*\*, datë 30.12.2013, se subjekti i rivlerësimit ka qenë kryesuese në trupën gjyqësore ku kanë vendosur “ndryshimin e vendimit nr. \*\*\* akti, datë 8.12.2013, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranës dhe caktimin si masë sigurimi personal ndaj personit nën hetim Pëllumb Prençi, atë të arrestit në shtëpi”, si dhe vendimin nr. \*\*\*, datë 8.1.2014, ku subjekti i rivlerësimit ka qenë relatore në dhënien e vendimit për “ndryshimin e vendimit nr. \*\*\* akti, datë 12.12.2013, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranës<sup>136</sup>, si dhe caktimin si masë sigurimi personal ndaj personit nën hetim Sh. Ll.<sup>137</sup> “arrest në shtëpi”.

### **35. Denoncimi nr. \*\*\* prot., datë 5.1.2021, i shtetasës V. T.**

Shtetasja në fjalë denoncon disa subjekte rivlerësimi, ndërmjet tyre edhe subjektin e rivlerësimit, por nuk ka vënë në dispozicion dokumentacion, për të vërtetuar pretendimet, në këto kushte, Komisioni, me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 20.1.2021, kërkoi pranë Gjykatës së

<sup>135</sup> Komisioni është shprehur edhe më parë me vendimin nr. \*\*\*, datë 17.6.2020, për subjektin E. T. (S.) në f. 65.

<sup>136</sup> Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, në referim të dispozitave të parashikuara në nenet 228 dhe 229 të Kodit të Procedurës Penale, ku janë përcaktuar kriteret e caktimit të masave të sigurimit.

<sup>137</sup> Ndaj shtetasit Sh. Ll., duhet të mbaheshin parasysh, shkalla e provueshmërisë së dyshimit të arsyeshëm, pasi ndryshe nga personat e tjerë të përfshirë për të cilët po hetohen, për këtë person, dyshimi i arsyeshëm mbetet kryesisht në *indicie*, madje edhe duhet vlerësuar fakti se për shumë vite, ai ka kryer detyrën e kryetarit dhe të gjyqtarit, si dhe faktin se ai dhe bashkëshortja e tij, vuajnë nga një sëmundje e rëndë dhe kanë nevojë për përkujdesje. Gjithashtu, lidhur me pretendimin se arrestimi i tij është bërë në kundërshtim me parashikimet ligjore të neni 1378 të Kushtetutës, Gjykata e Apelit ka çmuar se në rastin konkret, procedura e kërkuar nga Kushtetuta, për lejimin e arrestimit të tij, është administruar kërkesa e gjyqtarit dhe përgjigje e KLD, nr. \*\*\*, datë 10.12.2013, ku KLD-ja ka dhënë vullnetin duke autorizuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranës për të shqyrtuar kërkesën e prokurorisë për caktimin e masës së sigurimit ndaj tij.



Apelit Tiranë vendimin përkatës, e cila me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 29.1.2021, ka vënë në dispozicion vendimin civil nr. \*\*\*, datë 31.3.2016, me palë ndërgjyqëse V. T. kundër palë L. T. dhe R. T.. Nga shqyrtimi i vendimi të gjykatës konstatohet se subjekti i rivlerësimit ka qenë kryesuese në dhënien e vendimit nr. \*\*\*, datë 31.3.2016, me objekt “*pjesëtimin e pasurisë të apartamentit nr. \*\*\* dhe në zhdukjen e bashkëpronësisë mbi këtë pasuri*” dhe në përfundim ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, për pezullimin e gjykimit të çështjes me palë paditëse denoncuesen, deri sa të zgjidhet çështja administrative e legalizimit dhe regjistrimit përfundimisht të shtesës anësore të apartamentit në bashkëpronësi. Nuk shihen *indicie* për thellimin e hetimit, pasi denoncimi ka të bëjë me themelin e çështjes që nuk është objekt i shqyrtimit.

**36. Denoncimet nr. \*\*\* prot., datë 31.7.2019; nr. \*\*\* prot., datë 4.10.2019,; nr. \*\*\* prot., datë 30.10.2019, të ardhura nga Kolegji i Posaçëm i Apelit të përcjella nga shtetasi V. Ç.**

Komisioni ka shqyrtuar disa herë këtë/këto denoncime dhe në përfundim ka vlerësuar se denoncimet në raport me elementet e nenit 53, pikat 1 dhe 2, të ligjit nr. 84/2016, nuk referojnë asnjë shkelje ligjore apo procedurale apo veprime korruptive.

**37. Denoncimi nr. \*\*\*, datë 4.1.2018, i shtetasit J. N.**

Shtetasi denoncon disa subjekte rivlerësimi dhe ndërmjet tyre përmendet edhe subjekti i rivlerësimit Zegjine Sollaku, kryesisht denoncimi ka të bëjë me një tjetër subjekt rivlerësimi.

**38. Denoncimi nr. \*\*\* prot., datë 24.2.2021, i shoqërisë S.**

Shoqëria S. denoncon trupën gjyqësore dhe në veçanti subjektin e rivlerësimit Zegjine Sollaku për shkelje procedurale. Shoqëria SICRED ka qenë palë e paditur në çështjen civile nr. \*\*\* akti, datës 20.7.2018, ku në seancën e parë gjyqësore të zhvilluar në Gjykatën e Apelit Tiranë atë të datës 27.2.2020 pas shpalljes së trupit gjykues, nga subjekti i rivlerësimit Zegjine Sollaku është relatuar se kjo seancë është caktuar jashtë radhe, bazuar në kërkesën e palës “T. B.”. Në datën 28.1.2020, subjekti i rivlerësimit ka marrë vendim për pranimin e kërkesës për përshpejtimin e gjykimit, bazuar në vendimin nr. \*\*\*, datë 30.5.2019, të Këshillit të Lartë Gjyqësor, për përshpejtimin e gjykimit të çështjeve, pika 6, germa “ë”<sup>138</sup>, në të cilën sanksionohet se: “*Përshpejtimi i gjykimit behët për çështje shqyrtimi i të cilave në Gjykatën e Shkallës së Parë ka zgjatur përmbi 2 vjet*”. Shoqëria në fjalë ka depozituar kërkesë për përjashtimin e gjyqtarës Zegjine Sollaku, duke ngritur dyshime serioze, lidhur me paanësinë e saj pasi: “*Nuk ka motivuar dhe argumentuar shkaqet mbi të cilat ka marrë vendimi për përshpejtimin e kësaj çështje*”.

Kjo kërkesë është shqyrtuar nga Gjykata e Apelit Tiranë, e cila me vendimin nr. \*\*\*, datë 13.1.2021, ka vendosur “*rrëzimin e kërkesës së kërkuarit S. për përjashtimin e gjyqtarëve E. Ll. dhe Z. Sollaku, nga gjykimi i çështjes civile me nr. \*\*\* akti, datë 20.7.2018*”. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion dhe konkretisht nga vendimi nr. \*\*\*, datë 13.1.2021, rezulton se denoncuesi S. është vënë në dijeni të faktit se shtetasi D. B. është jurist dhe punon pranë subjektit “T. B.” dhe është i afërmi i bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit . Gjithashtu,

---

<sup>138</sup> Referuar vendimit të KLGj-së, germa është “ç” dhe jo “ë”.

me kërkesën e datës 28.1.2021, denoncuesi pretendon faktin se subjekti i rivlerësimit është në statusin e debitorit /garantuesit/ përkundrejt “T. B.”, referuar kontratës së huas, datë 19.7.2013, për vlerën 193.000 euro, status debitor për kontratën e huas në datën 22.9.2014, me vlerë 700.000 lekë, si dhe në statusin e debitorit /garantues për kontratën e huas, datë 22.9.2014, me vlerë 3.000.0000 lekë dhe për të gjitha sa më lartë përmendur statusi saj është “statusi 4-humbur”. Në seancën e datës 28.1.2021, ka rezultuar se subjekti i rivlerësimit është vetëdorëhequr nga gjykimi i kësaj çështje. Gjykata e Apelit Tiranë, me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 28.4.2021, ka informuar se kjo çështje i ka rënë në short subjektit të rivlerësimit dhe është ende në proces gjykimi.

301. Pasi është njohur me rezultatet e hetimit, subjekti ka paraqitur shpjegimet e tij dhe ka depozituar edhe dokumentacion mbështetës edhe për sa i përket kriterit të rivlerësimit të aftësive profesionale dhe, konkretisht, lidhur me problematikat e konstatuara nga KLGJ-ja – mbi tejkalimin e afateve – dhe/ose nga Komisioni, mbi konfliktet e mundshme të interesit, denoncimet apo faktet e njohura botërisht, të cilat janë administruar dhe shqyrtuar nga trupi gjykues, duke mos u konstatuar shkelje të rënda procedurale apo të etikës nga subjekti.
302. Nisur nga kryerja e një vlerësimi të përgjithshëm të kriterit të vlerësimit të aftësive profesionale, trupi gjykues çmon se, ndonëse në disa prej dosjeve/akteve të administruara nga Komisioni apo të referuara nga KLGJ-ja, përfshirë edhe denoncimet nga publiku, janë konstatuar problematika, kryesisht me afatet, të cilat mbeten të një niveli të tillë që vlerësohet që nuk përbëjnë në vetvete shkaqe të mjaftueshme për të konkluduar për papërshtatshmërinë profesionale të subjektit të rivlerësimit, znj. Zegjine Sollaku, ka arritur një nivel kualifikues të kriterit profesional të parashikuar dhe të kërkuar nga germa “c”, e nenit 59/1, të ligjit nr. 84/2016.
303. Në konkluzion, trupi gjykues arrin në përfundimin se:
  - i. Lidhur me kriterin e pasurisë, subjekti i rivlerësimit ka pasur mungesë të burimeve financiare të ligjshme – sipas parashikimeve të nenit D të Aneksit të Kushtetutës – për të kryer të gjitha investimet dhe, njëkohësisht, për të përballuar shpenzimet apo për të realizuar kursimet e deklaruara. Gjithashtu, subjekti ka kryer disa deklarime të pamjaftueshme dhe, për rrjedhojë, subjekti i rivlerësimit nuk arrin nivel të besueshëm në vlerësimin e krijimit dhe deklaramit të pasurisë dhe, në këtë rast, duhet të aplikohet pika 5, e nenit D, të Aneksit të Kushtetutës, si dhe pika 3, e nenit 61, të ligjit nr. 84/2016.
  - ii. Në lidhje me kontrollin e figurës, subjekti i rivlerësimit arrin një nivel të besueshëm, sipas germës “b”, të nenit 59/1, të ligjit nr. 84/2016 dhe trupi gjykues e konsideron të përshtatshëm për vazhdimin e detyrës.
  - iii. Në lidhje me aftësitë profesionale të subjektit të rivlerësimit, për sa më sipër, trupi gjykues çmon se ka arritur një nivel kualifikues, sipas germës “c”, të nenit 59/1, të ligjit nr. 84/2016.
304. Në këto kushte, trupi gjykues, bazuar në provat që ka administruar dhe zotëron, në vlerësimin e çështjes në tërësi, si dhe në bindjen e brendshme, arrin në konkluzionin se

subjektit të rivlerësimit, znj. Zegjine Sollaku, me detyrë gjyqtare në Gjykatën e Apelit Tiranë, duhet t'i jepet masa disiplinore e shkarkimit nga detyra.

### **PËR KËTO ARSYE,**

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, bazuar në nenin 179/b të Kushtetutës, në nenin D të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në ligjin nr. 76/2016, datë 22.7.2016, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, si dhe në pikën 5, të nenit 55, të ligjit nr. 84/2016, pasi u mblodh në dhomë këshillimi, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, në bazë të germës “c”, të pikës 1, të nenit 58 dhe të pikës 3, të nenit 61, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,

### **V E N D O S I:**

1. Shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit, znj. Zegjine Sollaku, me detyrë gjyqtare në Gjykatën e Apelit Tiranë.
2. Vendimi, i arsyetuar me shkrim, i njoftohet subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik dhe vëzhguesve ndërkombëtarë, si dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit, në përputhje me pikën 7, të nenit 55, të ligjit nr. 84/2016.
3. Ky vendim mund të ankimohet në Kolegjin e Posaçëm të Apelit nga subjekti i rivlerësimit dhe/ose Komisioneri Publik 15 ditë nga data e njoftimit të vendimit të Komisionit.
4. Ankimi depozitohet në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit.

Ky vendim u shpall në Tiranë, në datën 8.7.2020.

### **KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT**

**Xhensila PINE**

**Kryesuese**

**Lulzim HAMITAJ**

**Relator**

**Suela ZHEGU**

**Anëtare**

*Sekretare gjyqësore*  
*Orjanda Liçi*